



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0035074-1/26 dt. 29.06.2026

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës

Seanca e 9-të

Koha: 29.06.2026, ora 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Shkëlqim Ibrahim, Fisnik Suma, Igballe Islami, Ferdi Kadriu, Egzon Sadiku, Valon Brahimi, Egzon Hamza, Liridona Muharremi, Nazmiye Sejdiu, Lavdim Zeneli, Armend Begu, Jeton Zeneli, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Rinesa Preteni, Sazan Ramaxhiku, Bajram Istrefi, Visar Sylja, Xhevdet Osmani, Elfate Ademi Bahtiri, Rozana Peci, Oltion Ahmeti, Xhylljeta Imeri, Arta Neziri, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Flamur Vojvoda

Kryetari i Komunës z. Faton Peci

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

Mungoi: Majlinda Kurti, Gëzim Stavileci dhe Artan Berisha

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi, i cili fillimisht përshëndeti Kryetarin e Komunës, Nënkryetarin e Komunës, anëtarët të Kuvendit, organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare, media dhe të pranishmit tjerë. Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit i Kuvendit theksoi Në zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPI) Nr. 02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Mitrovicës, në cilësinë e Kryesuesi i Kuvendit të Kuvendit të Komunës kam thirrur mbledhjen e 9-të të rregullt të Kuvendit të Komunës, me rend dite siq është paraparë me thirrje (lexoi rendin e ditës),

Kryesuesi para se të hapë diskutimin lidhur me rendin e ditës theksoi se më duhet të jap një sqarim lidhur me rendin e ditës së mbledhjes së kaluar, pikën 19 nuk e kemi diskutuar mbledhjen e kaluar, fjala është për zhvlerësimin e lloptopëve të anëtarëve të Kuvendit të mandatit të kaluar, prandaj të futet në rend dite këtë mbledhje. Nga Drejtoria për Siguri dhe Emergjencë, ka ardhur kërkesa për ndryshim plotësim të raportit për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet, fjala është për një gabim teknik, ku në vend të shumës prej 6940 €, është shkruar shuma prej 694 €, prandaj edhe kjo pikë të futet në rend dite. Po ashtu e kemi edhe propozimin që pikë e veçantë e rendit të ditës të jetë Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin, 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026, kjo pikë ka qenë në diskutim në KPI, konkluzionet e KPI-së të mbledhjes së fundit i keni përpara. I hap diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Valon Brahim: Është hera e 4 që unë po e ngris një çështje dhe nuk po marr përgjigje adekuatë, ne kemi kërkuar raport të detajuar të Drejtorisë së Arsimit, lidhur me gjendjen në arsim, për orët e humbura dhe mënyrën se si janë kompensuar. Neve na ka ardhur në shkresë në formë informate, që nuk është ajo që e kemi kërkuar, konkretisht kemi kërkuar: sa është numri i mësimdhënësve që kanë munguar, sa është numri i mësimdhënësve që janë zëvendësuar, sa është numri i orëve të humbura dhe sa është numri i orëve që janë zëvendësuar. Po ashtu në KPI kam kërkuar Raport në formë të informatës, që ka të bëjë me shqetësimin e prindërve në Këshillin e prindërve të shkollave, pse në një farë forme janë obliguar shkollat e mesme që nga 6-7 nxënës me i ba pjesë të një kampanje të fushatës, e kam në formë informate, jo të konstatuar, një qëndrim një ditor dhe me e vizituar ish villën e të ashtuquajturit Radojqi, se tash është pjesë e institucioneve të Kosovës, po du me e ditë a është ai institucion akademik, a ka laborator biokimik, a çka ka aty që është në interes të nxënësve, cili është motivi i asaj vizite, dhe duhet me ditë se në bazë të ligjeve në fuqi arsimit fillor dhe parafillor është e drejtë ekskluzive e komunave dhe nuk ka nevojë me ju bind kërkesave të gabuara. Po ashtu po e shprehi shqetësimin tim lidhur me rastin e 80-të vjetorit të themelimit të Gjimnazit, përzgjedhja e personateteve që janë vendosur në tabelë është skandalozë, kontribuesit më të mëdhenjë që kanë dalur nga Gjimnazi nuk janë përzgjedhur.

Kryesuesi Safet Kaberi: Çështja e organizimit të përvjetorit të Gjimnazit, edhe unë jam të diskutohet për këtë çështje por kur të vijmë te pika e Drejtorisë së Arsimit, sepse edhe unë kam vërejtjet e mia lidhur me këtë çështje.

Kryetari Faton Peci: Pika 13, në kuadër të programit dhe fushatës, është një premtime që e kam dhënë: çdo klub që shpallet kampion, si dhe çdo klub ose sportist që arrin suksese gjatë një sezoni, do të përfitojë një shpërblim financiar. Prandaj, propozoj që pika 14 e rendit të ditës të jetë Propozim-vendim për ndarjen e mjeteve financiare për klubet sportive që kanë arritur rezultate gjatë vitit 2026, përkatësisht gjatë sezonit që tashmë ka përfunduar. Çdo klub dhe çdo sportist individual që shënon sukses gjatë vitit do të jetë përfitues i kësaj skeme. Si kryetar, jam zotuar dhe dua ta mbaj këtë zotim, duke siguruar një subvencionim të veçantë për sukseset e arritura, përveç subvencioneve të tjera që ndahen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara. Kur të vijë kjo pikë e rendit të ditës, do ta prezantoj skemën e subvencionimit, si dhe vlerën monetare që kemi paraparë për të gjitha klubet që janë shpallur kampionë, si edhe për ato që kanë siguruar avancimin në një nivel më të lartë të garës për vitin e ardhshëm.

Xhyljeta Imeri:  Kryetar, z. Peci. Dua të rikthej në vëmendje çështjen e ndërtimit të Shkollës "Abdullah Shabani", një projekt për të cilin jam angazhuar vazhdimisht qysh nga mandati im i kaluar. Nevoja për ndërtimin e kësaj shkolle është urgjente. Objekti ekzistues është ndërtuar rreth viteve të 60-ta. Gjatë kësaj periudhe ajo ka pësuar dëmtime të vazhdueshme, të cilat janë menaxhuar dhe riparuar nga drejtoria dhe stafi i shkollës. Megjithatë, këto ndërhyrje nuk kanë qenë afatgjate. Sot në këtë shkollë vijnë mësimin mbi 1000 nxënës, prandaj siguri i kushteve esenciale duhet të jete prioritet institucional. Pikërisht për këtë arsye, me kërkesën time në mandatin e kaluar u formua komisioni për vlerësimin e nevojës për ndërtimin e shkollës. Pas vlerësimit profesional u konstatua se ndërtimi i saj është i domosdoshëm. Raporti i përcoll Ministrisë së Arsimit dhe projekti u trajtua si prioritet. Kanë kaluar disa vite dhe ende nuk ka filluar realizimi i këtij projekti. Z. Kryetar, kërkoj nga ju që të intensifikoni angazhimin institucional me Ministrinë e Arsimit, që ndërtimi i shkollës "Abdullah Shabani" të nisë sa më parë.

Kushtrim Zeneli: Atëherë, unë kërkoj që në seancën e radhës të Kuvendit Komunal, nga Drejtoria e Kadastrës dhe Pronës, si dhe nga drejtoritë e tjera kompetente që mund të përfshihen në këtë çështje, të paraqitet një raport mbi gjendjen e përgjithshme të pronës komunale. Gjatë javëve dhe muajve të fundit kemi parë një sërë veprimesh që lidhen me pronën komunale. Janë ndërmarrë aksione për rrënimin e lokaleve, bizneseve dhe objekteve të ndryshme që kanë cenuar sigurinë e qytetarëve. Pra, janë zhvilluar aktivitete që lidhen drejtpërdrejt me administrimin e pronës komunale. Duke qenë se bëhet fjalë për pasuri publike, konsideroj se Kuvendi Komunal duhet të ketë një pasqyrë të plotë mbi gjendjen e saj. Prandaj, kërkoj nga ekzekutivi që në seancën e radhës të sjellë një raport, i cili të përfshijë: gjendjen e përgjithshme të pronës komunale; numrin e pronave të uzurpuara dhe masat e ndërmarra për lirimin e tyre; numrin e operatorëve ekonomikë që shfrytëzojnë pronën komunale në bazë të kontratave; sa operatorë ekonomikë i zbatojnë kontratat dhe sa janë në shkelje të detyrimeve kontraktuale; masat e ndërmarra ndaj operatorëve

që nuk respektojnë kontratat; të hyrat e realizuara nga dhënia me qira ose në shfrytëzim e pronës komunale gjatë vitit 2025 e deri më tani. Vlerësoj se ky raport është i domosdoshëm për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie, si dhe për t'i mundësuar Kuvendit Komunal ta ushtrojë në mënyrë efektive rolin e tij mbikëqyrës mbi administrimin e pronës komunale.

Sa i përket çështjes që e përmendi kolegu, në mbledhjen e KPF-së, është sqaruar nga drejtori se objekti është përdorur për një aktivitet trajnues. Megjithatë, dua të theksoj se nuk është e drejtë të quhet "vila e Radiçiqit". Ajo nuk ka qenë kurrë pronë e Radiçiqit dhe nuk duhet të identifikohet me atë emër. Bëhet fjalë për një objekt që ishte uzurpuar nga një person i dënua për krime dhe që sot është rikthyer në pronësi publike. Çdo qytetar, zyrtar apo nxënës që merr pjesë në trajnime në objektet e Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave duhet ta shohë atë objekt si simbol të rikthimit të pronës publike tek qytetarët. Ai duhet të shërbejë si dëshmi se prona publike nuk mund të uzurpohet përgjithmonë dhe se shteti ka detyrimin ta rikthejë atë në shërbim të interesit publik.

Valon Brahimi: Kushtrim unë isha shumë i qartë, është mirë me më dëgjuar me vëmendje, thash: "ish villën e të ashtuquajturit Radojqi, se tash është pjesë e institucioneve të Kosovës..."

Pasi nuk kishte diskutime tjera për rendin e ditës, Kryesuesi propozoj që pike e 2-të e rendit të ditës të jetë: Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026.

Anëtarët e Kuvendit me 18 vota për, o kundër dhe 0 abstenime votuan që pike e 2-të e rendit të ditës të jetë: Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026.

Kryesuesi propozoj që pike e 13-të e rendit të ditës të jetë: Propozim-vendimi Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0014451-7/26 dt. 27.03.2026.

Anëtarët e Kuvendit unanimitisht votuan që pikë e 13-të e rendit të ditës të jetë: Propozim-vendimi Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0014451-7/26 dt. 27.03.2026.

Kryesuesi propozoj që pikë e 14-të e rendit të ditës të jetë: Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për klubet sportive që kanë arritur rezultate gjatë vitit 2026.

Anëtarët e Kuvendit unanimitisht votuan që pikë e 14-të e rendit të ditës të jetë: Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare për klubet sportive që kanë arritur rezultate gjatë vitit 2026.

Kryesuesi propozoj që pikë e 15-të e rendit të ditës të jetë: Propozimi për zhvlerësim të lloptopëve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mandatin 2021-2025, dhe të njëjtëve t'iu ipen këta lloptopë në formë dhurate.

Anëtarët e Kuvendit unanimitisht votuan që pikë e 15-të e rendit të ditës të jetë: Propozimi për zhvlerësim të lloptopëve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mandatin 2021-2025, dhe të njëjtëve t'iu ipen këta lloptopë në formë dhurate.

Në vazhdim Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës sin ë vijim:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026
3. Korniza Afatmesme Buxhetore 2027/2029
4. Propozim Vendim Për caktimin e Parcelës komunale për Ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit
5. Rregullimi dhe harmonizimi i numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore
6. Raport mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, maj 2026
7. Raport i punës së DSHPI-së për periudhën janar-dhjetor 2025
8. Raport të komisionit për vlerësim të dëmeve në rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera

9. Raporti vjetor i menaxhimit të mbeturinave Komunale për vitin 2025
10. Raportet në Lëmin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
11. Informatë për gjendjen në Shëndetësi
12. Informatë e Planifikimit dhe realizimi i mbjelljeve pranverore për vitin 2026
13. Propozim-vendim Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0014451-7/26 dt. 27.03.2026
14. Propozim-vendim për ndarjen e mjeteve financiare për klubet sportive që kanë arritur rezultate gjatë vitit 2026
15. Propozim për zhvlerësim të lloptopëve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mandatin 2021-2025, dhe të njëjtëve t'iu ipen këta lloptopë në formë dhurate
16. Pyetje dhe përgjigje

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua me shumicë votash (27 për, 0 kundër dhe 1 abstenime).

Pika 2

Kryesuesi Safet Kamberi: Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026 është shqyrtuar në KPF, konkluzionin e KPF-së e kemi para vetës: KPF e ka miratuar këtë pikë, por I ka rekomanduar Kuvendit që me miratimin e këtij vendimi duhet të shfuqizohet vendimi paraprak për bartjen e të hyrave në mbledhjen e kaluar.

Gazmend Gjoshaj: Mosbartja e të hyrave në sektorin përkatës ka ndodhur për shkak se, në momentin e realizimit të shpenzimeve, kemi vlerësuar që nevojat janë përmbushur përmes mjeteve financiare të disponueshme, në përputhje me nevojat operative të institucionit. Për këtë arsye, të hyrat nuk janë alokuar në sektorin përkatës në këtë fazë. Ky veprim nuk ka pasur për qëllim shmangien e procedurave, por ka qenë rezultat i mënyrës së menaxhimit të mjeteve financiare për të përmbushur nevojat prioritare në kohën kur ato janë paraqitur. Tani, me propozim-ndryshimin në fjalë, në arsimin fillor kemi bërë realokim të mjeteve në shumën prej 34.000 eurosh. Gjithashtu, në sektorin e shëndetësisë kemi bërë realokim në shumën prej 75.000 eurosh. Këto mjete janë rritur për të mbuluar edhe pagesat shtesë për punonjësit që punojnë jashtë orarit të rregullt të punës. Për këtë kategori, nga viti i kaluar kanë qenë të planifikuara vetëm 14.000 euro, shumë e cila nuk ka qenë e mjaftueshme as për një muaj. Prandaj, me këtë realokim kemi synuar ta mbulojmë këtë nevojë financiare. Nëse keni ndonjë pyetje ose keni nevojë për sqarime shtesë, jemi në dispozicion për t'ju përgjigjur.

Igballe Islami: I nderuar kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetarë, të nderuar drejtorë dhe kolegë të Kuvendit. Para se të fillojmë shqyrtimin e kësaj pike, dua të ndërlihem me fjalën e drejtorit, i cili tha se janë financuar nevojat prioritare. Nëse arsimi dhe shëndetësia nuk kanë qenë nevoja prioritare në momentin e marrjes së vendimit të parë, atëherë sinqerisht nuk e di se çfarë mund të konsiderohet më prioritare. Refuzimi i bartjes së të hyrave nga Ministria e Financave është shqetësues dhe, njëkohësisht, tregon një menaxhim jo të mirë të financave publike. Duke qenë se tashmë jemi në fund të muajit qershor dhe procedura e vlerësimit të ligjshmërisë zgjat deri në 30 ditë, konsideroj se, edhe nëse ky vendim miratohet pas rishqyrtimit, mjetet financiare nuk do të jenë në dispozicion për shpenzim para muajit shtator. Veçanërisht shqetësuese është se, në vend që me bartjen e të hyrave të përforcoheshin sektorët e arsimit dhe shëndetësisë, të cilëve këto mjete u takojnë sipas ligjit, ata nuk janë përfshirë fare deri në momentin kur Ministria e Financave e ka kthyer kërkesën për korrigjim pikërisht për shkak të mosadresimit të këtyre dy sektorëve. Kjo krijon përshtypjen se, në praktikë, arsimi dhe shëndetësia nuk janë trajtuar si prioritet.

Po ashtu, dua të ndërlidhem edhe me fjalën e drejtorit lidhur me një çështje që e kam ngritur edhe në Komitet. Atje kam kërkuar sqarime për raportimet se buxheti i shkollave është përdorur për mbulimin e obligimeve financiare të krijuara nga drejtoritë komunale. Atëherë më është thënë se bëhet fjalë për "fake news". Prandaj, edhe sot e përsëris të njëjtën pyetje: A ka pasur shpenzime nga buxheti i shkollave për mbulimin e obligimeve financiare të krijuara nga drejtoritë komunale? Nëse një praktikë e tillë ka ndodhur gjatë këtij gjashtëmujori, atëherë është e domosdoshme që shkollat të kompensohen përmes bartjes së të hyrave, në mënyrë që buxheti i tyre të rikthehet në nivelin që është shpenzuar për mbulimin e obligimeve të komunës. Po ashtu, është e papranueshme që nga bartja e të hyrave, të cilat janë rezultat i tejkalimit të të hyrave gjatë vitit 2025, nuk është paraparë asnjë shumë për investime kapitale, ndonëse e dimë se ato janë thelbësore për zhvillimin e komunës dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Njëkohësisht, nuk është adresuar vazhdimi i mbështetjes për familjet në asistencë sociale. Kam kërkesa të vazhdueshme nga rreth 1.400 familje që përfitojnë asistencë sociale dhe pyes pse nuk po vazhdohet me praktikën e subvencionimit të tyre nga ana e komunës. Po ashtu, ka pasur premtime publike, të evidentuara edhe në procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit, se familjet që kanë pësuar dëme nga vërshimet do të subvencionohen nga buxheti komunal. Edhe sot, kur po e rishqyrtojmë bartjen e të hyrave, nuk shoh asnjë propozim që adreson këtë zotim. Prandaj, mendoj se sot kemi mundësinë dhe përgjegjësinë që këto mjete t'i ridestinojmë në mënyrë më të drejtë. Konkretisht, kërkoj që, nëse rezulton se ka pasur shpenzime nga buxheti i shkollave për mbulimin e obligimeve financiare të komunës, atëherë përmes kësaj bartjeje të të hyrave ato mjete t'u rikthehen shkollave. Në këtë mënyrë do të korrigjohesh një padrejtësi dhe do të sigurohesh që mjetet e dedikuara për arsimin të përdoren për nevojat e arsimit.

Kryetari Faton Peci: Sa i përket çështjes së lajmeve të rreme, nuk e di nëse përfaqësuesit e portaleve lokale janë të pranishëm këtu, por lajmi se nga mjetet e shkollave janë financuar lulet në qytet është i pavërtetë. Për këtë arsye, e kam autorizuar kabinetin që ta kontaktojë drejtoreshën e portalit që e ka publikuar këtë lajm. Nëse nuk tërhiqet dhe nuk e korrigjon informacionin, do të përballlet me padi për shpifje. Edhe sot, në mbledhjen e kabinetit, e kam ngritur si shqetësim çështjen e lajmeve të rreme dhe kam kërkuar që ndaj shpifjeve të medimeve lokale të reagojmë përmes procedurave ligjore. Kjo është ruga e vetme institucionale. Sa për sulmet personale, nuk pres që të ndalen. Gjatë fushatës kanë qenë të vazhdueshme dhe, me gjasë, do të vazhdojnë edhe gjatë mandatit. Nuk pres asgjë tjetër. Megjithatë, nuk do të lejoj që buxheti i qytetarëve të Mitrovicës, të cilët përballen me vështirësi ekonomike e sociale, të përdoret për interesa të tilla. Po ashtu, nuk më shqetësojnë kritikrat apo sulmet e mediave. Ajo që më shqetëson janë lajmet e pavërteta që dezinformojnë opinionin publik. Për secilin rast të tillë do të përgjigjem me rrugë ligjore. Edhe nëse drejtësia nuk reagon gjithmonë me shpejtësinë që do të dëshironim, institucionet duhet të ndjekin procedurat ligjore. Nga ana tjetër, fakti që mediat kanë lirinë të kritikojnë dhe qytetarët kanë lirinë të shprehën është pjesë e demokracisë. Por edhe shpifja duhet të ketë pasoja dhe të sanksionohet nga gjykata. Lajme të rreme ka pothuajse çdo ditë. Vetëm dje u raportua se ishin "avulluar" rreth 33 apo 34 mijë euro, gjë që është plotësisht e pavërtetë. Për këto raste do të na duhet të shpenzojmë kohë për përgatitjen e padive për shpifje. Sa i përket bartjes së mjeteve financiare, ne punojmë me buxhetin që kemi trashëguar. Është normale që çdo qeverisje t'ia lërë buxhetin qeverisjes pasuese. Edhe unë, kur të mos jem më në këtë detyrë, do t'ia lë dikujt tjetër një buxhet, i cili ndoshta nuk do t'i përshtatet vizionit të tij. Çdo qeverisje ka prioritetet e veta. Edhe mua nuk më pëlqen buxheti që kam trashëguar. Megjithatë, nuk kemi pasur alternativë tjetër veçse të orientojmë bartjet dhe shpenzimet sipas nevojave të krijuara në drejtoritë përkatëse. Dua ta bëj të qartë se asnjë cent i Drejtorisë së Arsimit nuk do të humbasë deri në përfundim të vitit fiskal. Nëse ka ndodhur ndonjë huazim i përkohshëm i mjeteve ndërmjet drejtorive për disa javë apo muaj, ato mjete do t'i kthehen Drejtorisë së Arsimit në tërësi, në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe me legjislacionin për financat e pushtetit lokal. Në fund të vitit fiskal, të gjitha të hyrat e institucioneve, përfshirë ato të arsimit, do të jenë të rikthyera dhe do të përdoren për projektet dhe nevojat e tyre. Kur flasim për planifikimin buxhetor, detyra e parë e një menaxheri, financieri apo politikani të mirë është të hartojë një buxhet realist. Kur kam qenë ministër, pyetja e parë që më bënte Ministri i Financave ishte gjithmonë: "Sa obligime kontraktuale keni?" Kjo sepse ato janë baza e planifikimit financiar. Ne kemi trashëguar një situatë ku kishte rreth 795 mijë euro të planifikuara për mallra dhe

shërbime, ndërsa obligimet kontraktuale arrijnë rreth 2 milionë euro. Kjo nuk është planifikim i mirë financiar dhe krijon probleme serioze në menaxhimin e buxhetit. Megjithatë, pasi dokumenti kaloi të gjitha procedurat, u vlerësua nga Ministria e Pushtetit Lokal dhe u nënshkrua edhe nga Sekretari i Ministrisë së Financave, një zyrtar kërkoi korrigjim për shkak se një pjesë e mjeteve duhej të orientohej drejt sektorit të shëndetësisë. Ne e kemi pranuar këtë korrigjim dhe e kemi reflektuar në propozimin e ri. Sa i përket arsimit, në vetëm gjashtë muaj kemi siguruar rreth 5 milionë euro për ndërtimin e objektit të ri të Gjinnazit dhe të Shkollës së Muzikës. Projekti është duke u hartuar dhe vlera përfundimtare do të përcaktohet pas përfundimit të projektimit. Gjithashtu, jemi në negociatë me Ministrinë e Arsimit për ndërtimin e Shkollës "Abdullah Shabani". Paralelisht, po planifikojmë edhe zgjidhjen për akomodimin e nxënësve gjatë kohës së ndërtimit të objektit të ri. Në fushën e arsimit kemi rritur edhe numrin e asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta. Mitrovica ka pasur vetëm pesë asistentë, ndërsa me ndryshimet që po bëjmë ky numër do të dyfishohet. Për këtë kemi sakrifikuar pozita administrative në sektorë të tjerë, sepse arsimit është prioritet i qeverisjes sonë. Vendimi im i parë si kryetar ka qenë pikërisht adresimi i nevojave të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe deri në fund të mandatit do të vazhdojmë ta rrisim mbështetjen për këtë kategori. Prandaj, nuk mund të thuhet se arsimit nuk është prioritet, kur kemi siguruar financim për Gjinnazin, Shkollën e Muzikës, po punojmë për ndërtimin e Shkollës "Abdullah Shabani" dhe po rrisim numrin e stafit mbështetës në shkollë. Përtej arsimit, kemi siguruar investime të rëndësishme edhe në fusha të tjera: ndërtimin e fushave sportive, investime në infrastrukturë rrugore, ura dhe projekte të tjera me mbështetje nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Vetëm në muajt e parë të mandatit kemi siguruar rreth 13 milionë euro investime nga qeveria qendrore. Këto janë projekte konkrete, të matshme dhe të prekshme për qytetarët. Prandaj, rezultatet ekzistojnë dhe ato do të vazhdojnë të shtohen gjatë mandatit.

Igballe Islami: Me të vërtetë, edhe në fjalën e tij, kryetari i ndërlidhi disa çështje të nivelit nacional me ato të nivelit lokal. Është mirë që edhe vetë e the se, kur ke shkuar te ministri i Financave, ke shkuar me kërkesa dhe ai e ka ditur saktësisht se cilat janë obligimet kontraktuale. Kjo do të thotë se edhe nga institucioni ku keni qenë më parë janë lënë obligime kontraktuale, të cilat janë të ligjshme. Sa i përket buxhetit, po e përfundoj me këtë pjesë. Është një çështje për të cilën mund të flitet me kompetencë profesionale. Në aspektin ekonomik na vlerësojnë profesorët tanë, ndërsa në aspektin politik na vlerësojnë qytetarët. Prandaj, në të dyja këto dimensionet ndihem e vlerësuar. Përdorisa më replikua mua, është normale që ta marr fjalën edhe në këtë pikë. Tani po kaloj te planifikimi i buxhetit për vitin 2027. Kur i kemi aprovuar të gjitha kontratat kornizë, ato kanë pasur mbulueshmëri financiare në buxhetin 2026–2028. Këto kontrata kanë një vlerë prej rreth 2 milionë eurosh, mirëpo shpenzohen gjatë tri viteve, pra në periudhën 2026–2028. Drejtor, po e marr si shembull edhe atë që ju votë e keni quajtur "fake news". Unë asnjëherë nuk thashë se për çfarë janë paguar mjetet. Unë vetëm pyeta nëse ka pasur shpenzime nga buxheti i shkollave për mbulimin e obligimeve financiare të drejtorive në përgjithësi. Nuk e specifikova asnjë drejtor, sepse më së paku kam dëshirë të diskutoj mbi supozime. Çdo gjë që flasim duhet të bazohet në dokumentet që i sillni në këtë Kuvend Komunal. Drejtorja e Shërbimeve Publike ka katër ose pesë kontrata aktive në fushën e mirëmbajtjes, në kategorinë mallra dhe shërbime. Unë vlerësoj se drejtori që e ka marrë këtë drejtori është me fat, sepse i ka kontratat aktive, ka mbulueshmëri financiare dhe ka hapësirë të punojë e të realizojë projekte. Po kaloj te kontratat e nënshkruara. Në seancën e kaluar, edhe pse nuk kam qenë e pranishme, e kam lexuar procesverbalin dhe ju përmendët se në vitin 2025 janë nënshkruar kontrata kornizë. Që nga muaji gusht, sistemi financiar është i lidhur me sistemin e prokurimit, dhe kjo është ndër reformat më të mira që ka ndodhur në sistemin financiar të Kosovës. Ai e vendos organizatën buxhetore në obligime dhe çdo kryetar që vjen është i obliguar t'i zbatojë ato. Sa i përket kontratës për Shalën, edhe unë jam nga Shala dhe jam shumë krenare që në buxhetin 2026–2028 i kemi planifikuar të gjitha rrugët për të cilat sot është nënshkruar kontrata. Kjo tregon se kemi vazhdimësi institucionale. Këtu përfshihen rruga e Rashanit, e Kutillovcit dhe e Bajgorës, të gjitha të planifikuara me kodet ekonomike dhe me buxhetin përkatës. Jam shumë e lumtur që sot është arritur të nënshkruhet kjo kontratë, sepse do të përfitojnë qytetarët e këtij qyteti, por edhe banorët e Shalës, prej nga vij edhe unë. Sa i përket fondeve nga niveli qendror, të gjithë e dimë se si funksionon bashkëpunimi ndërinstitucional. Për katër vite me radhë ka pasur kërkesa të vazhdueshme nga Komuna e Mitrovicës, mirëpo projektet që kanë ardhur kanë qenë të kufizuara. E përmendët kontratën

prej 1 milion eurosh. Unë po ju rikujtoj se në vitin 2025, nga vlera e përgjithshme prej 3.2 milionë eurosh, vetëm 100 mijë euro kanë qenë financim nga ministria. Pjesa tjetër, 900 mijë euro, ishte e planifikuar të shpërndahet në dy vitet pasuese, përkatësisht 400 mijë dhe 500 mijë euro. Sa i jep prioritet komuna arsimit, kjo varet nga buxheti komunal. Është e vërtetë që po arrini të siguron investime, fatmirësisht edhe për shkak të përputhjes politike me nivelin qendror. E përmendët Vushtrinë, por edhe ajo nuk po përfiton në masën që pritet. Është vetëm pak minuta larg Mitrovicës dhe nuk ka përfituar, për shembull, as fusha tenisi apo investime të ngjashme nga ministrinë përkatëse. Mbështetja për arsimin matet me buxhetin komunal. Këtë bindje e kam pasur gjithmonë. Sikur të mos kishte qenë analiza buxhetore që e përmendët, këto mjete, të cilat u takonin me ligj shkollave, nuk do të ishin bartur. Këtë e dëshmojnë edhe komunikimet zyrtare me Ministrinë e Financave. Unë kam shumë respekt për zyrtarët dhe analistët e Ministrisë së Financave. Megjithatë, prioriteti i një komune për arsimin shihet atëherë kur, përveç mjeteve që i takojnë me ligj, vendos të ndajë edhe mjete shtesë nga buxheti komunal dhe nga bartja e të hyrave për arsimin. Vetëm atëherë mund të flasim për mbështetje reale. Është shumë mirë që po arrini të siguron projekte nga niveli qendror dhe shpresoj që ato të vazhdojnë të vijnë në Komunën e Mitrovicës. Mirëpo, mbështetja e vërtetë për arsimin matet me buxhetin komunal dhe me vendimin për t'i orientuar mjetet financiare drejt arsimit.

Kryetari Faton Peci: Nëse thua se gjendja në arsimin e Mitrovicës nuk është e mirë, atëherë duhet të kesh parasysh se buxheti është propozuar nga ti, kur ke qenë drejtoreshë. Prandaj, këtu bie pak në kundërshtim me vetveten, sepse nuk i ke buxhetuar të gjitha 37 vendet e punës që sot i konsideron të nevojshme. Sa i përket çështjes së qeverisë, e kam fjalën për ish-qeverinë, jo për qeverinë aktuale. Po e përmend vetëm për ta ilustruar qasjen. Kur kam qenë ministër, kam mbështetur tetë komuna me investime për sistemet e ujitjes. Nga këto, dy komuna kanë qenë të LDK-së, dy të PDK-së, dy të AAK-së dhe dy të Lëvizjes Vetëvendosje. Kjo tregon qasjen që kam pasur si ministër. Investimet kapitale janë shpërndarë në mënyrë të barabartë, pa u bazuar në përkatësinë politike të komunave. Edhe pse pesha politike e komunave nuk ka qenë e njëjtë, kam synuar që secila të trajtohet në mënyrë të barabartë. Gjatë periudhës 2021–2022, sa kam ushtruar detyrën e ministrit, janë mbështetur gjashtë projekte. Fillimisht janë financuar katër projekte, ndërsa më pas edhe dy të tjera. Edhe komunat e udhëhequra nga AAK-ja kanë përfituar, në një nivel të ngjashëm me ato të udhëhequra nga Lëvizja Vetëvendosje, ndërsa numri i komunave të LDK-së dhe PDK-së ka qenë po ashtu i trajtuar në mënyrë të barabartë. Prandaj, nuk pajtohem me qëndrimin se gjithçka varet vetëm nga përputhja e vijës politike. Sigurisht që kjo mund ta lehtësojë komunikimin institucional deri në një masë, por po aq e rëndësishme është këmbëngulja dhe insistimi për të përgatitur e dërguar projekte cilësore dhe për t'i ndjekur ato deri në realizim.

Igballe Islami: Kryetar, siç the edhe ti, as unë nuk të kam menduar ty kur e ke shpërndarë buxhetin nëpër ministri. Unë po flas në përgjithësi për mënyrën se si bëhet planifikimi dhe ndarja e buxhetit. Tash, po dua të ndalem pak te planifikimi i buxhetit që e përmendët. Ju thatë në fillim të fjalës suaj se ministrat shkojnë me kërkesa te Ministri i Financave. Kjo është e kuptueshme, sepse secili sektor paraqet nevojat e veta: aq sa ka nevojë arsimi, aq sa ka nevojë shëndetësia, aq sa ka nevojë një komunë si Mitrovica për investime. Por edhe sikur të kishim buxhetin e kryeqytetit, përsëri do të ishte e vështirë të mbuloheshin të gjitha nevojat. Ne kemi ndarë mjete në përputhje me mundësitë buxhetore dhe, nëse e shohim periudhën nga viti 2022 deri në vitin 2025, kur e kemi dorëzuar mandatin, drejtori i Arsimit mund t'i kërkojë edhe grafikët për investimet kapitale dhe për rritjen e numrit të të punësuarve. Për çështjen e bartjes së stafit mund të diskutojmë veçmas. Mirëpo, edhe nëse një komunë apo një organizatë buxhetore dëshiron ta tejkalojë numrin e të punësuarve gjatë një viti fiskal, në asnjë fazë nuk lejohet nga Ministria e Financave. Kjo çështje është e përcaktuar edhe me ligj.

Nënkryetari Enis Osmani: I kam treguar Igballës dhe të gjithë anëtarëve të KPF-së se nuk ka pasur mjete të shpenzuara nga shkollat për çështjen e luleve. Megjithatë, dua t'ju sqaroj se kanë qenë rreth 200 mijë euro të bartura përkohësisht nga shkollat, për një periudhë të caktuar – një, dy apo tri javë – deri në momentin kur është bërë bartja e mjeteve. Nga këto mjete, rreth 100 mijë euro janë shpenzuar dhe janë bërë pagesa për kompani të ndryshme. Këtu përfshihen kompani si Kompania Regjionale "Uniteti", kompania "Ramadani" SH.P.K., "Eurondërtimi" dhe kompani të tjera. Pra, këto kanë qenë shpenzime në kategorinë

e mallrave dhe shërbimeve. Janë katër ose pesë kompani të cilat janë paguar nga këto mjete, por nuk kanë pasur të bëjnë me çështjen e luleve.

Bajram Istrefi: Përshëndetje, kryetar, nënkryetar, kryesues, kolegë asamblistë, ju të nderuar, ju të ekzekutivit dhe të gjithë të pranishëm. Kryetar, ju përgëzoj për punën që po e bëni në Shalë, veçanërisht për projektin prej 3 milionë eurosh në infrastrukturë, me rreth 23.4 kilometra asfaltim. Sa i përket çështjes së luleve, kjo është një temë që është diskutuar shumë edhe në qytet. Do të doja të di se cila ka qenë vlera, përkatësisht kostoja e tyre.

Xhyljeta Imeri: I nderuar kryetar, dua të ndalem te shkolla "Abdullah Shabani", të cilën e përmendët gjatë diskutimeve. Për mua personalisht, por edhe për prindërit dhe nxënësit e kësaj shkolle, do të ishte një lajm shumë i madh dhe i gëzueshëm nëse jeni duke punuar në këtë drejtim. Sa i përket hapësirës, nëse është çështja e mbarëvajtjes së procesit mësimor, ndërtimi i kësaj shkolle mund të fillojë edhe sot, duke marrë parasysh se prapa shkollës ekziston hapësirë e mjaftueshme për realizimin e punimeve. Pra, organizimi i orëve mësimore mund të bëhet në mënyrën më të mirë të mundshme, pa krijuar probleme për zhvillimin normal të procesit mësimor.

Valon Brahimi: Në kohën e Kryetarit Bedri Hamza, njëri prej ekonomistëve më të mirë, për të mos thënë ndër më të mirët në Kosovë, e kemi bërë rrugën e Shipolit. Qeverisja jonë dhe fjala jonë kanë qenë të njëjta. Ne e kemi realizuar projektin e rrugës "Mbretëresha Teutë" komplet. Edhe rruga e "Lah Nimanit" është realizuar në masën 99%, me disa përfundime të vogla që kanë mbetur. Për këtë mund të përgjigjet drejtoresha e Financave. Po i përmend vetëm disa projekte dhe kërkoj pak durim: çerdhja te Desi, rruga "Fan Noli", "Bislim Bajgora", të gjitha këto rrugë janë realizuar. Është bërë edhe QKMF-ja, ambulancat dhe projekte të tjera. Këto janë realizuar gjatë kohës së qeverisjes së Bedri Hamzës. Tash, për herë të parë, qyteti ka edhe objektin e bibliotekës. Gjithashtu, duhet të shohim edhe gjimnazin. Të gjitha projektet që vijnë nga ministritë dhe ato që i realizoni ju, nëse janë në favor të qytetit, ne i mirëpresim dhe i përkrahim. Mirëpo, dua të them se ju kanë mbetur më pak punë për t'u realizuar, sepse punët e mëdha infrastrukturore janë kryer nga qeverisja paraprake. Ajo që duhet të bëni tani është të vazhdoni me përmirësime të tjera dhe ta zbkuroni qytetin, me projekte më të vogla si gjelbërimi dhe rregullimi i hapësirave publike, sepse infrastruktura kryesore është realizuar. Do t'ju inkurajoja që, para se të bëni investime të tjera, të kërkonit edhe ndihmën e nivelit qendror për ta funksionalizuar palestrën Omnisport, pasi aktualisht ajo është jashtë funksionit. Kryetar, për çdo investim të mirë që vjen nga ministritë në Komunën e Mitrovicës, ne gëzohermi. Mirëpo, kam dëshirë të di se kur do të fillojë ndërtimi i gjimnazit dhe kur pritet të përfundojë. Po ashtu, dua të di kur do të fillojë ndërtimi i Shkollës së Muzikës dhe kur do të përfundojë. Mos më thuaj vetëm se do të përfundojnë brenda mandatit. Qytetarët kanë nevojë që këto projekte të realizohen sa më shpejt. Sa i përket infrastrukturës publike, pavarësisht nëse doni ta pranoni ose jo, faktet në terren tregojnë se pjesa më e madhe e saj është realizuar gjatë qeverisjes sonë. Nuk po them se edhe qeverisja juaj nuk ka shtuar projekte rrugore, sepse ka bërë investime, por pjesa kryesore e infrastrukturës publike në Mitrovicë është ndërtuar gjatë mandatit tonë. Sigurisht, jo gjithçka është përfunduar 100%, pasi kanë mbetur disa çështje që lidhen me shpronësimet. Kryetari e di mirë këtë problem dhe besoj se do ta zgjidhë atë pjesë dhe do ta përfundojë edhe rrugën. Kryetar, gjatë katër viteve të qeverisjes sonë, ministritë nuk na kanë mbështetur në masën që do të kishim dëshiruar. Po të kishim pasur atë mbështetje, do të kishim realizuar edhe më shumë projekte. Prandaj, dua të të shoh edhe ty se çfarë mund të realizosh me kapacitetet dhe angazhimin tënd, pa u mbështetur vetëm në ndihmën e Qeverisë. Atëherë do të shihet edhe forca e kryetarit.

Kryetari Faton Peci: Forca e një kryetari nuk varet vetëm nga buxheti vetanak i komunës. Në fund të mandatit, një kryetar vlerësohet jo vetëm për mënyrën se si e menaxhon buxhetin komunal, por edhe për qasjen e tij proaktive: sa mjete financiare arrin të sigurojë nga Qeveria, sa fonde tërheq nga partnerë të tjerë jashtë institucioneve qeveritare dhe sa investitorë arrin të sjellë në komunë gjatë mandatit të tij. Pra, nuk është çështja vetëm të shohim se sa është buxheti që ka në dispozicion një kryetar. Buxheti komunal është një fakt i dhënë, por performanca e një kryetari matet me aftësinë për të krijuar mundësi shtesë. Ajo vlerësohet nga qasja e hapur dhe proaktive, nga aftësia për t'i bindur ministritë e linjës të investojnë në komunën që ai udhëheq, nga numri i projekteve që sjell përmes organizatave ndërkombëtare dhe nga aftësia për ta bërë komunën atraktive për komunitetin e biznesit dhe investitorët. Për shembull, kjo asamble u ka

dhënë bizneseve 33 kontrata për të ndërtuar dhe zhvilluar aktivitete biznesore në Mitrovicë. Megjithatë, shumë prej tyre e kanë tejkaluar afatin dyvjeçar të implementimit dhe ende nuk kanë realizuar as fazën fillestare të ndërtimit. Kjo tregon se qasja nuk ka qenë mjaftueshëm efektive. Në disa raste është krijuar përshtypja se ka pasur trajtim selektiv dhe preferencial lidhur me atë se kush investon në Mitrovicë. Sa i përket gjimnazit, gjatë këtij viti do të përgatitet projekti ideor dhe projekti detal. Po ashtu, gjatë këtij viti do të planifikohen edhe mjetet buxhetore, ndërsa ndërtimi pritet të fillojë vitin e ardhshëm. Kohëzgjatja e realizimit të projektit do të përcaktohet nga ekspertët dhe inxhinierët e angazhuar nga Ministria e Arsimit. Unë nuk jam inxhinier dhe nuk jap deklaratat pa mbështetje profesionale.

Shkëlqim Ibrahim: Unë, realisht, nga kryetari do të kisha pritur që fillimisht të kërkonte falje, sinqerisht, për një vendim që ka qenë i gabuar. E gjithë kjo temë që po diskutojmë sot ka ardhur si rezultat i një vendimi të gabuar, i cili po përsëritet. Edhe në seancën e kaluar jam munduar t'ju jap këshilla profesionale dhe miqësore, por ju i keni interpretuar si politike. Mjafton ta merrni procesverbalin dhe do ta shihni se vazhdimisht kam bërë thirrje se po gaboni në destinimin e mjeteve. Destinimi i tyre nuk është respektuar. E kuptoj që kjo mund të korrigjohet. Mjetet mund të ridentinohen dhe çështja mund të rregullohet, por kanë kaluar tashmë dy muaj. Prandaj, do të kisha pritur një kërkimfalje, edhe ndaj drejtorit Nasër Maja, i cili praktikisht u vendos në pozitën që të arsyetonte këtë vendim. Vazhdimisht jam munduar t'ju bëj me dije se nuk kemi qenë duke folur për të njëjtën çështje. Prandaj, është mirë që Kuvendi të mos shpërfillet dhe që këshillat profesionale, e jo ato politike, të merren parasysh. Nuk është e drejtë të sillen vendime si të mbyllura, pa u marrë në konsideratë asnjë sugjerim. Sa i përket arsimit, dua t'ju rikujtoj se kur kemi marrë detyrën në ekzekutiv kemi gjetur 62 persona të angazhuar pa konkurs. Për shkak të kësaj gjelcje, Komuna e humbi grantin e performancës për dy vite me radhë, pasi i njëjti konstatim u përsërit në raportet përkatëse. Po ashtu, për herë të parë kemi angazhuar psikologë shkollorë në nivel të Komunës së Mitrovicës. Këtë mund ta konfirmojnë edhe asamblistët. Këto angazhime janë bërë në bazë të procedurave përkatëse. Gjatë mandatit tonë, fatmirësisht, vetëm një drejtor ka pasur probleme me Inspektoratin. Në të kaluarën ka pasur drejtorë të dënuar nga Inspektorati për shkak të parregullsive në procedurat e konkurseve. Madje, një nga personat që kishte bërë ankesë kishte arritur që, si rezultat i saj, të anuloheshin disa konkurse. Pra, po e ritheksoj se kemi gjetur 62 persona të angazhuar pa konkurs dhe pikërisht për këtë arsye Komuna e humbi grantin e performancës për dy vite radhazi. Kjo situatë nuk mund të zgjidhet menjëherë, sepse nuk ishte e mundur të sistemoheshin këta persona pa ndjekur procedurat ligjore. Gjatë mandatit tonë janë zhvilluar procedura të rregullta dhe është respektuar parimi i meritokracisë. Për këtë mund të dëshmojnë edhe drejtori Beshiri dhe drejtori Begu, të cilët janë punësuar si rezultat i procedurave meritore. Sa i përket buxhetit, edhe drejtoresha e Financave e përmendi se janë realizuar investime të mëdha. Në fund, kam vetëm një pyetje për nënkryetarin: A premtoni se mjetet që janë bartur përkohësisht dhe janë shfrytëzuar përkohësisht do t'i kthehen buxhetit të shkollave? Kjo do ta largonte çdo dilemë, sepse ekziston paqartësi nëse kemi të bëjmë me një bartje të përkohshme apo me një shpenzim. Jo secili e kupton terminologjinë profesionale në të njëjtën mënyrë, qoftë asamblistët apo edhe drejtorët e shkollave.

Kryetari Faton Peci: Së pari, dua të jeni të bindur, jo vetëm ju, por secili anëtar i Asamblesë, se kur bën një diskutim, apo edhe kur nuk pajtohet me një pikë të rendit të ditës, unë gjithmonë e analizoj dhe e vlerësoj dobinë publike të një vendimi. Besoni, nuk e shikoj se nga cila parti vjen propozimi. Ju sfidoj: hajdeni me ndonjë propozim konkret. Kemi edhe tre vjet e gjysmë mandat. Hajdeni me propozime konkrete. Dera ime është e hapur për çdo qytetar, e lëre më për ju që jeni të zgjedhurit e qytetarëve. Me fjalë të tjera, hajdeni me propozime konkrete, ju ose secili anëtar i Asamblesë, për tema që i vlerësoni si me interes publik. Po e them publikisht, nuk e di a është duke u incizuar, por qenka edhe kamera. Publikisht po ju jap këtë mundësi. Hajdeni në qeveri, bisedoni me mua, ma mbushni mendjen. Kur ma mbushni mendjen, vini me propozim, e keni të qartë bazën ligjore dhe hajdeni direkt. Sinqerisht, unë jam kryetar i të gjithëve. Ditën kur u shpall rezultati përfundimtar, që nga ai moment e kam marrë këtë përgjegjësi dhe deri në ditën e fundit të mandatit, në fund të vitit 2029, do të jem kryetar i secilit qytetar të Mitrovicës. Edhe secili anëtar i Asamblesë do ta ketë atë mundësi. Prandaj, hiqeni nga mendja se unë e shikoj politikisht atë që diskutohet. Sa i përket çështjes tjetër, në diskutimin paraprak thashë se do ta respektojmë tërësisht planifikimin buxhetor të mjeteve financiare që kanë qenë të destinuara për shkollat dhe arsimin. Tash kjo është lojë fjalësh: a ka qenë

shpenzim, bartje apo huazim. Quajeni si të doni. Unë e thashë se deri në fund, kur ta implementojmë dhe ta realizojmë buxhetin aq sa arrijmë ta realizojmë, të gjitha mjetet financiare që kanë qenë të destinuara për sektorin e arsimit do të rikthehen, qoftë përmes bartjeve, qoftë përmes vendimeve të veçanta, aty ku kjo lejohet, brenda kufizimeve ligjore për secilin titullar të institucionit. Arsimi nuk diskriminohet, sepse e kemi prioritet. Nuk diskriminohet as shëndetësia. Aq më tepër kur po flasim për një shumë prej 2 mijë eurosh, ndërkohë që kemi shërbime dhe detyrime financiare. Këto pagesa janë realizuar, ndër të tjera, edhe për shkak të urgjencës, dëshirës dhe përpjekjes për të parandaluar proceset përmbartimore. Vetëm për katër ose pesë muaj, përmbartuesit kanë marrë mbi 1 milion euro nga buxheti. Këto janë procese që ndodhin. Nuk dua ta gjykoj askënd, sepse edhe pas meje mund të vijë një përmbartues që, për një kontratë apo për një arsye tjetër, do të marrë mjete financiare. Prandaj, mos më kapni për fjale duke thënë: "Edhe ju e keni bërë." Edhe ju e keni bërë. Qëllimi ka qenë i mirë. Shpenzimet kanë ndodhur, në disa raste, pikërisht si përpjekje për të parandaluar që përmbartuesi të na marrë mjete. Sepse kur përmbartuesi i merr, nuk merr vetëm shumën kryesore, por edhe kostot shtesë financiare që rriten me kalimin e kohës. Prandaj, kemi vepruar me urgjencë, për t'i kryer sa më mirë dhe sa më shpejt obligimet, në mënyrë që të mos vonoheshim në afatet që më pas sjellin pasoja financiare. Ne kemi llogaritur se kjo do të kalonte. Në fund ka dalë ai rasti i 2 mijë eurove në shëndetësi, ku një zyrtar ka thënë se nuk bën. E kemi rikthyer dhe do ta korrigjojmë. Por po ta përsëris përgjigjen që e dhashë më herët, ndoshta nuk ishit i përqendruar. Të gjitha mjetet që janë të destinuara për shkollat do të përdoren për shkollat. Ato do të destinohen përmes bartjeve ose formave të tjera, përfshirë edhe vendime plotësuese në të ardhmen.

Kryesuesi i Kuvendit: E hedh në votim Kërkesën për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026.

Rezultati i votimit: 28 anëtarë të pranishëm, 18 për, 9 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se u miratua me shumicë votash Kërkesa për bartjen e të hyrave vetanake të pashpenzuara në vitin 2025 dhe vitet paraprake në vitin 2026.

Pika 3

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027/2029.

Igballe Islami: Singerisht, kur e kam pranuar materialin, kam menduar se është bërë një gabim teknik, pa dashje. Fillimisht e kam fajësuar sekretarinë, duke menduar se na e keni përcjellë Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2026–2028. Mirëpo, vetëm kur e kam parë nënshkrimin e kryetarit Faton Peci dhe titullin "Korniza Afatmesme Buxhetore 2027–2029", jam bindur se dokumenti është i vërtetë dhe nuk bëhet fjalë për një gabim teknik. Madje, edhe në pjesë të referencës së dokumentit ka mbetur shënimi "2026–2028", gjë që tregon qartë se dokumenti as nuk është rishikuar në mënyrë të plotë dhe profesionale para se të procedohej për një seancë të rregullt të Kuvendit Komunal. Mendoj se kjo nuk i shërben seriozitetit dhe trajtimit të duhur të seancave të Kuvendit Komunal. Për më tepër, nuk janë reflektuar as ndryshimet elementare në strukturën organizative të drejtorive. Ju lutem, ju që e keni materialin, referojuni faqeve 15 dhe 16. Nuk dua që askush të ndihet i bullizuar për atë që po them, por në këtë pjesë dokumenti as nuk është serioz dhe as nuk është i saktë. Aty vërehen ende emërtimet e mëparshme dhe pozitat drejtuese të drejtorive komunale. Praktikisht, e vetmja gjë që ka ndryshuar në dokument janë emrat e kryetarit dhe të drejtorëve. Asnjë e dhënë tjetër nuk është ndryshuar. Ky është pothuajse një kopjim i dokumentit të vitit të kaluar. Atëherë unë e kam udhëhequr ekzekutivin për katër vjet, ndërsa tani ekzekutivi ka ndryshuar. Nuk mund të paraqitet një dokument i ri me vizionin tim të mëparshëm. Kryetar, vazhdimisht po e thekson se e ke trashëguar këtë buxhet. Tani do ta kesh rastin jo vetëm ta hartosh, por edhe ta draftosh vetë. Unë, kur e marr Kornizën Afatmesme Buxhetore, që është hapi i parë strategjik drejt hartimit të buxhetit komunal, i cili miratohet në shtator, dhe shoh se edhe vizioni, edhe misioni, edhe objektivat strategjike janë ende ato të qeverisjes së kaluar, atëherë çfarë duhet të presin qytetarët, por edhe ne si Asamble, nga buxheti që do të draftohet? Praktikisht, dokumenti është një kopje pothuajse e plotë e vitit të kaluar. Dhe, meqë po flas, dua ta them qartë se askush nga anëtarët e Asamblesë nuk ka të drejtë të më ndërhyjë në fjalë. Ne kemi qeverisur për katër vjet dhe kam të drejtë ta shpreh atë që mendoj. Nëse dikush ka mendim të kundërt, është i lirë ta

thotë. Edhe atëherë kam pasur të drejtë të bëj opozitë; nëse nuk e kam bërë, kjo ka qenë zgjedhja ime. Nuk kam faj për këtë. Në këtë pikë, unë e kam udhëhequr qeverisjen për katër vjet. Mirëpo, kur ndryshon kryetari dhe e gjithë struktura ekzekutive, në parim do të duhej të ndryshonin edhe misioni, edhe vizioni, edhe objektivat strategjike. Tani duhet të jenë misioni, vizioni dhe objektivat e kryetarit Bedri Hamza. Tash po kaloj te kategoritë ekonomike sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027–2029. Tash, sa i përket buxhetit total, ne e dimë se si ndahet buxheti për komunat, bazuar në formulën e financimit dhe grantin për kokë banori. Siç e kam thënë edhe më herët, edhe sikur ta kishim buxhetin e kryeqytetit, ai përsëri nuk do të ishte i mjaftueshëm për një komunë si Mitrovica, e cila ka shumë nevoja. Mirëpo, unë vlerësoj se ky dokument, sa i përket totalit të buxhetit, ndarja e mjeteve nëpër kategori ekonomike është ekskluzivisht kompetencë e ekzekutivit, në këtë rast e kryetarit të komunës. Për këtë arsye, vlerësoj se kategoria e investimeve kapitale duhet të ketë rritje, sepse komuna e Mitrovicës ka nevojë të vazhdojë me projektet infrastrukturore, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë te qytetarët. Unë po e them përsëri: vendimi është në dorën tuaj. Ju mund ta miratoni këtë dokument, por unë do të vazhdoj të theksoj se ju tashmë keni filluar ta draftoni dhe ta hartoni një buxhet që, në parim dhe që në fillim, vazhdon të mbështetet në misionin dhe vizionin e qeverisjes së Bedri Hamzës.

Khyljeta Imeri: Unë dua të jem konstruktiv, sepse ky është mandati i tretë dhe dua që kjo qasje të vazhdojë edhe më tej. Të njëjtën kritikë e kam bërë edhe më herët. E kam edhe postimin kur e keni sjellë Kornizën Afatmesme Buxhetore, në fillim të mandatit tuaj të parë, dhe kam thënë se është e njëjta kopje e mandatit të kaluar. Këtë desha vetëm ta sqaroj, sepse është diçka që qëndron. Nuk duhet të gjykohej asnjë drejtor, pavarësisht nëse është në pozitë apo opozitë, apo kushdo që është në atë detyrë, sepse vazhdon i njëjti mision dhe vizion. Secili i ka planifikimet e veta, synimet e veta dhe vazhdimisht mendon për atë që është më e mira e mundshme. Për këtë arsye nuk desha të reagoj më herët, por desha vetëm ta sqaroj këtë çështje.

Kryetari Faton Peci: Nëse ti më thua që ky dokument është i njëjtë me ato paraprake dhe më tregon se pse është i keq, ndërsa në fund nuk e votojmë, atëherë kjo do të ishte një kontradiktë shumë e madhe në vetvete. Njerëzit që punojnë në institucione e dinë se Korniza Afatmesme e Shpenzimeve është një nga dokumentet më dinamike që mund të ekzistojë, sepse mbulon një periudhë trevjeçare dhe mundësia e rishikimit, riorganizimit ose ristrukturimit të strukturës së buxhetit është pjesë e vetë natyrës së këtij dokumenti. Më herët ky dokument njihej si Cash. Unë ende kam mbetur më shumë në nivelin qendror, me disa specifika, por tash po flasim për nivelin lokal. Për sa i përket investimeve kapitale, edhe unë kam shumë interes dhe dëshirë që pjesa më e madhe e rritjes së buxhetit të shkojë në investime kapitale. Por jo gjithmonë dëshira dhe mundësia janë në të njëjtën linjë. Për mua do të ishte më mirë që të kishim edhe më shumë investime kapitale. Mirëpo, kur merr përsipër obligime kontraktuale, atëherë duhet të përfshihen edhe mallrat dhe shërbimet, si dhe detyrimet e tjera buxhetore. Për shembull, të paga dhe mëditje nuk kemi pasur mundësi të bëjmë rritje, megjithatë ne e kemi rritur edhe atë kategori. Edhe sikur të sillje 1 miliard euro në Mitrovicë, përsëri do të duhej të trajtoheshin nevojat bazike dhe detyrimet. Pa i trajtuar pagat dhe mëditjet, si dhe pa i siguruar mallrat e shërbimet, nuk mund të funksionojë institucioni. Edhe pse mallrat dhe shërbimet janë kategori buxhetore që në teori duhet të kenë tendencë të ulen, ne nuk kemi mundur t'i eliminojmë, sepse kemi pasur obligime që duhet të përfshihen. Për shembull, kemi pasur edhe 180 mijë euro obligime që duhej të mbuloheshin. Pastaj kemi shpenzimet komunale, ku kanë mbetur obligime të cilat është dashur t'i përfshijmë. Sa i përket çështjes së mëditjeve të stafit të shëndetësisë primare, e cila është përmendur, ne nuk kemi pasur mbulesë për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit paraprak. Këto pagesa është dashur të realizohen, sepse ishin obligime të krijuara. Menjëherë janë paraqitur edhe çështje të tjera, ku është thënë se për disa muaj nuk janë marrë pagesa, por ne kemi qenë të obliguar t'i mbulojmë detyrimet e mëparshme. Në total, bëhet fjalë për rreth 1.6 milion euro, konkretisht 1.626.374 euro. Kemi bërë përpjekje që në mënyrë proporcionale t'i adresojmë nevojat dhe obligimet, duke i harmonizuar dhe përfshirë në buxhet nga fillimi deri në fund. Po të ishte vetëm çështja e investimeve kapitale, edhe unë do t'i kisha futur të gjitha 1.6 milion euro në investime kapitale. Sepse, teorikisht dhe edhe në aspektin ekonomik, investimet kapitale kanë kthim shumëfish më të madh në raport me vlerën e investuar. Nuk dua t'i kontestoj ekspertët dhe shkencëtarët e ekonomisë; jam i prirur t'u besoj njerëzve profesionistë. Sa i përket

kontratave që i përmende, unë mendoj se nuk është problem që janë lidhur kontratat. Përkundrazi, është mirë që janë lidhur. Problemi është mënyra se si janë realizuar ato. Për shembull, në një kontratë është shpenzuar rreth 90% e vlerës për vetëm tre muaj, ndërsa ne duhet të operojmë edhe dy vjet e nëntë muaj me pjesën e mbetur. Në qershor është përmendur se ka pasur fatkeqësi natyrore në Mitrovicë dhe janë shpenzuar rreth 485 mijë euro. Dy bagra kanë hyrë në Lushë ose në Ibër dhe janë shpenzuar afërsisht gjysmë milioni euro. Pyetja është: është mirë që është lidhur kontrata, por si është realizuar ajo kontratë? Sepse, nëse 90% e shpenzimit është bërë në fillim, atëherë neve na kanë mbetur vetëm dokumentet dhe mjetet financiare tashmë të orientuara te operatorët ekonomikë. Për këtë arsye kemi disa dyshime, të cilat do t'i trajtojmë në instancat përkatëse dhe jo në nivel të Asamblesë.

Igballe Islami: Dua të them diçka drejtpërdrejt: ti the se gjatë fjalimit tim ka pasur kontradiktë me vetveten. Unë mendoj se nuk ka pasur asnjë pikë kontradiktore. A e di pse? Sepse qytetarët ju kanë votuar juve për të qeverisur, ndërsa mua qytetarët më kanë votuar në rundin e parë si asambleiste dhe në rundin e dytë kam mbetur asambleiste e opozitës. Kështu që unë tash e luaj rolin tim si opozitare. Nuk mund të shikoj thjesht se a po votojmë ne si PDK apo jo, ose nëse dikush tjetër nuk duhet të votojë. Nëse e shikojmë në mënyrë parimore, atëherë kjo do të nënkuptonte se dokumenti nuk po diskutohet si duhet. Unë po them: nëse na bën neve, si anëtarë të Asamblesë opozitare, të votojmë, atëherë edhe ju duhet ta merrni përgjegjësinë tuaj si pozitë. Sa i përket kategorive ekonomike, në këtë po flasim vetëm për kategori buxhetore, nuk po hyjmë në projekte konkrete. Mirëpo, për kontratën të cilës po i referoheni, atë për pastrimin e lumenjve, ajo është kontratë për emergjencë dhe edhe sot vazhdon të përdoret. Edhe sot po bëhet pastrimi i lumit Trepça dhe lumit Lushta përmes së njëjtës kontratë. Pra, kjo kontratë nuk ka qenë vetëm për një rast të caktuar, por është përdorur si masë parandaluese dhe vazhdon të shfrytëzohet.

Kryesuesi i Kuvendit: E hedh në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027/2029.

Rezultati i votimit: 28 anëtarë të pranishëm, 17 për, 7 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se u miratua me shumicë votash Korniza Afatmesme Buxhetore 2027/2029.

Pika 4

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me Propozim Vendim Për caktimin e Parcelës komunale për Ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit.

Gazmend Asllani: Unë desha vetëm të bëj një ndryshim këtu, sepse është një gabim teknik. Në neni 21, duhet të ceket neni 9, paragrafi 1, pika 1, e cila duhet të fshihet. Gjithashtu, të rregullorja duhet të ceket neni 26. Është edhe një gabim teknik të numri i parcelës, ku një numër është harruar të shkruhet.

Kryesuesi i Kuvendit: Pra të preambula është vërejtja që neni 21 të bëhet neni 9, dhe të fshihet paragrafi 1, pika 1.1. Po ashtu, kur në rregullore bëhet referimi në nenin 26, ai duhet të mbetet, sepse ky nen e precizon çështjen e dhënies ose destinimit të pronave për nevojat e komunës, pra për nevojat të brendshme të saj. Sa i përket numrit të parcelës, bëhet fjalë për parcelën 399, sipas certifikatës së parcelës. Kjo çështje tashmë është rregulluar dhe është harmonizuar me numrin e parcelës në certifikatën përkatëse. Ka qenë thjesht një gabim teknik gjatë përgatitjes së propozimit nga drejtoria.

Igballe Islami: Fillimisht, dua të them se jam shumë pro bashkëpunimit dhe normalisht që për çdo investim që bëhet në komunën e Mitrovicës dhe që do të jetë në interes të qytetarëve të Mitrovicës, edhe si opozitë i gëzohemi dhe padyshim që e mbështesim si nismë. Unë e kam vërejtur bazën ligjore, ku fillimisht është thirrur neni 21, i cili ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim në rast të veçanta. Drejtori e përmirësoi këtë çështje dhe e përmendi tani nenin 9. Unë e shikova shumë shpejt dhe pashë se kjo ka të bëjë me rregullimin e pronës nga komuna, duke u bazuar në nenin 9 të ligjit për dhënien në shfrytëzim. Mirëpo, përsëri mendoj se edhe në seancën e kaluar është marrë një vendim pak a shumë i ngjashëm dhe vlerësoj se këtu duhet të kemi më shumë qartësi. A kemi të bëjmë me dhënie në shfrytëzim të kësaj prone, duke qenë se bashkëngjitur kemi një memorandum me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit? Ky memorandum është i përgjithshëm dhe përfshin katër ose pesë projekte. Në pikën 3.2.4 të memorandumit thuhet se, për secilin projekt, duke qenë se memorandumit është i përgjithshëm dhe faza e implementimit është 2026–

2030, do të përgatitet një aneks i veçantë ku do të përcaktohen lokacioni, çështjet e prokurimit dhe çështje të tjera financiare që lidhen drejtpërdrejt me projektin. Prandaj, pyetja ime është shumë e shkurtër, por mendoj se është e domosdoshme, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me pronë komunale: A po jepet kjo pronë në shfrytëzim për Ministrinë e Sportit dhe Rinisë? A do të jetë investimi i komunës, sa do të jetë pjesëmarrja e komunës dhe sa e ministrisë? Dhe në fund, kur të përfundojë projekti, a do të mbetet prona në pronësi të komunës apo do të kalojë te ministria? Një çështje tjetër që mungon është vlerësimi i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor. Nëse i referohemi ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe rregullores përkatëse në nivel qendror, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor është e obliguar të japë vlerësim, sepse kërkohet që materiali të dëshmojë se parcela i plotëson predispozitat për t'u ndarë dhe për t'u dedikuar për këtë qëllim. Duke e parë këtë parcelë, për të cilën kemi diskutuar edhe me drejtorin në Komitetin për Politikë dhe Financa, ku i kam treguar se ekziston një gabim të numri i parcelës, kam ardhur në përfundimin se ekziston edhe një vendim i Asamblesë Komunale të vitit 2021, ku një pjesë e kësaj parcele është ndarë. Këtu lind një çështje tjetër. Në vendimin e Asamblesë Komunale të vitit 2026 për dhënien në shfrytëzim të parcelave, kjo parcelë është paraqitur si e tëra, pa u marrë parasysh vendimi i mëhershëm i Asamblesë Komunale. Pra, nuk është marrë parasysh ai vendim ekzistues dhe është trajtuar si sipërfaqja totale e parcelës. Gjithashtu, ligji në asnjë pikë nuk parasheh dhënie në shfrytëzim për periudhë të përzemshme. Ligji përcakton periudhë afatshkurtër dhe periudhë afatgjatë. Nga dokumentet që kam siguruar, KF Trepça e ka marrë një pjesë të kësaj prona në vitin 2021 për një afat 20-vjeçar. Prandaj, lind pyetja: a ka hapësirë kohore për dhënien në shfrytëzim dhe kujt do t'i takojë kjo pronë pas përfundimit të investimit? Edhe pse ende nuk ekziston aneksi i veçantë që vetë memorandumit e parasheh, duhet ta kemi parasysh se memorandumit që është sjellë është i përgjithshëm për katër ose pesë projekte, ndërsa në të thuhet qartë se do të përgatiten anekse të veçanta për secilin projekt. Në këtë fazë nuk dihet qartë se kujt do t'i mbetet pronësia, kush do ta menaxhojë atë pronë dhe si do të trajtohet investimi i komunës. Mendoj se ky është problemi që është ngritur edhe në seancën e kaluar dhe e kam përmendur edhe në procesverbal. Sipas mendimit tim, propozuesi ndoshta do të duhej të ishte Drejtoria e Kadastrit, sepse ajo është drejtoria që menaxhon me pronën komunale. Këtu kemi të bëjmë me pronë komunale, jo me një vendim të zakonshëm, siç mund të jetë një subvencion. Kemi të bëjmë me dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Prandaj, duhet të specifikohet baza ligjore dhe afati i dhënies në shfrytëzim, ashtu siç e përcakton neni 6. Nëse shkojmë dhe themi se komuna do ta shfrytëzojë pronën për nevoja të veta, atëherë nuk duhet të bazohemi në ligjin për dhënien në shfrytëzim, por në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Neni 17 përcakton se komuna ka të drejtë të ndajë parcela për nevojat e veta. Në këtë rast, atëherë largohen këto nene dhe këto referenca në rregullore, sepse nuk janë të nevojshme.

Kryetari Faton Peci: Po e qartësoj shumë shpejt: nuk po ia japim kujt do dhe nuk po ia destinojmë ndonjë subjekti tjetër. Kjo pronë po destinohet për nevojat e investimit në infrastrukturën sportive në Mitrovicë. Për herë të parë, Mitrovica do të ketë fusha të tenisit dhe të padelit. Kështu është paraparë edhe në memorandum: pesë fusha të tenisit dhe dy fusha të padelit. Madje, dakordimi me ministrin e Sportit, z. Blërim Gashani, të cilin e falënderoj edhe nga kjo Asamble, është që standardet e këtyre fushave të jenë në atë nivel që, kudo ku organizohen gara të karakterit ndërkombëtar, këto fusha t'i plotësojnë kriteret përkatëse. Në këtë fazë, meqenëse po flitet për aneksin, ai mund të vijë më vonë. Për mua është e rëndësishme që fillimisht të destinohet parcela për këtë investim. Menjëherë pas destinimit fillon hartimi i projektit ideor dhe projektit detal. Investimin 100% do ta bëjë Ministria e Sportit. Pra, këto fusha do të financohen tërësisht nga Ministria e Sportit, ashtu siç do të financohen edhe shumë projekte të tjera deri në vitin 2029. Ndërkohë, nëse lind ndonjë nevojë, për shembull nëse ndonjë klub apo Federata e Tenisit dëshiron që në të ardhmen ta marrë nën menaxhim pjesën e fushave të tenisit, atëherë do të merret një vendim i radhës për dhënien në shfrytëzim. Sot, ne po e destinojmë këtë parcelë për projektet konkrete: pesë fusha të tenisit dhe dy fusha të padelit. Padeli është një sport i ri, shumë inovativ dhe atraktiv, sidomos për të rinjtë, dhe përfitimi për komunën do të jetë i jashtëzakonshëm. Pra, në këtë fazë nuk po japim pronë në shfrytëzim, por po destinojmë një pronë që do të jetë në funksion të investimit në fusha moderne me standarde evropiane për tenis dhe padel. Mendoj se ky do të jetë një prej sporteve që nesër mund të jetë shumë atraktiv për grupe dhe gjenerata të ndryshme të të rinjve, të cilët do të kenë mundësi ta zhvillojnë

aktivitetin sportiv. Besoj se jam i qartë: nuk po japim shfrytëzim, por po e dedikojmë pronën për nevojat e komunës. Në proces, aneksi është paraparë që, në rast se paraqitet ndonjë klub apo federatë që dëshiron ta marrë në menaxhim këtë hapësirë, atëherë të përcaktohen kushtet, mënyra, kohëzgjatja, menaxhimi dhe çështjet e tjera përmes një vendimi përkatës.

Valon Brahimi: Me thënë të drejtën, më ka ikur si detaj kjo çështje, që ekziston një vendim për të njëjtën parcelë. Por, nëse konstatohet se për parcelën e njëjtë ekziston një vendim i mëhershëm, ne jemi pro këtyre projekteve që janë në të mirë të Mitrovicës, por konsiderojmë se propozuesi duhet ta ketë plotësuar pjesën formale, juridike dhe procedurale para se të vazhdohet me procesin e votimit të këtij vendimi. Po e theksoj edhe një herë: kjo është një çështje shumë e rëndësishme. Po e ndal mikrofonin për një moment, sepse vlerësoj se, nëse ekziston një vendim i mëhershëm, fillimisht ai vendim duhet të trajtohet dhe të fuqizohet ose të shfuqizohet, pastaj të vijë propozimi i ri për vendim. Nuk ka logjikë të kemi dy propozim-vendime për të njëjtën pronë, kur realisht ekziston një vendim në fuqi. Kryetar, për të qenë i qartë: nëse për parcelën në fjalë ekziston një vendim i mëhershëm, atëherë ai vendim duhet fillimisht të shfuqizohet, nëse dëshirojmë që të votojmë për këtë propozim-vendim aktual. Mua si detaj më ka ikur kjo çështje nga diskutimi që e dëgjova nga drejtoresha, ish-drejtoresha dhe asambleistja kolege. Nëse ekziston një vendim, ligjërisht ai vendim duhet të shfuqizohet dhe vetëm pastaj ky propozim-vendim mund të kalojë në votim. Kjo është thjesht një çështje logjike juridike dhe nuk kërkon ndonjë përvojë të madhe në këtë fushë. Secili drejtor që ka punuar në drejtori dhe secili anëtar i Asamblesë duhet ta dijë këtë: nuk mund të ketë dy vendime për të njëjtën çështje. Njëri prej tyre duhet të shfuqizohet. Prandaj, nëse ekziston një vendim i mëhershëm, ju lutem verifikojeni dhe silleni këtë pikë në seancën e radhës. Kështu nuk mund të vazhdohet. Ne e dimë që nëse ekziston një vendim në fuqi, ai duhet të shfuqizohet. Nëse nuk ekziston, atëherë vazhdojmë me procedurën. Pra, kryetar, unë po them vetëm këtë: nëse ka një vendim, sepse kështu e dëgjova nga asambleistja, por nuk jemi ende të sigurt.

Nazmi Kelmendi: Një informacion teknik, pa dashur të hyj në detaje profesionale: Bëhet fjalë për parcelën 399-6, në zonën kadastrale Zhabar i Poshtëm. Vendimi që ka kaluar në Asamblesë Komunale ka qenë për ndarjen e kësaj parcele. Nga ajo ndarje është krijuar një parcelë e re, e cila në Drejtorinë e Urbanizmit figuron si parcela 399-5. Pika kryesore është që sot të kalojë vendimi për fushat e tenisit. Më pas vazhdojnë procedurat që parashihihen me Drejtorinë e Urbanizmit për ndarjen dhe trajtimin e parcelës përkatëse. Kjo është gjendja aktuale, bazuar në informacionet që i kemi shkëmbyer me Drejtorinë e Urbanizmit. Pra, ekziston një vendim i mëhershëm i Asamblesë Komunale që lidhet me parcelën 3996, pas të cilit janë zhvilluar procedurat e nevojshme nga Drejtoria e Urbanizmit. Si rezultat, është krijuar parcela 3995, e cila është paraparë për një destinim tjetër, ndërsa tani është planifikuar krijimi i një parcele të re pas vendimit të Asamblesë Komunale. Këto janë detajet teknike që i kemi trajtuar.

Valon Brahimi: Nëse ekziston një vendim i mëhershëm, fillimisht duhet ai vendim të shfuqizohet, ose të bëhet ndarja e parcelës dhe të na sillen këtu skica që dëshmon se është bërë ndarja fizike e parcelës. A na është sjellë skica që tregon ndarjen fizike të parcelës? Nëse po, atëherë jemi në rregull. Vetëm dua të jem i sigurt si Kuvend që nuk ka asnjë paqartësi në këtë çështje. Për ne nuk ka dallim se kush përfiton nga ky investim. Ajo fushë do të shfrytëzohet nga të gjithë: nga qytetarët, nga pozita, nga opozita, nga shqiptarët, turqit dhe të gjithë qytetarët e Mitrovicës që jetojnë këtu. Ajo që kërkojmë është vetëm të jemi ligjërisht në rregull dhe të mos kemi dy vendime për të njëjtën parcelë. Kjo është kërkesa dhe esenca e çështjes: ta sqarojmë dilemën. Nëse nuk ka më dilemë, atëherë vazhdojmë pa problem.

Gazmend Asllani: Ajo parcelë ka qenë ndarë më herët, ku një pjesë e saj është ndarë për fushat e futbollit dhe për klubin futbollistik Trepça. Pra, nga ajo parcelë është krijuar një parcelë e veçantë, e cila tash i takon pjesës së destinuar për Trepçën. Sa i përket ndarjes fizike, po, edhe ajo është bërë. Tash është procedurë që lidhet me kadastrën, certifikatën e pronës dhe dokumentacionin përkatës. E kuptoj shqetësimin dhe po dua vetëm ta sqaroj: pjesa që ka mbetur nga parcela pas ndarjes për fushën e futbollit është ndarë më pas për fushat e tenisit dhe fushat e padelit. Të gjitha procedurat janë ndjekur së bashku me drejtorin përkatës dhe gjithçka është në rregull. Nëse ka ndonjë çështje apo ndonjë gabim eventual, atëherë e evidentojmë dhe e korrigjojmë. Por, sipas informacioneve që kemi, nuk besoj se ka ndonjë problem në këtë rast.

Ardian Kavaja: Atëherë, e pashë që asambleistja, zonja Igballi, e kishte ngritur shqetësimin lidhur me atë parcelë, për një vlerësim apo çështje të ngjashme. Drejtoria e Urbanizmit e ka shqyrtuar këtë çështje dhe, sa i përket destinimit të parcelës, ajo është e përcaktuar për shfrytëzim të përzier dhe aktivitete të ndryshme sportive. Prandaj, sa i përket destinimit, nuk kemi asnjë problem. Meqenëse kjo parcelë ka qenë edhe më herët pjesë e diskutimeve në Kuvendet e mëparshme, mund të themi se destinimi është në rregull. Sa i përket Drejtorisë së Urbanizmit, nuk ka ndonjë pengesë, sepse destinimi i saj është përcaktuar për shfrytëzim të përzier dhe aktivitete sportive.

Igballe Islami: Do të doja vetëm një sqarim shumë të shpejtë. Meqenëse drejtori e ndryshoi bazën ligjore, pra nga ajo që lidhej me raste të veçanta, ku unë kisha menduar të kërkoja edhe kërkesën formale nga ministri i Sportit dhe Rinisë, tani dua të ndalem vetëm te çështja e parcelës. Drejtori i Kadastrit tha se e kemi ndarjen e parcelës. Unë, nëse e marrim këtë vendim, besoj se edhe sekretaria mund të ketë qasje të shpejtë, sepse edhe unë e kontrollova vendimin që kemi marrë për përcaktimin e pronave të cilat do të jepen në shfrytëzim. Në atë vendim, kjo parcelë figuron me sipërfaqe të përgjithshme prej 58 mijë e 65 metra katrorë. Drejtor, kjo do të thotë se te parcela 3996 nuk është marrë parasysh vendimi i Asamblesë Komunale i vitit 2021, me të cilin 18 mijë metra katrorë i janë ndarë KF Trepçës për një periudhë 20-vjeçare. Ajo që dua ta kuptoj është: kjo parcelë ka pasur rreth 58 mijë metra katrorë, prej të cilave 18 mijë janë ndarë për KF Trepçën për 20 vjet, ndërsa sot po propozohet që një pjesë tjetër, rreth 10 mijë metra katrorë, të destinohet për fushat e tenisit. Unë u ktheva pak në retrospektivë, sepse edhe më herët kam pasur disa dyshime rreth kalimit të asaj pike. Tani, kur e pashë këtë vendim që është në fuqi, shqetësimi im është se duket sikur është marrë për bazë vlera dhe sipërfaqja e përgjithshme e pronës, pa u marrë parasysh vendimi i mëhershëm i Asamblesë Komunale. Drejtori i Urbanizmit tha se prona është shqyrtuar dhe i plotëson kriteret. Mirëpo, unë dua që kjo të jetë e reflektuar në dokumentacion. Unë mund ta vlerësoj se drejtorët kanë diskutuar dhe kanë ardhur në përfundim se kjo mund të destinohet për aktivitete sportive ose kulturore, por ne këtu marrim vendime mbi bazën e dokumenteve të shkruara dhe raporteve zyrtare që na sillen. Nuk mund të mbështetemi vetëm në atë që është diskutuar mes drejtorëve, sepse atëherë lind pyetja: ku mbetet serioziteti i procesit të vendimmarrjes?

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimi i cili është marrë në Kuvendin e Komunës për dhënien në shfrytëzim të parcelës në fjalë ka qenë për rreth dy hektarë, konkretisht 1.8 hektarë. Pra, nuk ka qenë për tërë sipërfaqen e parcelës, por vetëm për atë pjesë prej 1.8 hektarësh. Sa i përket bartjes së vendimit, ai nuk ka mundur të bartet në kadastër përderisa nuk ka pasur një marrëveshje të nënshkruar ndërmjet ministrisë dhe komunës. Në bazë të asaj marrëveshjeje, drejtoria e merr përsipër procedurën e emërimit dhe bartjes së parcelës. Deri tani kjo nuk është realizuar, pasi marrëveshja ndërmjet komunës dhe ministrisë është bërë kohët e fundit. Tani kjo është çështje procedurale dhe pritet të realizohet. Unë, për të qenë i saktë, jam bazuar në hapësirën për të cilën kemi diskutuar edhe me drejtorin e Kulturës dhe drejtorin e Kadastrit. Pra, sipërfaqja totale e parcelës është rreth 58 mijë metra katrorë. Nga kjo sipërfaqe, pjesa tjetër prej rreth 10 mijë metrash katrorë është paraparë për ndërtimin e këtyre fushave. Ndërsa pjesa tjetër është planifikuar dhe destinuar për fushat e Trepçës. Këto dy çështje nuk bien ndesh me njëra-tjetrën, sepse në propozim-vendim është përcaktuar qartë se merren 10 mijë metra katrorë nga sipërfaqja totale e parcelës dhe është bashkëngjitur edhe skica orientuese. Për çështjet e tjera profesionale, besoj se drejtoria përkatëse mund të japë sqarime më të hollësishme. Sa i përket çështjes së ngritur nga zonja Igball, mendoj se duhet ta sqarojmë edhe një parim të rëndësishëm: nëse kjo parcelë përcaktohet për nevojat e komunës, atëherë vazhdoj të besoj se nuk ka nevojë të jetë pjesë e listës së pronave që jepen në shfrytëzim. Duhet ta sqarojmë këtë, sepse po krijohen disa paqartësi. Këtu nuk bëhet fjalë për dhënie në shfrytëzim të një prone tjetër; thjesht po përcaktohet një pjesë e pronës së komunës së Mitrovicës për një destinim të caktuar. Pra, vetëm po i caktohet destinimi kësaj pjesë prej 10 mijë metrash katrorë për këtë nevojë dhe kjo është çështja që duhet të rregullohet edhe në preambulë, pasi të njëjtën çështje e kemi ngritur edhe në Komitet. Po, besoj se me këto sqarime e kemi qartësuar çështjen.

Jeton Ujkani: Vetëm desha ta ndihmoj sqarimin e çështjes: kjo nuk po bëhet për dhënie në shfrytëzim, sepse nuk po i jepet askujt. Kjo mbetet pronë komunale dhe përsëri do të jetë pronë komunale. Këtu mund të bëhet riedestinimi i pronës për shfrytëzim në funksion të sportit dhe kaq. Pra, nuk ka transferim të

pronësisë dhe nuk ndryshon pronari. Është pronë komunale, vetëm se i ndryshohet destinimi për sport. Sipas vendimit që e pashë, i cili është marrë në muajin e tretë të vitit 2026, bëhet fjalë pikërisht për këto 10 mijë metra katrorë, pjesë e parcelës së komunës, e cila do të shfrytëzohet nga komuna për këtë qëllim. Nuk ka nevojë ta komplikojmë më shumë çështjen.

Valon Brahim: E dëgjova diskutimin për hapësirën ku po flasim, si dhe e dëgjova edhe diskutimin e kolcgut. Nëse bëhet ridestinimi, atëherë duhet të vijë një propozim i veçantë për ridestinim, sipas procedurës përkatëse. Por kjo nuk do të thotë që ne jemi kundër kësaj çështjeje. Përkundrazi, unë jam shumë në favor të këtij projekti. Ne vetëm duam që vërejtjet dhe gjetjet tona të kontribuojnë në qartësimin e situatës. Personalisht jam shumë i interesuar që ky projekt të realizohet, sepse Mitrovicës i nevojiten shumë këto fusha. Por ajo që na duhet është qartësia juridike, që në fund të procesit të jemi të sigurt. Drejtor, nëse ka mundësi, deri në fund të seancës, në mënyrë që të mos e vonojmë këtë pikë, të sigurohet nga zyrtarët ndarja fizike e parcelës, që ne ta kemi të qartë dhe të sigurohemi ligjërisht. Ne nuk kemi asgjë kundër këtij projekti. Jemi plotësisht pro kësaj pune, pro sportistëve dhe pro zhvillimit. Vetëm duam që çështja të jetë e qartësuar.

Kryesuesi Safet Kamberi: Atëherë, besoj se të gjithë e dimë që një parcelë nuk mund të ndahet pa një vendim të Kuvendit të Komunës. Ne aktualisht e kemi parcelën totale me numrin përkatës. Duhet të kemi një vendim që mundëson procedurën e ndarjes dhe bartjes në kadastrë, në mënyrë që të mos krijohet ndonjë mospërputhje mes dokumenteve. Prandaj, besoj që këtë çështje ta lëmë deri në fund të seancës. Deri atëherë të sigurohen informatat shtesë dhe pastaj ta hedhim këtë pikë në votim. Kjo çështje nuk duhet të mbetet e paqartë për shkak të çështjeve procedurale. Drejtor, vetëm po kërkojmë që ta sqarojmë përfundimisht dhe të sigurohemi që preambula është rregulluar.

Gazmend Asllani: Nuk kam zyrtar ligjor në drejtori fare dhe duhet të merrem vetë me të gjitha çështjet, për shkak të mungesës së zyrtarit ligjor. Prandaj, edhe për gabimet teknike që mund të ndodhin duhet të kemi mirëkuptim dhe t'i kemi parasysh edhe këto rrethana. Nëse ju e ngritni çështjen e bazës ligjore apo të ministrisë, atëherë duhet ta diskutojmë edhe atë pjesë. Por nëse jeni pro kësaj çështjeje, atëherë duhet ta trajtojmë edhe me këtë qasje.

Kryesuesi theksoi se votimi për Propozim Vendimin Për caktimin e Parcelës komunale për Ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit do të bëhet gjatë mbledhjes.

Pika 5

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin lidhur me Rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore.

Xhylljeta Imeri: Kam një vërejtje lidhur me formulimin e kësaj kërkesë. Në dokument thuhet se nevojat në arsim do të mbulohen përmes bartjes së stafit nga drejtoritë komunale. Mirëpo, sipas asaj që është paraqitur në tabelë, nuk bëhet fjalë për bartje të punonjësve nga këto drejtori për të punuar në arsim, por për bartje të numrit të pozitave të aprovuara në DKA. Këto janë dy çështje krejtësisht të ndryshme. "Duke qenë se po flasim për bartjen e 19 pozitave në DKA, kërkoj që brenda ketyre pozitave të përfshihen edhe profilet që janë të domosdoshme. Konkretisht, kërkoj që të parashihen pozita përpsikologë, asistentë për fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe stafi i nevojshëm për funksionalizimin e çerdhes së ndertuar tek ish "Desi". Duke marrë parasysh se mjetet buxhetore përkëto pozita kanë qenë të planifikuara. Prandaj, është e arsyeshme që këto pozit të përfshihen në kuadër të 19 vendeve të punës qëpo barten, në mënyrë që t'u përgjigjemi nevojave reale të qytetarëve.

Igballe Islami: Fillimisht, kur kjo pikë është diskutuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bashkë me nënkryetarin, kemi diskutuar edhe me drejtorin e Arsimit. Atëherë kam thënë se kjo pikë më shumë i ngjan një komunikimi ndërmjet Drejtorisë së Arsimit dhe kryetarit të komunës, ku drejtori paraqet një kërkesë, ndërsa kryetari e miraton atë, sesa një propozim-vendim të mirëfilltë. Vetë fakti që në arsytim thuhet se vendimi është bazuar në kërkesën e arsyetuar të Drejtorisë së Arsimit, më ka shtyrë që në Komitetin për Politikë dhe Financa të kërkoj qasje në atë kërkesë të arsyetuar, në mënyrë që ta dimë saktësisht për çfarë bëhet fjalë. Ne kemi informacion se pozitat po barten nga drejtori të ndryshme

komunale, si nga Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare. Prandaj duhet ta dimë saktësisht cilat pozita po barten, cilat profile dhe cilat konkurse do të hapen për këto vende pune. Thjesht, duhet ta kemi të qartë se ku po shkojnë këto pozita. Në këtë formë, kemi një propozim-vendim të kryetarit pa një bazë të qartë dokumentare. Për këtë arsye kam kërkuar që këtij materiali t'i bashkëngjitet edhe kërkesa e arsyetuar e Drejtorisë së Arsimit. Ne i bëjmë këto kërkesa në Komitetin për Politikë dhe Financa pikërisht për të kontribuar në proces dhe për të shmangur diskutimet e gjata në seancën e Kuvendit Komunal. Nëse në Komitet kërkoj një sqarim ligjor, këtë e bëj që ta kem të qartë bazën juridike dhe të mund ta verifikoj vetë se në cilin ligj apo rregullore mbështetet ky propozim-vendim. Pra, duhet të na sigurohet jo vetëm se ekziston një kërkesë e arsyetuar nga drejtoria, por edhe se në cilën dispozitë ligjore apo nënligjore mbështetet e drejta për një bartje të tillë. Një çështje tjetër që kam ngritur dhe që nuk është adresuar është disponueshmëria financiare. Ne po flasim për bartjen e numrit të pozitave, por nuk po flasim për bartjen e mjeteve buxhetore që i shoqërojnë ato. E dimë se 19 pozitat që aktualisht janë të buxhetuara në administratën komunale, pas bartjes do të krijojnë barrë financiare në kuadër të Drejtorisë së Arsimit. Për të hapur një konkurs të rregullt rekrutimi nuk mjafton vetëm ekzistenca e një pozite të lirë; kërkohet edhe disponueshmëri financiare. Prandaj, nëse po bartim vetëm numrin e pozitave, duhet të dimë nëse ekziston edhe mbulimi financiar që Drejtoria e Arsimit të mund t'i zhvillojë procedurat e rekrutimit. Po ashtu kam ngritur edhe çështjen nëse është bërë një analizë e mirëfilltë për pozitat që po barten. Askush këtu nuk e vë në dyshim rëndësinë e arsimit dhe nevojën që çdo nxënës ta ketë mësimdhënësin në klasë, ashtu siç kërkon udhëzimi administrativ. Megjithatë, duhet të dimë nëse është analizuar ndikimi i bartjes së këtyre pozitave në drejtorinë nga të cilat ato po merren. Për shembull, numri i zjarrfikësve përcaktohet sipas territorit dhe nivelit të rrezikshmërisë së komunës. Nëse barten gjashtë pozita nga Shërbimi i Zjarrfikësve, duhet të dimë se çfarë ndikimi ka kjo në funksionimin e atij shërbimi. Po ashtu, njësia e auditimit të brendshëm ka mbetur vetëm me një drejtor për shkak të pensionimit. Nëse edhe pozita e lirë bartet në një drejtori tjetër, atëherë po dobësohet edhe më shumë kontrolli i brendshëm financiar i komunës. Një tjetër çështje është fakti se arsimit dhe shëndetësia financohen nga grante specifike. Bartja e pozitave nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Drejtorinë e Arsimit krijon ndërveprim mes dy granteve specifike, të cilat e përcaktojnë numrin e stafit sipas kriterëve të ndryshme: njëri sipas nevojave të sistemit shëndetësor, tjetri sipas numrit të nxënësve. Pa dashur ta paragjykoj mënyrën se si drejtori e ka menaxhuar situatën deri më tani, ne e dimë që ka pasur mungesë të mësimdhënësve, si në arsimin fillor ashtu edhe në atë të mesëm. Megjithatë, nëse thuhet se normat janë të përmbushura sipas qarkores buxhetore, atëherë duhet ta shohim edhe vetë atë qarkorë. Pikërisht për këtë arsye kam kërkuar në Komitetin për Politikë dhe Financa që ajo të na vihet në dispozicion. Sipas qarkores së parë buxhetore për vitin 2027, për shkak të uljes së numrit të nxënësve parashihet edhe zvogëlim i numrit të mësimdhënësve. Kjo nënkupton se mund të ketë nevojë për riorganizim dhe plotësim të normave, e jo domosdoshmërisht për shtim të pozitave. Nëse qarkorja buxhetore tregon se numri aktual i mësimdhënësve është i mjaftueshëm dhe për vitin 2027 parashihet zvogëlim i afërsisht 100 mësimdhënësve, atëherë këto janë të dhëna që duhen analizuar seriozisht. Natyrisht, mund të ketë ndryshime me qarkoren e dytë, por kjo mbetet për t'u diskutuar më tej. Prandaj, ajo që kam kërkuar gjatë gjithë kohës ka qenë vetëm një konfirmim i qartë ligjor dhe financiar, në mënyrë që të shmangen të gjitha këto dilema dhe polemika.

Kryetari Faton Peci: Ju ngritët disa tema dhe shumë prej tyre janë interesante, por kërkojnë edhe sqarime shtesë. Së pari, sa i përket çështjes që e ngriti asambleistja e LDK-së, zonja Xhyljete, dua ta sqaroj se aty bëhet fjalë për një lëshim teknik. Nuk po bartet stafi. Pra, ta kemi të qartë që në fillim: nuk po flasim për bartje të stafit, por për bartje të pozitave, përkatësisht të numrit të pozitave që kanë qenë të planifikuara në administratë dhe që tani po i dedikohen Drejtorisë së Arsimit. Arsyeja pse po i dedikojmë këto pozita arsimit është se vazhdimisht është ngritur pyetja se ku janë pozitat e munguara. Unë kam dhënë një zotim publik për përfshirjen e asistentëve dhe psikologëve në sistemin arsimor, sepse vlerësoj që Mitrovica e ka gjendjen më të vështirë në Kosovë në sektorin e arsimit. Kjo lidhet, para së gjithash, me përfshirjen e fëmijëve në arsimin parashkollor, por edhe me problemet e tjera strukturore që janë grumbulluar ndër vite. Përveç problemeve sistematike që kanë ekzistuar për më shumë se 20 vjet, është edhe historia e zhvendosjes së shkollave brenda qytetit. Nuk dua të ndalem te kjo pjesë, por edhe ajo ka ndikuar në gjendjen që kemi

sot. Për këtë arsye po bëjmë përpjekje maksimale për një riorganizim të pozitave. Sa i përket kornizës buxhetore, planifikimin e bën organizata buxhetore. Brenda organizatës buxhetore përfshihen zjarrfikësit, mësimdhënësit, punonjësit shëndetësorë dhe administrata komunale. Nga njëra anë, me të drejtë po i referoheni ligjeve dhe udhëzimeve administrative që garantojnë se çdo nxënës duhet ta ketë mësimdhënësin në klasë. Nga ana tjetër, po i referoheni edhe qarkores buxhetore, e cila parashihet ulje të numrit të punonjësve në arsim. Ndërkohë shtrohet edhe pyetja se ku janë mungesat e mësimdhënësve. Këto janë çështje që secila e ka logjikën e vet. Sfida jonë është t'i harmonizojmë pozitat, buxhetin dhe nevojat reale, në mënyrë që të arrijmë zgjidhjen më të mirë të mundshme. Në këtë fazë, unë kam prirje që, në njëfarë mënyre, t'i sakrifikoj disa pozita të lira nëpër drejtori, duke mos i plotësuar ato për momentin, por duke i orientuar drejt sistemit arsimor, sepse aty nevoja është më e madhe. Në fund të fundit, aty janë fëmijët tanë. Ndërkohë synojmë të bëjmë edhe një riorganizim në zonën e Shalës së Bajgorës. Kam planifikuar një ristrukturim të numrit të mësimdhënësve dhe nxënësve. Nuk është e qëndrueshme që një shkollë të ketë tetë nxënës dhe dymbëdhjetë mësimdhënësit. Për ta bërë këtë riorganizim, fillimisht duhet të hartojmë buxhetin. Gjatë hartimit të tij bëhet analiza paraprake: sa nxënës ka secila shkollë, sa mësimdhënës ka dhe cilat pozita mund të riorganizohen. Përveç kësaj, riorganizimi do të kërkojë edhe planifikimin e transportit të nxënësve dhe organizimin e mësimi gjithëditor, gjë që do të sjellë kosto shtesë financiare. Vetëm mësimi gjithëditor, së bashku me sigurimin e ushqimit, sipas përllogaritjeve tona do të kushtojë rreth 462 mijë euro. Prandaj, për momentin duhet të ndërhyjmë aty ku vlerësojmë se nevoja është më e vogël, për t'i orientuar burimet aty ku nevoja është më e madhe. Edhe zjarrfikësit janë jashtëzakonisht të rëndësishëm. Për këtë arsye kam marrë iniciativën për krijimin e një grupi vullnetarësh dhe jam shprehur publikisht se do të jem edhe vetë pjesë e këtij angazhimi. Dua t'u tregoj qytetarëve se angazhimi im është maksimal. Madje kam planifikuar të qëndroj edhe gjatë natës në zonën e Kodrës së Cërnushës, në periudhat me rrezik më të madh nga zjarret, së bashku me ekipet përkatëse, me ujësjellësin, Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe kamionët me ujë, për të parandaluar përhapjen e zjarreve. Në vitet '90 kemi bërë roje për arsye të tjera. Sivjet kam vendosur të bëj roje për t'u përballur me rrezikun e zjarreve. Më shumë se kësaj nuk besoj se mund të bëjë një kryetar komune. Po ashtu, po bëjmë analizë edhe për sistemin e hidrantëve dhe burimet e ujit. Për këtë vit kemi paraparë masa emergjente, ndërsa do të kërkojmë edhe mbështetjen e KFOR-it si masë parandaluese. Qëllimi nuk është t'i kërkojmë helikopterët vetëm kur zjarri të ketë dalë jashtë kontrollit, por të hartojmë paraprakisht një plan të përbashkët, sepse parandalimi është gjithmonë më i mirë sesa sanimi i pasojave. Prandaj, në parim, ju keni të drejtë në vërejtjet që ngrini. Megjithatë, ne jemi përballë nevojës për të marrë vendime. Për mua është më e arsyeshme që, për momentin, disa pozita të lira në administratë të orientohen drejt arsimit, në mënyrë që të mos lejojmë përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes në këtë sektor dhe të krijojmë hapësirë për një riorganizim dhe planifikim më të mirë të nxënësve, mësimdhënësve dhe buxhetit. Dhe, në fund, dua ta sqaroj edhe një çështje: me bartjen e pozitave bartet edhe buxheti përkatës. Pra, barten edhe linjat buxhetore. Kjo është një çështje parimore dhe ligjore, dhe me të drejtë e keni ngritur si shqetësim.

Valon Brahim: Po, shkresa që na ka ardhur e pashë se është pa preambulë dhe kjo më bëri të interesohem se si po zhvillohet ky proces. Mendoj se do të ishte mirë të shfrytëzohej zyrtari i Zyrës Ligjore, i cili është një jurist shumë i përgatitur, për t'i trajtuar këto çështje. Unë kam disa dilema juridike lidhur me mundësinë e bartjes së pozitave ndërmjet kategorive të ndryshme të punësimit. Ligji për Zyrtarët Publikë i përcakton qartë kategoritë e punësimit. Për shembull, nuk kam dilemë që nga Drejtoria e Financave mund të barten dy pozita në Drejtorinë e Kadastrit, pasi bëhet fjalë për të njëjtën kategori të shërbimit civil. Megjithatë, në këtë rast po flasim për bartje të pozitave nga administrata komunale drejt arsimit, ku bëhet fjalë për kategori të ndryshme. Mësimdhënësit janë pjesë e shërbimit publik, ndërsa punonjësit e administratës komunale janë pjesë e shërbimit civil. Për këtë arsye, më intereson të di nëse është sqaruar juridikisht kjo çështje. E pashë se propozues i vendimit është Kryetari i Komunës dhe jo drejtori, prandaj kërkoj një sqarim nga Kryetari: a ekziston bazë ligjore për një bartje të tillë ndërmjet këtyre kategorive? Kjo është e rëndësishme që më vonë të mos ketë probleme të natyrës ligjore gjatë procedurave në ministri. Po ashtu, vërejta se në preambulë nuk është cituar asnjë bazë ligjore mbi të cilën mbështetet propozimi.

vendimi. Prandaj, do të dëshiroja një sqarim të qartë nga Kryetari nëse ekziston ndonjë dilemë juridike lidhur me këtë çështje.

Kryetari Faton Peci: Ne kemi kërkuar interpretim ligjor për këtë çështje. Baza ligjore që na është përcjellë nga Zyra Ligjore është Ligji Nr. 10/L-001 për Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Konkretisht, është referuar neni 11, që rregullon limitet në zotime dhe shpenzime, pika 2, si dhe neni 14 i këtij ligji. Ky është interpretimi ligjor që na është ofruar nga Zyra Ligjore, pas konsultimit të kryer.

Shkëlqim Ibrahim: Kryetar, a do të ishte e mundur që, si praktikë, opinioni i Zyrës Ligjore dhe ai i Zyrës Kryesore Financiar (ZKF) t'u bashkëngjiten të gjitha dokumenteve? Mendoj se kjo do të ishte një praktikë e mirë. Në këtë mënyrë edhe ne informohemi më mirë dhe shmangen dilemat që lindin gjatë shqyrtimit të materialeve. Kur dokumentet vijnë pa opinionin e Zyrës Ligjore dhe pa konfirmimin e ZKF-së, është normale që të ngremë pyetje dhe shqetësime, sepse raste të tilla nuk kanë ndodhur më parë. Prandaj, kërkoj që në çdo dokument të bashkëngjitet opinioni i Zyrës Ligjore, si dhe të evidentohen konsultimet e zhvilluara me ZKF-në. Bësoj se kjo do të ndihmonte në rritjen e transparencës dhe do të na jepte më shumë siguri gjatë vendimmarrjes. Edhe herën e kaluar pati një rast ku në dokument ishte përcaktuar fituesi dhe çmimi, pa qenë i zhvilluar ende procedura e prokurimit. Për shkak të ndjeshmërisë së çështjes dhe në mirëkuptim me shefat e grupeve parlamentare, vendosëm të mos e bënim temë diskutimi. Nuk dua të ndalem te ai rast apo të përmend ndonjë vendim konkret. Prandaj, ju lutem që dokumentet të verifikohen paraprakisht para se të sillen në Kuvend, pasi këto janë çështje të ndjeshme, veçanërisht nga aspekti ligjor.

Kryetari Faton Peci: Si Kryetar i Komunës, ka vetëm një kategori dokumentesh që i nënshkruaj pa c lexuar përmbajtjen: kërkesat për qasje në dokumente zyrtare dhe publike. Kur stafi më paraqet një kërkesë për qasje, unë e nënshkruaj menjëherë. Këtë ua kam bërë të qartë të gjithë drejtorëve dhe stafit që në ditën e parë kur kam marrë detyrën. U kam thënë se çdo qytetar, çdo gazetar dhe çdo asamblist, nga dita e parë dori në ditën e fundit të mandatit tim, ka të drejtë të marrë qasje në dokumente. Kushdo që kërkon qasje, nuk duhet të presë. Nëse nuk mund të përgjigjem po atë ditë për shkak të angazhimeve jashtë komunës, kërkesa trajtohet menjëherë ditën pasuese. Për mua, kërkesat për qasje miratohen pa dallim. As nuk e lexoj emrin e kërkuarit dhe as nuk shikoj se kush është. Edhe një herë u bëj thirrje drejtorëve që të kenë kujdes në këtë drejtim. Kushdo që kërkon qasje në lëndë, procedura, vlerësime apo dokumente të tjera që lidhen me qeverisjen komunale, duhet ta ketë atë qasje. Përgjegjësia përfundimtare bie mbi mua dhe, për këtë arsye, unë i miratoj këto kërkesa automatikisht. Kur vjen dita e nënshkrimeve, ndonjëherë edhe me qindra dokumente, gjithmonë kërkoj që kërkesat për qasje të më vendosen të parat për t'i nënshkruar. Çdo cent i buxhetit të komunës duhet të jetë transparent. Kushdo që shpreh interesim ka të drejtë të marrë sqarime se si janë shpenzuar mjetet publike. Në këtë çështje nuk bëj kompromis me askënd. Prandaj, kushdo që ka interes apo paraqet kërkesë për qasje në dokumente, do ta ketë mbështetjen time dori në ditën e fundit të mandatit. Çdo qytetar ka të drejtë të vijë, të shohë dokumentacionin dhe të kërkojë informacione për mënyrën e shpenzimit të çdo centi të buxhetit komunal.

Igballë Islami: Kryetar, më ka mbetur edhe një çështje që do të doja ta sqaroj. Ne e dimë se nga cilat drejtori po barten pozitat, por meqenëse nuk kemi pasur qasje në kërkesën e Drejtorisë së Arsimit, a mund të na informoni se për cilat pozita dhe për cilat profile apo lëndë do të hapen këto konkurse? Po ashtu, dua ta ndërlihd edhe me çështjen e qasjes në dokumente zyrtare. Kur paraqitet një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, përgjigjja nuk duhet të kthehet nga stafi politik i Kryetarit. Ajo duhet të formalizohet me një akt administrativ, përkatësisht me vendim të Kryetarit, përmes të cilit lejohet qasja e plotë, qasja e pjesshme ose refuzohet qasja, në përputhje me ligjin. Prandaj, një përgjigje e dhënë nga një punonjës i kabinetit nuk përbën vendim administrativ për qasje në dokumente zyrtare. Është mirë që e përmendët edhe ju se duhet të ketë një vendim formal. Në këtë rast, një vendim i tillë nuk ka qenë.

Kryetari Faton Peci: Po e përsëris edhe një herë: mos i ndalni kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, nga dita e parë deri në ditën e fundit. Nëse në ndonjë rast është tejkaluar afati ligjor, kjo është pjesë e procedurës administrative që trajtohet nga Zyra për Informim, e cila ia përcjell lëndën Kryetarit për vendimmarrje. Nga ana ime, e them qartë se, nga dita e parë deri në ditën e fundit të mandatit, mbaj përgjegjësi vetëm për veprimet e mia. Prandaj, nëse ekziston ndonjë kërkesë që rrezikon të tejkalojë afatin

ligjor, ajo duhet të më sillet menjëherë për ta nënshkruar vendimin për lejimin e qasjes në dokumente zyrtare. Unë i obligoj Drejtorin e Arsimit dhe Drejtorin e Administratës që, përmes një shkrese zyrtare, t'ju njoftojnë se cilat pozita janë duke u bartur, nga cilat drejtori vijnë dhe në cilat pozita do të sistemohen sipas vendimit që kemi para vetes. Gjithashtu, ju inkurajoj që të mos ndaleni vetëm te pjesa fillestare e kërkesës suaj, por ta ndiqni të gjithë procesin deri në fund. E keni përkrahjen time që të dy drejtoritë t'ju raportojnë për tërë ecurinë e zbatimit të këtij vendimi, deri në realizimin përfundimtar dhe te përfituesi i fundit, përkatësisht te pozitat dhe shërbimet që do të ofrohen nga mësimdhënësit.

Shefki Begu: Këto pozita barten në arsimin e mesëm të ulët. Në këtë kategori përfshihen edhe asistentët. Pra, këto pozita i referohen kësaj kategorie të punësimit.

Flamur Vojvoda: Përshëndetje i nderuar Kryesues i Kuvendit, i nderuar Kryetar i Komunës, i nderuar Nënkrystar, drejtorë dhe të nderuar anëtarë të Kuvendit. Për një pjesë të kësaj çështjeje tashmë është dhënë përgjigje nga Kryetari, mirëpo duke qenë se kam punuar një periudhë të gjatë në arsim, ndiej obligim të kërkoj disa sqarime shtesë dhe të jap opinionin tim për këtë pikë të rendit të ditës, e cila mendoj se është ndër çështjet më të rëndësishme të kësaj seance. Me këtë pikë kërkohet miratimi i harmonizimit të numrit të stafit përmes bartjes së 19 pozitave në Drejtorinë Komunale të Arsimit. E kuptojmë nevojën për staf në arsim dhe rëndësinë e këtij sektori si një ndër fushat më të rëndësishme të funksionimit të komunës. Funksionimi normal i arsimit është interesi i të gjithëve. Nëse ekziston mungesë e stafit në arsim, mendoj se kjo çështje është dashur të trajtohet edhe më herët, pasi shkollat nuk duhet të përballen me mungesa për shkak të proceseve administrative, kur funksionimi i tyre varet nga organizimi dhe mbulimi i nevojave me staf. Në parim, pajtohem që duhet të gjendet një zgjidhje. Edhe pse kjo zgjidhje mund të ketë ardhur me vonesë, është e rëndësishme që procesi të coë përpara. Megjithatë, mendoj se është e rëndësishme që përmes këtij vendimi të bëhet e qartë edhe për qytetarët se çfarë nënkupton konkretisht kjo bartje e pozitave. Nga informacionet që kam kuptuar, nuk bëhet fjalë për krijimin e vendeve të reja të punës, por për bartjen e pozitave ekzistuese nga sektorë të tjerë komunalë në Drejtorinë e Arsimit. Nëse ky kuptim nuk është i saktë, do të kërkoja të korrigjohem. E kuptojmë nevojën që arsimi të ketë staf të mjaftueshëm, por duhet të sigurohemi që kjo lëvizje të mos krijojë probleme në kapacitetet e sektorëve të tjerë nga ku po merren këto pozita. Duhet të dimë nëse kjo është një zgjidhje afatgjatë dhe nëse e adreson realisht problemin e mungesës së stafit në arsim. Dëshiroj të marr sqarim nëse kjo është një zgjidhje e qëndrueshme apo vetëm një ndërhyrje e përkohshme. A ekziston mundësia që pas disa muajsh të përballemi përsëri me të njëjtin problem? Ne jemi të gatshëm ta mbështesim këtë vendim, sepse nuk duam të pengojmë funksionimin e arsimit. Por për një vendim të tillë është e nevojshme të kemi transparencë të plotë dhe të dimë: pse janë zgjedhur pikërisht këto pozita, a janë aktualisht të lira këto pozita, a ndikohet funksionimi i sektorëve nga të cilët po merren dhe cili është plani afatgjatë për mbulimin e nevojave të arsimit me staf. Gjithashtu, kërkoj sqarim nëse ky vendim është në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike. Mendoj se në momentin kur ne e votojmë këtë vendim, përgjegjësia ndahet edhe me Kuvendin Komunal. Prandaj është e rëndësishme që të kemi të gjitha sqarimet e nevojshme, në mënyrë që vendimi të jetë sa më i drejtë, i zbatueshëm dhe në interes të plotë të qytetarëve.

Kushtrim Zeneli: Kjo çështje e bartjes së pozitave, në këtë pikë të rendit të ditës, më shumë tregon se si qeverisja lokale ka gjetur një mënyrë për t'iu qasur dhe për ta adresuar këtë problem. Unë e prita që ndoshta nuk do të kishte shumë diskutim për këtë pikë, mirëpo meqë jemi ndalur, para se të vazhdoj me disa çështje, dua ta përgëzoj kryetarin dhe drejtorin për klimën e re demokratike që është krijuar në Mitrovicë. Për herë të parë po shoh që drejtorë të shkollave po dalin dhe po flasin hapur për problemet me të cilat përballen. Ka pasur drejtorë që për katër vite kanë heshtur, ndërsa sot po gjejnë guximin të flasin publikisht dhe hapur. Kjo nuk është diçka negative; përkundrazi, është dëshmi se problemet nuk po fshihen më, por po trajtohen dhe po përballohen. Sa i përket kësaj pike, pjesa më e madhe e diskutimit është përqendruar te interpretimi ligjor dhe opinioni juridik. Nuk besoj se dikush këtu në asamble ka më shumë interes se sa ekzekutivi që kjo çështje të jetë në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore. Në fund të fundit, asambleja mund të votojë një vendim, por përgjegjësia për zbatimin dhe përputhshmërinë ligjore i takon edhe institucioneve përkatëse. Prandaj, mendoj se sqarimet për interpretimin ligjor janë dhënë dhe nuk ka nevojë të krijohet paqartësi aty ku çështja është sqaruar. Para se të votojmë këtë pikë të rendit të ditës, dua

të rikujtoj disa fakte që lidhen me gjendjen në arsim. Duhet ta dimë se për tre vite nuk është shpallur asnjë konkurs për mësimdhënës në Komunën e Mitrovicës. Duhet ta dimë se konkursi për drejtorë dhe zëvendësdrejtorë ka dështuar për tre vite radhazi. Është shqetësuese që shumica e shkollave në Komunën e Mitrovicës kanë funksionuar pa drejtorë dhe me ushtrues detyre. Po ashtu, ka pasur raste kur komisionet e Drejtorisë së Arsimit kanë vlerësuar se një kandidat nuk i plotëson kushtet për pozitën e drejtorit, ndërsa më pas është emëruar ushtrues detyre në atë pozitë. Kemi humbur një numër shumë të madh orësh mësimore gjatë viteve të fundit. Ka shkolla në Mitrovicë ku për periudha të gjata nuk është zhvilluar mësimi në lëndë të caktuara, ndërsa sot ende po diskutojmë për bartjen e këtyre pozitave dhe për çështje procedurale. Prandaj, këtë vendim e votoj me shumë dëshirë, sepse prindërit dhe nxënësit janë duke pritur që kjo çështje të përfundojë dhe orët e humbura mësimore të mbulohen. Vota ime dhe e gjithë grupit tonë është për këtë pikë të rendit të ditës.

Xhylljeta Imeri: Unë vetëm desha t'i bashkëngjitem kërkesës së Shkëlqimit lidhur me bashkëngjitjen e pëlqimeve ose opinionëve nga Zyra Ligjore për dokumentet që na sillen, jo për këtë çështje që jemi duke e diskutuar tani, por për çështjet e tjera kur ato janë të ndjeshme dhe kërkojnë sqarim juridik.

Kryetari Faton Peci: Derisa ta hartoj buxhetin tim për herë të parë në vjeshtë, për momentin jemi duke punuar në disa aspekte të rëndësishme, ndërsa arsimi është një prej fushave ku gjendja kërkon ndërhyrje. Për këtë arsye, po marrim disa pozita nga administrata dhe po i sistemojmë në sistemin arsimor, veçanërisht për një kategori që është shumë e veçantë. Unë kam një ndjeshmëri të lartë për kategorinë e fëmijëve me nevoja të veçanta. Nuk po them që kategoritë e tjera nuk janë të rëndësishme, sepse edhe ndjeshmëria varet shpesh nga planifikimi dhe mundësitë që kemi. Por, për fëmijët me nevoja të veçanta kam një përkushtim të veçantë dhe një vullnet të madh që deri në fund të mandatit të arrijmë një standard më të mirë në adresimin e nevojave të tyre, përmes asistentëve dhe psikologëve. Për ta thjeshtuar për qytetarët që na ndjekin: ky vendim është një hap në një seri vendimesh të tjera që lidhen me harmonizimin e shpenzimeve, pozitave dhe burimeve njerëzore. Me fillimin e hartimit të buxhetit do të fillojë edhe faza e harmonizimit të pozitave dhe stafit në secilin institucion. Edhe deri tani jemi udhëhoqur nga një logjikë e tillë. Për shembull, në rastin e zjarrfikësve, nga 43 pozita të aprovuara kemi propozuar marrjen e gjashtë pozitave, duke vlerësuar që ndikimi në këtë sektor të jetë sa më i vogël. Jemi munduar që pozitën t'i marrim nga sektori ku pasojat ose rreziku i mungesës së stafit janë më të ulëta. Pra, kemi pasur kujdes që të mos dëmtojmë funksionimin e shërbimeve kryesore. Kjo është bërë edhe në konsultim me drejtorët përkatës, duke parë ku ka më shumë hapësirë për riorganizim. Dua ta sqaroj edhe një çështje që u përmend gjatë diskutimit nga njëra prej asambleistëve lidhur me numrin e pozitave të marra nga zjarrfikësit. Arsyeja pse janë marrë gjashtë pozita është sepse ky sektor ka numër më të madh të pozitave të aprovuara. Nga 41 pozita të aprovuara, është marrë vetëm një pjesë e vogël. Qëllimi ynë nuk ka qenë dhe nuk është që t'i dëmtojmë sektorët e tjerë. Përkundrazi, qëllimi është që të kemi qeverisje më të mirë, më shumë meritokraci dhe më shumë projekte të realizuara. Secili prej jush, pavarësisht pozitës apo opozitës, e ka të njëjtin interes: që Komuna e Mitrovicës të ketë rezultate sa më të mira dhe që shërbimet për qytetarët të përmirësohen.

Xhylljeta Imeri: Kryetar, pas këtij sqarimi dhe konfirmimi që e dhatë, jam edhe më e bindur dhe me më shumë kënaqësi do ta votoj këtë pikë. Duke marrë parasysh se vazhdimisht jam në kërkim të sigurimit të asistentëve për fëmijët me nevoja të veçanta dhe të psikologëve, për të cilët i kam paraqitur edhe më herët këto kërkesa, e vlerësoj këtë hap si shumë të rëndësishëm.

Valon Brahimi: Vetëm desha të bëj një sqarim për opinionin, pasi qytetarët po e përcjellin këtë seancë. Këtu u deklarua se ne jemi kundër kësaj pike, por dua ta bëj të qartë se Partia Demokratike e Kosovës nuk voton për vendime të cilat i konsideron të paligjshme. Nëse një vendim do të ishte në kundërshtim me ligjin, ne nuk do ta mbështesnim. Në këtë rast, ne jemi pro kësaj pike pikërisht për shkak të interesit të nxënësve dhe të sistemit arsimor. Prandaj, vota jonë është pro këtij vendimi, për hir të interesit të nxënësve dhe për përmirësimin e arsimit në Mitrovicë. Pra, jemi pro dhe jo kundër, siç u deklarua më herët.

Igballe Islami: Në asnjë fazë të punës së Kuvendit Komunal nuk do të doja të shihja që një asamblist, vetëm pse është pjesë e pozitës, të deklarojë se nuk ka nevojë për konfirmim ligjor dhe se ne duhet ta votojmë një çështje vetëm sepse ekziston një organ tjetër që mund ta shqyrtojë ligjshmërinë më vonë. E

dini pse? Sepse edhe kur je pjesë e pushtetit dhe e pozitës, duhet ta respektosh veten, votuesit që të kanë sjellë këtu dhe vetë demokracinë. Kërkimi i një konfirmimi ligjor është pjesë e përgjegjësisë sonë si anëtarë të Kuvendit. Së dyti, u përmend se për tre apo katër vite nuk ka pasur konkurse të rregullta. Mendoj se kjo është një deklaratë që nuk i bën nder këtij Kuvendi Komunal, nëse nuk është e saktë. Ka pasur konkurse të rregullta, për shembull për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale. Edhe sa i përket shkollave, emërimet janë bërë duke u bazuar në kriteret dhe procedurat ligjore për zgjedhjen e drejtorëve. Në rastet kur nuk ka pasur kuorum ose nuk janë plotësuar kushtet procedurale, konkursi është anuluar dhe procedurat janë zhvilluar sipas ligjit. Sa i përket numrit të pozitave në arsim, duhet të bëhet dallimi mes pozitave dhe zëvendësimeve të përkohshme. Ndryshimet në numrin e stafit arsimor lidhen shpesh me raste të lehonisë dhe zëvendësimeve të tjera, ku Drejtoria e Arsimit ka numrin më të madh për shkak të natyrës së punës. Gjithashtu, sa i përket qarkores buxhetore, duhet të kemi parasysh se Ministria e Financave, bazuar në kufizimet për zotime dhe shpenzime, nuk lejon tejkalimin e numrit të të punësuarve brenda një organizate buxhetore. Mund të bëhen ndryshime përmes listës së pagave, por kjo nuk do të thotë se procesi përfundon automatikisht. Duhet të ndiqet procedura e rregullt e rekrutimit, të ekzistojë numri i aprovuar i pozitave dhe të ketë disponueshmëri financiare për të kaluar në listën e pagave.

Kushtrim Zeneli: Pikërisht pse jemi në këtë seancë sot është sepse është shkelur ligji. Çështja është se si janë krijuar këta 37 numra dhe si është rritur numri i pozitave. Si janë rritur? Është shkelur qarkorja buxhetore. Kjo çështje është dashur të trajtohet atëherë dhe të mos na vijë sot në këtë formë.

Nënkryetari Enis Osmani: Për hir të korrektësisë, po flasim për një çështje konkrete. Çfarë kanë qenë 37 numrat, janë bartur gjatë kohës suaj si drejtoreshë e financave. Jo, këto kanë qenë tejkalime që me ligjin e buxhetit nuk lejohen. A pajtohesh me këtë? Sa i përket shkollave, janë përmendur raste si Migjeni, Musa Hoti, Ismajl Qemali dhe të tjera. Pra, për tre vjet me radhë qëndron fakti se nuk ka pasur konkurse të rregullta në arsim. Qeverisja ka qenë e juaja. Nuk ka pasur konkurs të rregullt në arsim. Madje më vjen çudi se si nuk i dini këto gjatë mandatit tuaj. U mundova të mos flas, por konkurs të rregullt për tri vite nuk ka pasur. Këto që po i them mund të vërtetohen dhe për këtë mund të ballafaqohemi edhe në seancën e radhës. Për çerdhen në Shipol, po ta jap përgjigjen. Çerdhja në Shipol është bërë jashtë procedurave ligjore. Është prerë shiriti nga ish-kryetari dhe nënkryetari, por nuk ka pasur projekt të përfunduar, nuk ka pasur numra të siguruar dhe nuk ka pasur procedura të kompletuara. Çerdhja në Shipol nuk ka pasur as leje të nevojshme për kyçje në energji elektrike dhe as leje ndërtimore. Nuk po them këtë për të sulmuar dikë, por faktet duhet të thuhesh. Unë jam për t'i mbuluar gabimet njerëzore kur është e mundur, por nuk mund të mbulohen veprimet që kanë qënë rezultat i keqmenaxhimit. Ju keni zhvilluar procedura për çerdhen në Shipol pa i pasur të gjitha kushtet e nevojshme. Për tri vite nuk ka pasur konkurs të rregullt në arsim, kanë dështuar procedurat për drejtorë të shkollave, ka pasur mungesë të stafit dhe janë vazhduar kontrata afatshkurtra për disa vite. Këto janë çështje që kanë ndodhur gjatë mandatit tuaj: çështja e çerdhës në Shipol, konkursi në arsim dhe çështja e numrave të stafit. Nuk po them që dikush nuk mund të bëjë gabime, sepse çdo qeverisje mund të përballet me sfida, por këto janë fakte që duhet të diskutohen me përgjegjësi.

Shkëlqim Ibrahim: Vetëm desha t'ju tregoj se, nëse do ta kishit parë gjendjen në arsim që e kemi marrë ne, do ta kuptonit se është dashur të përballemi me kriza dhe me shumë procese të pazgjidhura. 62 persona kanë qenë pa konkurs. Dy vite me radhë kemi humbur grantin e performancës për shkak të së njëjtës gjelje. Ata na thoshin: "Legalizoni këtë çështje", sepse proceduralisht nuk kishte mundësi që ato mjete të realizoheshin dhe kemi pasur humbje financiare. Përveç kësaj, ka pasur edhe gjelje të tjera që kanë shkuar deri në rreth 500 mijë euro. Sot i keni drejtorët, i keni emëruar drejtorë, por mos u ktheni gjithmonë te e kaluara; qëndroni te e tashmja. Sepse ata drejtorë që kanë ndikuar në humbjen e rreth 6 milionë eurove nga grantet e performancës, sot janë bërë drejtues kryesorë. Prandaj, mos u ktheni vetëm te e kaluara, por vazhdoni përpara. Përgjegjësia juaj është vazhdimësia e proceseve dhe ngritja e tyre, sepse kjo është çështja kryesore. Nëse duam të kthehemi te e kaluara, atëherë ka shumë çështje për të diskutuar, por më e rëndësishme është të fokusohemi në të tashmen dhe në përmirësimin e gjendjes.

Kryesuesi i Kuvendit: E hedh në votim propozimin për Rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore.

Rezultati i votimit: 28 anëtarë të pranishëm, 28 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se u miratua unanimisht Vendimi për Rregullimin dhe harmonizimin e numrit të stafit në kuadër të Organizatës Buxhetore.

Pika 6

Kryesuesi i Kuvendit sa i përket Raportit mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës së Jugut, maj 2026, e hap diskutimin.

Shkëlqim Ibrahim: Unë veç një pyetje e kam, drejtor. A bën me na saktësuar pak sa është përqindja e popullsisë në skema sociale në Mitrovicë?

Sazan Ramaxhiku: Unë desha veç me pyetur drejtorin: çfarë planesh konkrete keni për një periudhë të afërt, do të thotë kohore, për t'u rrealizuar për fëmijët dhe personat me nevojë për mbështetje?

Kryesuesi i Kuvendit: Domethënë, po, po, gjithsesi, ne jemi duke biseduar në renditje për raport, jo për planet e të ardhmes, por kryesisht të fokusohemi te raporti.

Igballe Islami: Po, ky raport mbi gjendjen sociale në komunën e Mitrovicës së Jugut është shqyrtuar para mbledhjes së fundit të KPF, ku nuk kanë qenë as kryetari dhe as nënkryetari. Unë kam pritur që kjo pikë, kur shqyrtohet në kuvend, të jetë kryetari ose nënkryetari. Unë kam pasur një kërkesë dhe një pyetje ndaj drejtorit sa i përket këtij raporti, e cila nuk është pyetje e imja, por është pyetje e qytetarëve, e aq më tepër e familjeve që janë në asistencë sociale. A ka pasur drejtori për mirëqenie sociale të komunës së Mitrovicës kërkesë ndaj kryetarit të komunës për vazhdimin e subvencionimit të familjeve me asistencë sociale? Praktikisht ka qenë viteve të fundit. Përgjigjja e tij në Komitetin për Politikë dhe Financa është e faktuar në procesverbal, ku thotë: "Unë kam kërkesa të vazhdueshme." Unë kam dashur që kryetari ose nënkryetari të thonë se a ka pasur kërkesa, domethënë kush është këtu që nuk e ka aprovuar këtë subvencionim, sepse po flasim për 1400 raste me asistencë sociale. Unë po vlerësoj dhe po besoj që vëmendja kryesore e drejtorisë është pikërisht te rastet me asistencë sociale, domethënë, a ka kërkesa dhe pse nuk u aprovuan? E dyta, ne kemi pranuar një material shumë voluminoz. Domethënë, përgëzime për raportin që është bërë, mirëpo a mundet drejtori me ma konkretizuar sa faqe janë punë që ti ke kryer dhe sa faqe të tjera janë raporte që i ke marrë prej Agjencisë së Statistikave të Kosovës? Edhe sa mendon ti që këtu mund të ndërlihet me punën tënde, me trajtimin që ti ke bërë aty? Sepse nuk është vetëm me marrë prej Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe me i vendosur aty, por çështja është se ti je drejtor dhe çështja është se ti je në atë drejtori për të ofruar zgjidhje. Kështu që, sa faqe janë punë konkrete që ti i ke zgjidhur, sa faqe të tjera janë të dhëna metodologjike, të dhëna të tjera të agjencioneve statistikore të Kosovës dhe cilat mendon që duhet të jenë aty? Kështu që, shumë mirë që kryetari dhe nënkryetari janë këtu. Përgjigjen e drejtorit besoj tash e dinë. Këtë pyetje e kam bërë edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe vazhdojmë tutje.

Xhylljeta Imeri: Sipas këtij raporti ka rënie të lehtë të familjeve me asistencë sociale, por tek raporti për tregun e punës gjatë vitit 2025 vërehet se nga 230 punëkërkes, 147 janë gra që përbëjnë rreth 64% të totalit. Ky është një tregues shqetësues, pasi tregon se gratë po përballen me më shumë vështirësi në qasje në tregun e punës. Po aq shqetësues është edhe niveli i arsimimit të punëkërkesve: 110 persona janë të paarsimuar, duke përbërë grupin më të madh. Unë mendoj që kjo është një kampanë alarmi për rëndësinë e investimit në arsim, aftësim profesional dhe rikualifikim. Megjithatë, sfida nuk prek vetëm personat me arsim të ulët. Në listën e punëkërkesve ka edhe persona me gjimnaz, bachelor dhe master, çka tregon se edhe të arsimuarit po hasin vështirësi për t'u punësuar. Për këtë arsye konsideroj se komuna, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, duhet të hartojë një plan afatgjatë për punësimin, me fokus të veçantë në fuqizimin ekonomik të grave, programe të aftësimit profesional sipas kërkesave të tregut, bashkëpunimin me bizneset për krijimin e vendeve të reja të punës, si dhe mbështetjen e të rinjve dhe të diplomuarve për praktikë. Së dyti, raporti tregon se shumica e prindërve vetë-ushqyes janë gra dhe po ashtu shumica e viktimave të dhunës në familje janë gra. Kjo tregon se gratë vazhdojnë të përballen me sfida të mëdha ekonomike dhe sociale. Për këtë arsye presim nga ekzekutivi më shumë programe konkrete për fuqizimin ekonomik të grave, mbështetjen e nënave vetë-ushqyese dhe parandalimin e dhunës në familje. Gjithashtu, shqetësues është edhe fakti se në qytetin tonë mungon një qendër për personat me autizëm. Kjo është një nevojë reale

për shumë familje dhe besoj se komuna do ta ketë prioritet planifikimin e një shërbimi të tillë. Shpresoj që këto gjetje të mos mbeten vetëm statistika në raport, por të shndërrohen në politika dhe masa konkrete që përmirësojnë jetën e qytetarëve tanë.

Kushtrim Zeneli: Unë e kam një pyetje për drejtorin rreth projektit për banim të përballueshëm. Njëra ndër projektet më të mira që ka qenë është marrë nga Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor, pra projekti për banim të përballueshëm social. Komuna e Mitrovicës ka mbetur jashtë si pasojë e neglizhencës ose mosaplikimit nga vetë komuna e Mitrovicës. Atëherë, pyetja ime për drejtorin është: cilat janë hapat konkretë dhe cila është mundësia që ky projekt të rikthehet për qytetarët e Mitrovicës?

Visar Syla: Për drejtorin e pata një pyetje. Ndoshta ka vepruar diçka në atë drejtim, por edhe si kërkesë: shembull, në lagjen "Jetimat e Ballkanit" në Frashër, të cilëve qeveria u ka ndërtuar shtëpitë në veri. A janë identifikuar ato familje? A kanë dalë në veri apo janë duke qëndruar ende aty, ndërkohë që shtëpitë i kanë mbyllur lart? Do të ishte mirë të merrej një iniciativë që ata të kthehen në shtëpitë e tyre, në mënyrë që të lirohen këto shtëpi këtu për raste të tjera.

Ramadan Beshiri: Po fillojmë me z. Ibrahim, faleminderit fillimisht për pyetjen. Raporti është i ndarë në dy pjesë dhe aty ka një paqartësi, për shkak se 8.8% deri në muajin prill është niveli i skemave sociale të cilët përfitojnë mbi bazën e numrit të anëtarëve të familjes, ndërsa 8.5% është mbi bazën e numrit të personave që përfitojnë prej asistencës sociale. Domethënë, dallon mes numrit të rasteve dhe numrit të anëtarëve të familjeve pra 8.5% është mbi bazën e numrit. Pra d.m.th. kjo 8.8% është mbi bazën e numrit të familjeve, që është mbi 5.000, ndërsa 8.5% deri në muajin prill është si rezultat i numrit të anëtarëve, që është 1457.

Shkëlqim Ibrahim: Tek faqja e shtatë nëse merr numrin e njëjtë të anëtarëve të familjes që ke shkruar, 5491, dhe e zbaton me atë formulë që ka llogaritur, del 8.5%. A kupton që ideja është cila është e sakta? 8.5% apo 8.8%?

Ramadan Beshiri: 8.5% është në rregull, po normalisht kjo është shifër për muajin prill, sepse materialin e kemi pasur para mbledhjes së KPF. Ndërsa sot i kemi 144 familje me asistencë sociale, që është shifra diku 8.1–8.2%. Sa i përket znj. Islami për çështjen e subvencionimit të familjeve me skema sociale, unë e kam thënë në term të përgjithshëm, jo subvencionim prej kryetarit me kërkuar që të ketë nga 100€ për familje, mirëpo në term të përgjithshëm kam kërkesa të vazhdueshme drejtuar kryetarit. Shembull, siç është kërkesa për përkrahjen e viktimave të dhunës, që së bashku me kryetarin jemi duke shqyrtuar kohën dhe momentin më të duhur për ta realizuar, apo edhe subvencionimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Faleminderit shumë edhe te znj. Ramaxhiku. Pyetja kryesisht lidhet me çështjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Momentalisht në Mitrovicë janë 249 fëmijë me aftësi të kufizuara të evidentuar në bazë të QPS. Normalisht kjo shifër ndoshta nuk është reale, sepse shumë prindër hezitojnë t'i lajmërojnë fëmijët, siç e kemi rastin e fëmijëve autikë. Çfarë kemi për të bërë në të ardhmen për t'i përkrahur fëmijët, siç janë këta 249 fëmijë me aftësi të kufizuara, lidhet më shumë me aspektin e buxhetimit dhe kostove buxhetore që lidhen me shërbime sociale. Shembull, tashmë i kam paraqitur kryetarit një kërkesë për përkrahjen e 26 fëmijëve me sindromën Down për terapi logopedike, me një mbështetje prej 3600€. Pastaj do të vazhdojmë edhe me fëmijët e tjerë që kanë nevoja të veçanta. Siç e dini, përkrahja ka qenë 50€ për fëmijët autikë, një shumë simbolike, por ka pasur qëllim të zgjojë interesin e prindërve që t'i lajmërojnë fëmijët dhe të mos i mbajnë të fshehur. Ndërsa sa i përket raportit, normalisht është raporti social i gjendjes komunale, i ndarë në dy pjesë: një pjesë më analitike, ku kam përdorur metodë krahasimore dhe statistikore për të paraqitur gjendjen reale. Për gjashtë muaj nuk kam mundur ta avancoj raportin në mënyrë perfekte, por tash do të fokusohem për ta përmirësuar gjendjen sociale në komunën e Mitrovicës. Raporti është i punuar me instrumente dhe hulumtime shkencore, i mbështetur në statistikat e QPS-së, ATK-së, Agjencisë së Punësimit, Inspektoratit të Punës, e kështu me radhë, sepse është një ndërlidhje ndërinstitucionale. Pa një databazë të tillë nuk mund të realizojmë asnjë punë. Sa i përket grave, kemi një problematikë edhe brenda personave me aftësi të kufizuara, ku ka diskriminim për gratë. Programi që së shpejti duhet ta aplikojmë është për nënat vetë-ushqyese, të cilat janë në numër shumë të madh. Vetëm dy baballarë janë vetë-ushqyës, ndërsa pjesa tjetër janë nëna. Po ashtu, projekti i qeverisjes Kurti për fuqizimin e grave në tregun e punës është një mundësi e mirë. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik mund të ndihmojë me programe si vazhdimi i

punës praktike pa pagesë për të diplomuarit, duke përkrahur sa më shumë gra dhe vajza, si dhe persona me aftësi të kufizuara, veçanërisht gratë, për të thyer barrierat gjinore. Z. Sylja kur ti marr informacionet do të përgjigjem për atë pjesë sepse jemi duke punuar në atë drejtim. Sa i përket banimit social, tashmë kemi fituar 2 milionë € projekt nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, znj. Fitore Pacolli, dhe jemi në komunikim me të. Mënyerën po kërkojmë përkrahje shtesë për banimet sociale ekzistuese, të cilat si rezultat i kohës dhe rrethanave kanë filluar të dëmtohen. Fillimisht po tentojmë t'i rinovojmë, si në Trepçë dhe lokacione të tjera, dhe më pas të vazhdojmë me njësi të reja banesore për persona në skema sociale, por edhe për çiftet e reja. Ky është procesi aktual.

Erseka Barani: E kam një pyetje sa i përket shtëpisë së sigurt. Deri në çfarë faze ka arriti d.m.th vazhdimi i ndërtimit të atij objekti edhe pse është bërë vonimi i vendosjes së viktimave të dhunës familje në shtëpinë e sigurt si dhe cilat janë problematikat që e kanë stërvonuar këtë proces?

Igballe Islami: Fillimisht, unë nuk e pranova përgjigjen në pyetjen time konkrete. Sa faqe janë punë konkrete që i keni bërë gjatë kësaj periudhe raportuese? Sa faqe janë statistika të Agjencisë së Statistikave? Janë tre-katër raporte, të cilat kanë ardhur prej drejtorive. E katërta është gjendja e popullsisë, sa që kam hyrë ta shikoj nëse dikush e ka shënuar gabim apo jo, domethënë, këto janë statistika në të cilat secili prej nesh ka qasje. Drejtor, në Komitetin për Politikë dhe Financa nuk e morëm të njëjtën përgjigje. Nuk ka qenë kryetari, tani është kryetari këtu. Janë 1.400 familje me asistencë sociale, të cilat kanë kërkesa të vazhdueshme për të ditur pse nuk është vazhduar subvencionimi prej nga 100 €, që ka qenë një praktikë të cilën e kanë mirëpritur për shkak të kushteve të rënda që i kanë qytetarët e Mitrovicës. Drejtor, në Komitetin për Politikë dhe Financa është në procesverbal se ju keni thënë: “Unë po bëj kërkesa të vazhdueshme.” Tani, nëse ato kërkesa kanë qenë të vazhdueshme, ne sot prapë e votuam bartjen e mjeteve, por prapë nuk u përfshi. A ka mundësi ta dinë edhe qytetarët e Mitrovicës: a i ka Drejtoria për Mirëqenie Sociale familjet me asistencë sociale në qendër të vëmendjes apo nuk i ka? A kanë qenë kërkesat tuaja të arsyetuara te kryetari? Tjetra, ju thotë se keni kërkesa të vazhdueshme te kryetari për subvencionimin e viktimave të dhunës në familje. Më duket se ai është propozim i mirë ishte nga znj. Barani. Nuk është diçka që e keni propozuar ju. Në rregull, është përmes jush, por është vendim i Kuvendit dhe ju e implementoni. Prandaj, tregoni edhe një herë qartë: a keni pasur kërkesë për vazhdimin e subvencionimit? A e keni konsideruar të nevojshme që 1.400 familjeve të mos u vazhdohet mbështetja me asistencë sociale? Qytetarët duhet ta dinë: a është Drejtoria ajo që nuk dëshiron ta vazhdojë, apo thjesht kryetari nuk e ka aprovuar kërkesën? Tjetra, sa faqe të këtij raporti janë punë konkrete e juaja si drejtori, e jo statistika? Duke u bazuar në profesionin tuaj, ky është një material shumë voluminoz. Unë e përmenda këtë me gjithë respektin, mirëpo sa është puna konkrete, kjo është më e rëndësishme për ne, pasi e kemi rolin tonë mbikëqyrës në Kuvend ndaj ekzekutivit.

Ramadan Beshiri: Sa i përket Shtëpisë së Sigurt, apo shtëpisë e cila është e destinuar për viktimat e dhunës me bazë gjinore, ajo është në fazën përfundimtare. Sot përfundon vendosja e rrethojave dhe matja e kuzhinës. Është vendosur edhe tavolina e ngjënies.

Gjatë javës vjen kontejneri për sigurimin, i cili duhet të qëndrojë aty, dhe pastaj mbetet vetëm përrurimi, apo prerja e shiritit, siç themi. Ndërsa, sa i përket vonesave, ato ndërlidhen me çështjet gjeopolitike, sepse UNMIK-u është investitor, së bashku me UNOPS-in, dhe ka humbur një pjesë të madhe të mbështetjes financiare si rezultat i vendimeve të fundit që kanë ndodhur, përfshirë edhe ato të presidentit Trump, me të cilat janë ndërprerë financimet për shumë organizata ndërkombëtare dhe transnacionale. Kjo ka ndikuar edhe në këtë projekt. Megjithatë, kjo është edhe meritë e juaja, sepse kemi bërë një punë goxha të madhe. Kemi bërë kërkesa të vazhdueshme ndaj UNMIK-ut dhe UNOPS-it dhe, përfundimisht, me kontraktimin e fundit punët po përfundojnë. Besoj se brenda dy ose tre muajsh do ta kemi përrurimin e Shtëpisë së Sigurt, e cila është shumë e nevojshme për viktimat e dhunës, sidomos për QMGF “Raba Voca”, për të cilën edhe ti e di se në çfarë gjendjeje është mënyerën. Ndërsa, sa i përket pyetjeve nga znj. Islami, sa është punë konkrete e imja? Për këtë duhet ta pyesni profesor doktor Fadil Malokun. Ai më ka magjistruar; si t'ia nis t'ju tregoj unë sa faqe kam shkruar? Shikojeni materialin dhe do ta shihni pjesën analitike. Pjesa analitike është ajo që unë e kam menduar dhe analizuar, pjesa statistikore është ajo që duhet të merret prej institucioneve. Metoda statistikore, që është pjesë e sociologjisë, është produkt i punës sime. Unë e kam

marrë numrin e banorëve, ashtu siç e keni shkruar të gjithë. Po të mos e kishim numrin prej 64.500 banorësh, si do ta dinim përqindjen e familjeve në skemën sociale? Si do ta dinim sa janë me asistencë sociale, sa janë nëna lehonë apo nëna ushqyese? Këto janë të gjitha shifra që na duhen për të nxjerrë një epilog të caktuar. Sa i përket përkrahjes nga kryetari, e kam pasur përkrahjen e tij pa rezervë. Ne përgatisim propozim-vendimet dhe ia dërgojmë kryetarit. Normalisht, i diskutojmë çdo ditë me kryetarin dhe i kemi politikat tona për kohën se kur do t'i implementojmë. Ndërsa, sa i përket 100 €ve për familjet me asistencë sociale, nuk e kemi pasur në planin tonë dhe as nuk është pjesë e planit të punës që e kam trashëguar nga drejtoresha znj. Drita Ibrahim. Ne do të aplikojmë programe të vetëpunësimit dhe vetëproduktivitetit për familjet në skemën sociale. Nëse 64 familje kanë dalë nga skema sociale, ne kemi programe të caktuara që do t'i zbatojmë për t'i bërë ato vetëproduktive dhe aktive në tregun e punës. Ndërsa subvencionimin, siç e dini, e ka bërë Qeveria Kurti për pensionistët, lehonat dhe fëmijët.

Bajram Istrefi: Cilat janë programet të cilat do t'i aplikoni në vazhdimësi për përkrahjen e rasteve sociale?

Igballe Islami: Po, drejtor, me të vërtetë tani na e zhvendosët vëmendjen te profesorët e sociologjisë dhe mënyra se si u munduat t'i përmbledhmit këto çështje na bëri që herëve të tjera të vijmë edhe me ndonjë asistent të sociologjisë, e jo të shkojmë ta pyesim profesorin se çfarë ju ka mësuar. Unë kam për ta pyetur ju, sepse ju e keni marrë besimin e kryetarit të komunës për ta udhëhequr një drejtori kaq të rëndësishme siç është DMS. Nëse juve ju duket se nuk është e nevojshme të përgjigjeni dhe më thoni të shkoj ta pyes profesorin tuaj, atëherë kjo kalon në një fazë tjetër. Ju thotë se duhet ta shikoj raportin. Besoj që nuk dyshoni se unë e kam lexuar raportin tuaj deri në faqen e fundit. E di saktësisht çfarë keni paraqitur. Pikërisht për atë arsye jua bëra pyetjen: tregomë sa faqe janë punë konkrete të juajat dhe sa faqe janë analiza statistikore. Kaq janë shoqata të dala nga lufta, kaq janë këto statistika – e gjitha është në rregull. Unë nuk thashë pse i keni paraqitur; përkundrazi, ju përgjzoja për raportin. Por, punët tuaja konkrete, çfarë keni bërë ju gjatë këtyre gjashtë muajve, ose pesë muajve, deri në momentin kur e keni sjellë raportin? Këtë nuk mund ta definoni duke më thënë të shkoj ta pyes profesorin tuaj. Unë po ju pyes juve, sepse ju jeni këtu dhe ju mbani përgjegjësi para meje, jo profesori juaj. A e kuptoni? Unë e kam rolin tim mbikëqyrës ndaj ekzekutivit, pra ndaj jush, e jo ndaj profesorit. Për të kam shumë respekt. Nuk e njoh personalisht dhe nuk kam qenë student i tij, por e respektoj.

Ramadan Beshiri: Veçse këtu e kemi një keqkuptim. Ju po flisni për raportin gjashtëmuor, apo pesëmuor, të punës sime. Raportin gjashtëmuor të punës e kemi më 16 korrik. Ky është raport analitik mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës. Sa faqe i kam shkruar unë? Hajde e shikojmë, madje edhe sa shkronja i kam përdorur në raport, e mund t'ju tregoj në një seancë tjetër. Por kjo nuk e mat performancën. Mund të më pyesni për tabelën shtatë, për shembull, e unë të ngrihem dhe t'ju shpjegoj. Por të flasim për numrin e faqeve, kjo nuk është në rregull. Pra, ky është raport mbi gjendjen sociale në Komunën e Mitrovicës. Nuk është raport i Drejtorisë për aktivitetet e mia, sepse kërkesa e Kuvendit ka qenë për një raport mbi gjendjen sociale. Raportin e punës e kemi më 16 korrik, të cilin ia paraqesim kryetarit të komunës. Më pas ai bëhet publik dhe atëherë mund t'u përgjigjem edhe pyetjeve, të cilat ishin mjaft me vend, edhe nga znj. Islami. Por jo pyetjeve se sa faqe janë shkruar e të ngjashme. Sa i përket programeve që do t'i aplikojmë, ne po shikojmë të bëjmë programe të cilat lidhen me Agjencionin e Punësimit dhe Inspektoratin e Punës, pra një bashkëpunim ndërinstitucional, në mënyrë që, kur t'i largojmë nga skema sociale një numër të caktuar të familjeve, të cilat tashmë e kanë tejkaluar përmbushjen e statusit formal për të qenë përfutues të skemave sociale, t'u mundësojmë programe të aftësimit profesional, të cilat lidhen me Qendrën për Aftësim Profesional, me Diakonie Kosova, në mënyrë që të kemi nga familjet sociale njerëz që aftësohen profesionalisht në sektorë të caktuar dhe të mos mbesin gjithmonë, në afat të gjatë, 10-vjeçar, pjesë e skemave sociale. Ndërsa programi tjetër, të cilin ia kam paraqitur vetëm kryetarit, jemi duke e analizuar, sepse është një program në vlerë prej 100.000 €sh. Ai ka të bëjë me subvencionimin e lejeve të drejtimit për kamionë për 100 anëtarë të familjeve me asistencë sociale, sepse në tregun e punës ka kërkesë shumë të madhe për posedimin e lejes për kamion. Mund të kemi, për shembull, 80% sukses, pra 80% të familjeve mund t'i nxjerrim nga skema sociale dhe t'i bëjmë vetëprodhuese. Po ashtu, ideja është edhe t'i subvencionojmë fëmijët e familjeve me asistencë sociale, që është një kategori e cila përfiton

asistencë sociale për shkak se ka fëmijë, për ndjekjen e kurseve të gjuhëve të huaja, në mënyrë që të jenë më konkurrues në tregun e punës, në call center apo në agjenci telefonike. Po ashtu, programet tona ndërlidhen në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik, siç janë programi i punës praktike me pagesë, që e aplikojmë, si dhe vazhdimi i punës praktike për personat me aftësi të kufizuara.

Sazan Ramaxhiku: Kryetar në emër të të gjithë fëmijëve me nevojë për mbështetje dhe të prindërve të tyre, ju falënderoj për ndjeshmërinë që po tregoni në këtë aspekt. Po ashtu, falënderoj edhe Drejtorin e Mirëqenies Sociale dhe Drejtorin e Arsimit sa i përket kësaj çështjeje. Pyetja ime ishte: Drejtor, sa i përket Qendrës për Autizëm, ku jemi me këtë projekt? A kemi filluar me procesin e ndërtimit apo kemi ndonjë hap konkret?

Ramadan Beshiri: Siç e dini, premtimi i kryetarit për Qendrën për Autizëm është bërë edhe publik. Në vazhdim të këtij premtimi, unë kam bërë përpjekje dhe gjendja aktuale është kjo: E kam përpiluar një koncept-projekt për Qendrën për Autizëm dhe ia kam paraqitur donatorit, TIKA-s turke. Më pas kam marrë edhe reagimin (feedback-un) e tyre dhe jam konsultuar edhe me kryetarin. Kryetari është në fazën e diskutimeve dhe koordinimit për të biseduar me përfaqësuesit e TIKA-s. Jam i bindur se gjatë mandatit tonë do të finalizohet Qendra për Fëmijë dhe Persona me Autizëm në Komunën e Mitrovicës, e cila është një nga mungesat e infrastrukturës sociale në Komunën e Mitrovicës.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Kryetari theksoi se gjendja ekonomike dhe sociale e komunës është një çështje komplekse që nuk mund të përmirësohet vetëm përmes subvencioneve, pasi zhvillimi ekonomik varet nga shumë faktorë. Ai vuri në dukje se komuna ka ndërmarrë masa mbështetëse për kategori të ndryshme, përfshirë fëmijët me autizëm dhe familjet në nevojë, por theksoi se synimi kryesor është krijimi i mundësive të qëndrueshme për punësim. Ai njoftoi se gjatë vitit të ardhshëm planifikohet ndërtimi i një Qendre të Inovacionit, ku të rinjtë do të aftësohen në fusha si teknologjia informative, inteligjenca artificiale, siguria kibernetike dhe gjuhët e huaja, në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu, u theksua se do t'u jepet prioritet përfshirjes së personave nga familjet përfituese të asistencës sociale në programe të aftësimit profesional, përfshirë edhe mbështetjen për pajisje me patentë-shofer të kategorive të larta, me qëllim rritjen e mundësive për punësim. Duke iu referuar statistikave të vitit 2025, kryetari theksoi se qarkullimi financiar i sektorit privat në Mitrovicë është dukshëm më i ulët krahasuar me komunat e tjera të mëdha të vendit, çka sipas tij pasqyron nivelin aktual të zhvillimit ekonomik. Ai theksoi se rënia e industrisë së Trepçës dhe mungesa e zhvillimit të sektorëve të tjerë ekonomikë kanë ndikuar në këtë gjendje. Në këtë drejtim, ai vlerësoi se një ndër prioritetet kryesore është menaxhimi më efikas i pronës komunale, duke propozuar ndarjen e sektorit të pronës nga kadastra për të krijuar kushte më të favorshme për investitorët. Sipas tij, aktivizimi i pronës komunale dhe funksionalizimi i Parkut Industrial do të ndikojnë në tërheqjen e investimeve, krijimin e vendeve të reja të punës dhe gjenerimin e zhvillimit ekonomik përmes efektit shumëfishues në ekonomi. Po ashtu theksoi se komuna do të vazhdojë koordinimin me nivelin qendror për sigurimin e investimeve infrastrukturore dhe njoftoi se deri në fund të vitit do të hartohet një strategji e veçantë zhvillimore për zonën e Shalës së Bajgorës. Kryetari njoftoi se komuna do të hartojë një strategji 10-vjeçare për zhvillimin e zonës së Shalës së Bajgorës, e cila do të përcaktojë objektivat dhe projektet prioritare në fushën e infrastrukturës, trashëgimisë kulturore e arkeologjike, agroturizmit, bujqësisë dhe blegtorisë. Ai theksoi se kjo strategji synon të krijojë një vizion afatgjatë zhvillimor, i cili do t'u shërbejë edhe qeverisjeve të ardhshme. Më tej, ai bëri të ditur se Qeveria është në negociata me konsorciume ndërkombëtare për zhvillimin e Trepçës, duke vlerësuar se përfshirja e investitorëve me përvojë dhe kapital do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të Mitrovicës. Megjithatë, ai theksoi se zhvillimi ekonomik nuk duhet të mbështetet vetëm te Trepça, por edhe në sektorë të tjerë prodhues dhe përpunues. Kryetari njoftoi se komuna do të bëjë rivlerësimin e parcelave në Parkun Industrial, si dhe do të angazhohet për zgjidhjen e çështjes së kontratave në Parkun e Bizneseve, me qëllim që operatorëve ekonomikë t'u mundësohet qasje më e lehtë në financim dhe zhvillim të aktiviteteve të tyre. Ai theksoi se një tregues pozitiv është rënia e numrit të familjeve që përfitojnë asistencë sociale, duke shtuar se komuna synon të hartojë programe për identifikimin e potencialit të secilit anëtar të familjeve në asistencë sociale dhe për përfshirjen e tyre në programe të aftësimit profesional dhe punësimit. Sipas tij, subvencionet e njëhershme nuk janë zgjidhje afatgjate, prandaj fokusi do të jetë në krijimin e mundësive të qëndrueshme

për punësim dhe integrim ekonomik, duke përfshirë edhe kategori të veçanta, si fëmijët me autizëm dhe persona të tjerë me nevoja specifike. Në fund të diskutimit, kryetari u ndal edhe te debati lidhur me raportet dhe statistikën, duke theksuar se cilësia e një raporti nuk matet me numrin e faqeve, por me përmbajtjen dhe rëndësinë e çështjeve që trajton. Ai vlerësoi se secili drejtor duhet të ketë lirinë të paraqesë raportin sipas qasjes dhe përkushtimit profesional, ndërsa interpretimi i statistikave duhet parë në kontekstin e tyre dhe jo vetëm përmes vëllimit të raportit.

Kryesuesi thekson është shterrë debati për këtë pikë andaj rikthehem tek pika e 4-të: Propozim-vendimi për destinimin e parcelës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe fushave të padelit. Sa i përket preambulës, kemi pasur pyetje lidhur me nenin 9 dhe 26. Besoj se nuk ka nevojë ta lexojmë, sepse është sqaruar qartë në preambulë se Kuvendi ka të drejtë të vendosë, pa thirrje publike, për caktimin e parcelave në interes të vet. Pra, nuk ka nevojë për thirrje publike kur bëhet fjalë për pronën e komunës dhe për investimet e institucioneve të saj. Po ashtu, sa i përket çështjes së pronës, besoj se hapësira është e mjaftueshme edhe për fushën që është dhënë më herët në raport me Trepçën për futboll, por edhe për këtë hapësirë tjetër. Konfirmi u bë edhe nga drejtorët që hapësira është në rregull.

Kryesuesi i Kuvendit: Atëherë e hedh në votim Propozim-vendimin për destinimin e parcelës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe fushave të padelit me të gjitha vërejtjet që i kemi pasur, përfshirë edhe atë rreth numrit të parcelës, që ka qenë një gabim teknik, si dhe korrigjimet në preambulë, të cilat janë bërë sipas vërejtjeve të mëhershme.

Rezultati i votimit: 24 të pranishëm, 21 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstaton se miratohet vendimi për destinimin e parcelës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe fushave të padelit.

Pika e 7

Kryesuesi i Kuvendit: Po ashtu sa i përket Raportit të punës së Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë për periudhën janar–dhjetor 2025, fjalën ia kaloj drejtorit që ta arsyetoj.

Naser Muja: Raportin besoj se e keni para vetes secili. Është raporti për vitin 2025. Për mendimin tim, ky është një raport i mangët, madje me insistimin tim është përgatitur, sepse kur kam ardhur në detyrë nuk kishte fare raport. Unë kam kërkuar nga zyrtarët që ai të përfundohej. Megjithatë, sipas analizës që kam bërë, është një raport me shumë pak të dhëna. Mendoj se është dashur të përfshiheshin më shumë informacione, si p.sh. pranimet teknike të rrugëve, cilat punime janë realizuar e cilat jo. Këto nuk i kam gjetur në raport, edhe pse e kam analizuar me kujdes. Nëse ka dikush pyetje lidhur me raportin, jam i gatshëm të përgjigjem.

Kryetari i Komunës: Kjo është risi për mua. Zyrtarët janë vartësit tuaj, nëse nuk jeni i kënaqur me raportin, mund t'u dërgoni udhëzime apo kërkesa për plotësim dhe, nëse është e nevojshme, keni edhe të drejtën ligjore të ndërmerri masa ndaj atyre që nuk i kryejnë detyrat në mënyrë profesionale. Unë mendoj se çdo temë ia vlen të diskutohet. Nuk ka pyetje të keqe dhe nuk ka interesim të panevojshëm për problematikat. Gjatë kësaj seance kemi diskutuar shumë tema të rëndësishme, megjithatë, mendoj se kjo pikë është ajo ku do të duhej të kishte më së shumti diskutim. Nuk mund t'ia imponoj askujt diskutimin, por kjo është tema që lidhet drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve, infrastrukturën, projektet dhe çështje të tjera me interes për qytetarët. Më habit fakti që pikërisht për këtë temë nuk po kërkon askush fjalën.

Visar Sylja: Kam vetëm një pyetje për drejtorin. Sa kanë kushtuar matjet gjeodezike në Rrugën "Lah Nimani", sa kohë ka marrë realizimi i tyre dhe, bazuar në praktikën e zakonshme, sa kohë nevojitet zakonisht për kryerjen e këtyre matjeve?

Kushtrim Zeneli: Atëherë, pyetja ime është kjo, Drejtor: a mund të na tregoni çfarë po ndodh dhe çfarë ka ndodhur me projektin e rrugëve "Ali Zeneli" dhe "Lah Nimani"? Pyetja e dytë ka të bëjë me zgjerimin e rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimin e pusetave në Shalën e Bajgorës. Vazhdimisht, edhe gjatë mandatit të ish-drejtoreshës, kemi ndarë mjete në buxhet, herë 50.000 €, herë 100.000 €, e herë 150.000 €, por ende nuk kemi parë asnjë punë konkrete sa i përket ndërtimit të pusetave apo zgjerimit të rrjetit të kanalizimit në

Shalën e Bajgorës. Na tregoni ku ka mbetur puna dhe në cilën fazë janë procedurat. Po ashtu, kemi ngritur vazhdimisht si shqetësim çështjen e ujit të pijshëm, e cila prek sidomos fshatrat Rashan, Mazhiq dhe Tërstenë. Në vitin 2023, në vitin 2024, por edhe në buxhetin e vitit 2025, janë ndarë nga 50.000 €. Atëherë ka qenë zotimi i kryetarit dhe i drejtorit të atëhershëm se kjo çështje do të zgjidhej, mirëpo ende nuk është bërë asnjë investim. Këto mjete janë ndarë vit pas viti, ndërsa tashmë, për shkak të neglizhencës së qeverisjes së kaluar, rrezikon të dështojë një projekt që, nëse nuk gaboj, kushton rreth 500.000 € dhe i cili ka përfunduar si projekt qysh në vitet 2012–2014. Do të ishte mirë të na tregoni se në çfarë faze është funksionalizimi i stacioneve të pompave, si ka mbetur procedura dhe a keni ndonjë plan konkret për ta adresuar këtë çështje, duke pasur parasysh se banorët po përballen me mungesën e ujit të pijshëm, që është nevoja më elementare për jetën.

Xhevdet Osmani: Kam një pyetje: A është bërë pranimi teknik për rrugën e Shipolit dhe për rrugën Mbretëresha Teutë?

Igballë Islami: Sa i përket raportit, në momentin kur drejtori thotë se është raport i mangët, unë kam dy hamendësime. E para, a do të thotë se ka edhe më shumë punë të kryera që nuk janë përfshirë në raport? Nëse është kështu, atëherë kjo është diçka tjetër. Mund të kuptohet se raporti nuk i pasqyron të gjitha punët konkrete që janë realizuar. Nëse drejtori vlerëson se raporti është i mangët, atëherë kjo mund të nënkuptojë se zyrtarët e drejtorisë nuk i kanë përfshirë të gjitha aktivitetet. Ky është interpretimi im. Unë po vlerësoj se, nëse e ke lexuar materialin, bëhet fjalë për raportin e punës dhe jo për raportin e planifikimit për vitin 2025. Sa i përket përmendjes së ish-drejtoreshës, dua ta sqaroj një gjë, roli i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa është të planifikojë dhe të sigurojë mjetet buxhetore për vitin fiskal, nëse drejtoria përkatëse paraqet kërkesë. Nëse një projekt fillon, por gjatë Rrugës dështon procedura e prokurimit, kjo nuk është përgjegjësi e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa. Është e çuditshme që një ish-anëtar i Kuvendit, i cili ka qenë i informuar për raportet financiare dhe për nivelin e pagesave të urdhrave përmbartimorë që Komuna e Mitrovicës ka ekzekutuar gjatë dy viteve të fundit, ta ngrejë këtë çështje në këtë mënyrë. Nëse drejtori vlerëson se ka pasur edhe punë të tjera që nuk janë përfshirë në raport, atëherë zyrtarët që e kanë përgatitur raportin nuk kanë vepruar mirë, sepse në fakt i kanë bërë dëm vetë punës së tyre, duke mos i pasqyruar të gjitha aktivitetet e realizuara.

Kushtrim Zeneli: Drejtor, meqë ky është raport i punës, a mund të na tregoni ku janë investuar 50.000 € e ndara për funksionalizimin e stacionit të pompave të ujësjellësit në Mazhiq dhe Tërstenë? A mund të na tregoni ku janë investuar mjetet për zgjerimin e rrjetit të kanalizimit dhe puseta në Shalën e Bajgorës?

Naser Muja: Për pyetjen e znj. Islami, kur thashë “i mangët”, e kam thënë në kuptimin se nuk janë cekur specifikat e secilës rrugë: çfarë ka ndodhur me to, ku kanë arritur, a janë përfunduar apo jo, a ka pranim teknik apo jo. Në këtë kuptim e kam thënë. Edhe një herë po e përsëris: zyrtarët me siguri nuk do ta kishin bërë fare këtë raport, por unë i kam detyruar dhe ai është përgatitur në muajin mars. Sa i përket pyetjeve të tjera, konkretisht Rruga “Lah Nimani” së pari, te lidhja e kontratës, vlera e parashikuar ka qenë 600.000 €, ndërsa kontrata e lidhur është 892.000 €, pra ka një tejkalim prej rreth 292.000 €. Sa i përket matjeve gjeodezike, për këtë rrugë çmimi ka qenë 39 € për metër gjatësi dhe është aplikuar i njëjti çmim për kanalizimin sekal dhe atmosferik. Këto matje zakonisht përfundojnë për një ditë pune dhe kanë mundur të realizohen edhe nga shërbimet komunale, por nuk e di pse nuk është bërë kështu. Totali i realizuar në këtë kontratë është 674.798 €, ndërsa vlera e pa realizuar është 217.655 €. Ka pasur pengesa në terren, por leja ndërtimore është lëshuar për të dy rrugët, si për “Lah Nimani” ashtu edhe për “Ali Zeneli”. Nuk e di si është lëshuar leja ndërtimore kur ende ka çështje të pazgjidhura të shpronësimit. Te Rruga “Ali Zeneli”: Kjo është Rruga që është përmendur më së shumti dhe ka qenë pjesë e premtimeve se do të hapej në vitin e parë, të dytë apo të tretë, por kanë kaluar katër vite dhe ende nuk është hapur. Nuk po them se nuk kemi probleme edhe ne, por këto probleme ekzistojnë. Edhe këtu leja ndërtimore ka qenë e lëshuar në tërësi. Totali i pagesave në rrugën “Ali Zeneli” ka kaluar vlerën 848.000 €. Janë realizuar rreth 300 metra rrugë gjatësi, ndërsa kanë mbetur edhe rreth 400 metra pa u realizuar. Ka mbetur një pjesë e projektit e pa realizuar për shkak të problemeve me pronën. Në total janë shpenzuar rreth 848.000 € për 300 metra rrugë të realizuar.

Kryetari i Komunës: Kryetari kërkoi që përgjigjet të jenë më konkrete dhe të fokusohen në informimin e qytetarëve. Ai kërkoi që të flitej me të dhëna konkrete lidhur me projektin në rrugën “Ali Zeneli”, duke theksuar se nga vlera totale e kontratës prej 1,259,165 €, janë shpenzuar rreth 840,000 €, ndërsa janë realizuar 300 metra të projektit, me rreth 400 metra të mbetur pa u përfunduar, përfshirë edhe problemet që lidhen me çështjet pronësore. Ai kërkoi që të sqarohet qartë se sa për qind e projektit është implementuar dhe sa për qind e mjeteve financiare të kontratës janë shpenzuar, në mënyrë që qytetarët të kenë një pasqyrë të saktë mbi ecurinë e projektit.

Naser Muja: Sqaroj se, sipas të dhënave të prezantuara, në projektin e Rrugës “Ali Zeneli” janë realizuar rreth 300 metra punime, ndërsa vlera totale e kontratës është 1,259,165€.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci theksoi se rreth 410,000 € kanë mbetur të parealizuar, duke vlerësuar se në aspektin financiar kontrata është realizuar afërsisht 70%, ndërsa realizimi fizik i punimeve është më pak se 50%. Sipas tij, kjo mospërputhje ka ardhur kryesisht si pasojë e problemeve me pronësinë, çështjeve juridike dhe lëshimit të lejeve pa u zgjidhur plotësisht këto çështje. Është mirë që është këtu edhe asamblisti dhe ish-drejtoresha e Financave, sepse duhet theksuar se njëra prej detyrave të Drejtorisë së Financave është të sigurojë disponueshmërinë e mjeteve për kontratat dhe tenderimet. Në këtë rast, ju nuk i keni pasur mjetet, por e keni lejuar që institucioni ku keni qenë drejtorësh të hyjë në raport kontraktual. Kjo nuk mund të ndodhë në qeverisjen time. Mbani mend mirë këtë: nuk ka shans të nënshkruhet kontratë pa disponueshmëri të mjeteve. Disa që dinë më pak mendojnë se dinë më shumë se ata që janë kompetentë, por në prezantime publike nuk duhet të veprohet kështu. Pyetja e z.Syla ishte shumë konkrete: sa është çmimi referent për matjet gjeodezike? Nëse matjet gjeodezike kushtojnë nga 2 deri në 5 €, atëherë në qeverisjen paraprake një matje e tillë për metër ka kushtuar 39 €. Kjo është një punë që një zyrtar mund ta kryejë për gjysmë dite. Tash merrni metrat e Rrugës “Lah Nimani” dhe e krahasoni me 39 € për metër. Lidhe nëse e marrim 5 €, diferenca është e madhe. Mund të shtojmë edhe 10 € si bonus, por kjo tregon nivelin e përgjegjësisë dhe çfarë ka ndodhur në proceset e investimeve kapitale: dështime, parregullsi, keqmenaxhim dhe keqpërdorim financiar. Prandaj, sa herë që flasim për këto çështje, duhet të kemi parasysh mënyrën si menaxhohen investimet publike dhe përgjegjësinë institucionale. Unë operoj mbi bazën e fakteve dhe gjendjes faktike. Në opinionin publik dhe në televizione, tani varet kush sa “e gjuan bonuesin”. E gjuan bonuesin dhe je më i miri. Në fushatën e fundit, p.sh., një vajzë e re është prezantuar si “menaxhere e jashtëzakonshme”. 22 vjet ka ajo vajzë, ndoshta mund të jetë shumë e mirë, ndoshta edhe më e mira në Kosovë në perspektivë. Thonin “menaxhere e jashtëzakonshme” në moshën 22-vjeçare. Në 18 vjet përfundohet shkolla e mesme, në 19 fillohet fakulteti. Historia më e mirë për një vajzë 22-vjeçare është ta përfundojë fakultetin. Por në televizion paraqitet si më e mira në menaxhim. Pra, ajo që flitet në opinion dhe gjendja faktike janë dy gjëra të ndryshme. Ndërhyrjet duhen bërë duke u bazuar në fakte. Të lutem vazhdo drejtor me sqarimet tjera.

Naser Muja: Po vazhdojmë. Vlera e parashikuar për projektin në rrugën “Ali Zeneli” ka qenë rreth 900.000 €, ndërsa kontrata është nënshkruar në vlerë prej 1.259.000 €. Pra, tejkalimi është rreth 359.000 €. Sa i përket çmimit të shënimit për rrugë në metër gjatësi, këtu është 29 € për metër, ndërsa më herët është përmendur 39 €. Gjatë ekzekutimit janë hasur punë me cilësi të dobët. Skajet e betonit të vendosura rreth asfaltit kanë cilësi të dobët. Sipas paramasave të parashikuara, ai beton nuk guxon të ndryshojë formë për 20 vite, ndërsa sot kemi dëshmi në rrugën “Ali Zeneli” dhe në rrugën “Lah Nimani” që disa pjesë kanë filluar të degradohen plotësisht. Kjo mund të shihet edhe me sy. Pse është pranuar dhe si është realizuar, nuk e di, por nuk është dashur të ndodhë kështu. Pastaj kemi edhe rastin e Rrugës “Mbretëresha Teutë”. Po ashtu, është Rruga “Beslim Bajgora Rr. Dëshmorët e Kombit”. Edhe Rruga “Shipol” apo “Dëshmorët e Kombit”, që është përmendur më herët si një rrugë shembull. Unë kisha thënë të kundërtën, që është një rrugë ku pas një viti të gjitha puscat dhe elementet e tjera kanë ndryshuar. Forma e saj është tejte e dëmtuar. Sot, nëse shkohet atje, shihet se ka filluar dëmtimi i asfaltit në të gjitha pjesët e Rrugës. Ka qenë i parashikuar një rreth të zona që e quajmë të “Shelnja” ose të “Nënë Tereza”, por është vendosur brenda natës në mes të Rrugës dhe është hequr pa procedurë të prokurimit. Do të thotë është bërë rrethi dhe të nesërmen në mëngjes ka ndodhur një aksident, pas së cilës është larguar rrethi. Dikush prej jush që jetoni në Shipol e keni parë atë element të sinjalizimit. Ka pasur edhe dy herë vendosje të elementeve të rinj në

atë pjesë. Pjesa e Rrugës është dëmtuar. Janë vendosur elemente sinjalizimi, pastaj janë hequr dhe më pas janë vendosur përsëri të rinj. Realizimi nuk është bërë plotësisht në mënyrë të arsyeshme. Pozicionet me çmime më të ulëta nuk janë prekur fare. Janë realizuar pozicionet që kanë pasur çmime më të larta. Janë realizuar rreth 603.000 €, ndërsa kanë mbetur pa realizuar 174.000 €. Në bazë të asaj që kemi vërejtur në paramasë, çmimet më të ulëta nuk janë prekur, gjë që lë hapësirë për dyshime se diçka nuk ka shkuar siç duhet në procesin e mbikëqyrjes apo menaxhimit. Patëm edhe rrugën “Mbretëresha Teutë”. Është Rruga më problematike dhe nuk e di pse ka ndodhur që është konsideruar e përfunduar, por në fakt nuk është përfunduar. Aty janë paguar rreth 75.000 € për punimet, ndërsa rreth 275.000 € kanë mbetur borxh ndaj operatorit. Është bërë një pranim teknik jashtë çdo rregulle. Ka pasur shumë polemika dhe komunikime ndërmjet zyrtarëve. Sot operatori pretendon se ka mbetur me obligime të papaguara, por ne nuk kemi obligime ndaj operatorit. Obligimet janë të qeverisjes paraprake. Rruga nuk është punuar mirë. Shtyllat e ndriçimit publik janë dëmtuar; sot gjysma e tyre janë të shtrembëruara ose të dëmtuara, ndoshta nga ndonjë kontakt i lehtë, dhe kanë mbetur në atë gjendje. Ne nuk marrim përgjegjësi për këtë rrugë. Nuk ka pranim teknik të rregullt, por vetëm një pranim teknik formal që nuk i plotëson kushtet. Nuk e di si ka ndodhur, dhe për këtë arsye nuk janë bërë pagesat.

Igballe Islami: Urdhëro, fillimisht, jo nuk është kreu mbrapsht. E di pse, kryetar, sepse kështu siç po diskutojmë, po kthehemi te ajo që ti e the, dhe ne kemi të drejtë me e trajtuar këtë çështje. Fillimisht, drejtori aktual dhe asamblistët që sot po flasin kanë qenë asamblistë edhe në mandatin e kaluar. Kanë qenë në dijeni për çdo shpenzim që është bërë në këto rrugë dhe kanë pasur mundësi t'i ngrisin këto çështje në asamble, pasi i kanë pasur raportet financiare. Dy rrugët për të cilat po flasim janë realizuar me procedurë të hapur.

Ju e dini si funksionon. Është me procedurë të hapur dhe të gjitha specifikat, parametrat dhe elementet e tjera janë vlerësuar nga komisioni vlerësues në zyrën e prokurimit. Kontratat janë të hapura. Nuk ka nevojë askush me pyet sa ka kushtuar. Tash ndoshta ne me pyet çështje njëjtë si me pyet sa kushton ura atje te Vidimri, që është rreth 4 milionë, sikur të ishte sekrete. Vetë e thatë që janë paramasa sekrete, por pas një viti thuhet që janë sekrete. Kjo kontratë është publike dhe është realizuar përmes prokurimit publik. Duhet të thëksohet kjo. Për rrugën “Ali Zeneli”, kontrata ka qenë 1.2 milionë €. Nuk e di saktësisht për sa metra asfalt ka qenë e parashikuar, por besoj që ka qenë për totalin e projektit në hapësirën e shpronësuar. Ne nuk mund të hamendësojmë këtu. Unë nuk e di saktë dhe besoj që kontrata është bërë për hapësirën e shpronësuar. Menaxheri i kontratës nuk është staf i kabinetit apo i ekzekutivit, por janë zyrtarët që i kanë pranuar punimet. Sa është shpenzuar dhe si është realizuar, janë çështje që i kanë pasur asamblistët në raportet financiare dhe kanë mundur t'i trajtojnë më herët. Në terren, gjendja faktike nuk është e njëjtë. Sot po flasim në retrospektivë: kanë kaluar dy vite që kur janë kryer punimet në rrugët “Shipol”, “Ali Zeneli” dhe “Lah Nimani”, dhe qytetarët nuk mund ta mohojnë që ka pasur progres, pasi kanë qenë rrugë me problematika të shumta. Ne nuk po themi që Rruga “Ali Zeneli” është e përfunduar plotësisht, as Rruga “Lah Nimani” nuk është e përfunduar. Por pjesa tjetër e punimeve është buxhetuar dhe vazhdon të jetë pjesë e obligimeve kontraktuale. Për pjesën e mbetur të kontratës, është bërë edhe buxhetim shtesë me kërkesë të drejtorisë, për punime shtesë në rrugë.

Valon Brahimi: Çështja e lejes ndërtimore nuk është problem nëse projekti zhvillohet gjatë Rrugës, sepse pa leje ndërtimore nuk mund të fillojë asgjë ky është kushti i parë. Pyetja ime është: çfarë është bërë për gjashtë muaj për vazhdimin e 300 metrave të Rrugës? A është ndërmarrë ndonjë veprim që Rruga të vazhdojë më tutje? A është bërë ndonjë shpronësim? A është realizuar ndonjë metër asfalt shtesë që e mundëson vazhdimësinë e projektit? Në një pushtet janë realizuar 300 metra për gjashtë muaj. Cili është progresi që Rruga të vazhdojë më tej? Po të kursej në shumë çështje, sepse disa tema janë për drejtorët që të vijnë me propozime dhe ide. Por ka tema që nuk mund të anashkalohen. Jo 301 metra, 300 metra e 1 centimetër nuk mund të shkojë pa u respektuar procedura ligjore dhe administrative.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Ka disa tema për të cilat nuk lëshoj pe. Drejtori mund të më plotësojë me ndonjë sqarim tjetër, por është shumë e rëndësishme ajo që po them. Jo 301 metra, por as 300 metra e një centimetër nuk shkon pa i pasur të qarta procedurat ligjore dhe administrative. Jo, nuk kemi bërë asgjë, sepse nuk shkon. Nëse dikush ka pasur guximin të vazhdojë 300 metra me gjithë ato shkelle të rënda ligjore, qeverisja ime nuk shkon as një centimetër pa bazë të qartë ligjore. Kjo nuk lidhet me përpjekjen për të thënë

se ne nuk kemi bërë asgjë. Nuk shtrohet as një metër asfalt apo zhavorr pa u qartësuar paraprakisht baza ligjore dhe administrative. Sa i përket shpronësimeve, drejtori i Urbanizmit mund të tregojë se ka takime të vazhdueshme çdo javë për këtë çështje. Shpronësimet është dashur të përfundonin para se projekti të pajisej me leje ndërtimore. Procedura është e qartë: fillimisht bëhet shpronësimi, pastaj merret leja ndërtimore dhe vetëm më pas fillojnë punimet. Prandaj, si qeverisje nuk jemi të interesuar të shtrojmë asnjë centimetër asfalt pa pasur bazë të qartë ligjore. Sa i përket pranimeve teknike, të cilave iu referua Igballi, është e vërtetë se ato kryhen nga shërbyes profesionistë. Megjithatë, kemi një projekt ku të gjithë shërbyesit profesionistë kanë refuzuar ta pranojnë teknikisht. Pastaj është kontraktuar një kompani, pas një periudhe prej dy vjetësh e dy muajsh nga afati i përfundimit të Rugës “Mbretëresha Teutë”, e cila ka bërë pranimin teknik. Kjo nuk është bërë nga ekzekutivi; dikush tjetër ka pretenduar se kompania ka pasur të drejtë dhe autorizim për ta bërë pranimin teknik, ndërkohë që problemet janë shumë më të thella. Drejtori mund të japë sqarimet teknike, drejtori i Urbanizmit mund të tregojë deri në cilën fazë kanë arritur shpronësimet, ndërsa unë, si kryetar i komunës, e them qartë: sa të jem unë në dijeni, nuk shtrohet asnjë centimetër asfalt pa u qartësuar plotësisht çështjet ligjore dhe administrative.

Valon Brahim: Theksoi se, sipas dijenisë së tij, nuk është ndërmarrë asnjë veprim lidhur me shpronësimet, duke shtuar se çështja e këmbimit të pronave duhet të sillet për shqyrtim në Kuvend Komunal. Ai kërkoi sqarime se çfarë veprimesh konkrete janë ndërmarrë gjatë gjashtë muajve të fundit për të mundësuar vazhdimin e punimeve në rrugën “Lah Nimani”.

Shkëlqim Ibrahim: Kryetar, desha vetëm të të pyes diçka. Në këto dështime, a ka pjesë përgjegjësie drejtori Muja? Veç na trego paraprakisht si e ka gjetur gjendjen dhe si na e ka lënë.

Dua të them se kemi gjetur kontrata me mjete të zotuar prej 120.000 €, ndërsa kontrata të nënshkruara në vlerë prej 500.000€. Kështu që, drejtor, paraprakisht duhet të na tregosh si e ke gjetur gjendjen dhe si na e ke lënë, sepse aty ka pasur borxhe të vazhdueshme. Ne mund të tregojmë çfarë kemi bërë, sepse i kemi edhe rastet në prokurori, por fillimisht duhet të na thuash si e ke gjetur gjendjen dhe si e ke lënë.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Shumë shkurt dua të ndërhyj. Unë nuk e di drejtori z. Muja e ka në diskrecionin e tij nëse dëshiron të përgjigjet. Unë nuk i di në detaje ngjarjet e periudhës së mëhershme. Jam qytetar i këtij qyteti dhe i kam parë projektet që janë realizuar, por jo çdo detaj. Sa i përket çështjes së borxheve, për to është diskutuar edhe në mandatin e kaluar. A e dini sa borxhe ka aktualisht Komuna e Mitrovicës? Nuk e di nëse e keni kërkuar atë informacion. Unë po e marr përsipër që në seancën e ardhshme t'juja sjell pasqyrën e borxheve të Komunës së Mitrovicës. Nuk ka qeverisje që e përfundon mandatin pa mbetur ndonjë obligim financiar. Çështja është si interpretohen ato, sepse ka projekte shumëvjeçare dhe kontrata që zgjasin dy apo tre vjet. Nuk mund t'i ndërpresësh ato në momentin që përfundon mandati dhe të thuash se nuk ekzistojnë më obligime. Prandaj, kush pretendon se mund të marrë një qeverisje pa asnjë obligim të trashëguar, nuk e njeh mënyrën se si funksionon qeverisja. Kjo nuk është e mundur, as teorikisht e as praktikisht. Megjithatë, përgjegjësinë duhet ta japim në fund të mandatit, jo në fillim. Jemi ende në fillim të mandatit dhe për këtë arsye nuk mund të bëjmë vlerësime përfundimtare. Mos na pyetni neve se çfarë ka lënë Naseri. Nëse Naseri dëshiron, ai mund të përgjigjet vetë. Po, çdo gjë ka ndikim. Edhe një mizë po të hyjë këtu ka ndikim; ndoshta nuk shkakton ndonjë dëm të madh, por krijon shqetësim. Naseri, jepi një sqarim sa më të shkurtër për ata që janë kureshtarë. Ardian, vazhdo me çështjen e shpronësimeve.

Ardian Kavaja: Sa i përket Rugës “Lah Nimani”, besoj se jeni të njoftuar që dy herë ka pasur kërkesa për këmbimin e asaj prone. Për ta kuptuar më qartë edhe qytetarët që na përcjellin, bëhet fjalë për një shtëpi problematike. Në vitin 2023, kur drejtor i Drejtorisë së Kadastrit ishte z. Valon, ka përfunduar i gjithë procesi i këmbimit të pronës në rrugën “Lah Nimani”. Besoj se e dini shumë mirë se çfarë ka ndodhur. Pasi kishte përfunduar vlerësimi i dy pronave komunale dhe i pronës së shtëpisë, pronarit të atëhershëm, i cili tani është ndërtues, iu kërkua nga Drejtoria e Kadastrit që të fillonte rrënimin e shtëpisë në mënyrë që të hapej Rruga. Pronarja e shtëpisë e ka filluar rrënimin. Nuk e di për çfarë arsyeje Komuna e Mitrovicës, përkatësisht Drejtoria e Kadastrit dhe Urbanizmit, pa dashur të paragjykoj, ka kërkuar që të bëhej edhe një herë vlerësimi dhe ka nisur procedura për rivlerësimin e asaj shtëpie. Në vitin 2023, shtëpia ishte vlerësuar me 85.000 €. Kur u bë vlerësimi i dytë, Ministria e Financave konstatoi se shtëpia ishte e demoluar dhe nuk kishte nevojë të rivlerësohej, duke e përcaktuar vlerën e saj në zero. Kur kemi shkuar në Departamentin e

Pronës në Prishtinë, kemi gjetur dy raporte vlerësimi. Si komunë, nuk kemi vendosur të vazhdojmë procedurën e këmbimit duke u bazuar në raportet e mëparshme, sepse raporti i vitit 2023 nuk përputhet me raportin e vitit 2025. Në vitin 2023 shtëpia ishte vlerësuar me 85.000 €, ndërsa në vitin 2025 ishte vlerësuar me zero. Me cilin raport do të duhej të vepronim? Nëse do ta kishim pranuar raportin e vitit 2023, dikush me të drejtë do të pyeste mbi çfarë baze është pranuar ai raport, kur ekziston një raport tjetër zyrtar. Prandaj, besoj se gjatë këtij muaji kemi vazhduar procedurën nga fillimi, duke iniciuar sërish procesin e këmbimit dhe duke parë mundësitë se si mund të procedohet më tej. Mua thjesht më ka interesuar pse nuk ka përfunduar procedura. Çdo gjë ka qenë në rregull. E keni detyruar pronarin ta demolonte shtëpinë dhe ai e ka bërë këtë. Atëherë, pse nuk është shkuar deri në fund? Pse është kërkuar edhe një herë vlerësimi? momentin që Zyra Ligjore, në këtë rast përmes Drejtorisë së Kadastrit, ka kërkuar edhe një herë vlerësim, Ministria e Financave ka kthyer përgjigje dhe ka bërë rivlerësimin, ku sërish e ka vlerësuar pronën me vlerë zero. Kjo është situata. Tani ne, si ekzekutiv i ri dhe si qeverisje e re, po e vazhdojmë procedurën nga fillimi. Mënyra se si Ministria e Financave e bën vlerësimin është kompetencë e saj; ajo e vlerëson pronën sipas gjendjes faktike që e gjen në terren..

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: z. Brahimi fatkeqësisht, për herë të parë nuk kam mundur ta përcjell Kampionatin Botëror në futboll. Megjithatë, dua t'ju përgjigjem me një analogji nga futboli, meqenëse ju e nisët diskutimin me tema më të rënda, ndërsa unë po e trajtoj pak më lehtë. Është njësoj sikur, sipas rregullave të lojës, dikush ta shënojë golin në minutën e 90-të dhe më pas t'i thuhet se UEFA dhe FIFA i kanë ndryshuar rregullat e lojës, prandaj ai gol nuk vlen. Ose të thuhet se distanca e pozitës jashtë loje nuk matet më si më parë, por me një kriter tjetër, kur gjatë gjithë lojës ka qenë në fuqi një rregull tjetër. Me fjalë të tjera, rregullat e lojës nuk mund të ndryshohen në mes të procesit. Motivet që kanë qenë pas kësaj nuk dua t'i paragjykoj. Mund të kenë qenë plotësisht objektive dhe me qëllim të mirë. Ndoshta dikush ka konstatuar se është bërë ndonjë gabim. Nuk dua të paragjykoj askënd. Mirëpo, mënyra se si është menaxhuar çështja e përpjekjes për këmbimin e pronës dhe procesi i vlerësimit ka qenë skandaloz dhe me shkelje të rënda ligjore. Është shkelje e rëndë ligjore të bëhet një vlerësim, të fillojë rrënimi i objektit dhe më pas të thuhet se procedura ndalet dhe se duhet të fillojë një vlerësim i ri, kur ndërkohë gjendja faktike në terren dhe në pronë ka ndryshuar. Ne nuk jemi të interesuar vetëm që të përfundojnë 100 metra asfalt. Nuk do të lejoj që askush të veprojë jashtë rregullave, procedurave ligjore, objektivitetit dhe transparencës. Edhe nëse bëhen vetëm 100 metra asfalt, është e rëndësishme që secili qytetar ta dijë se ato janë realizuar në përputhje me procedurat ligjore, e jo duke filluar punimet, duke futur makineritë, e më pas duke u kthyer në ministri për të ndryshuar vendimet. Kjo mënyrë e veprimi nuk është e pranueshme. Qytetarët nuk e vlerësojnë një qeverisje vetëm nga numri i metrave të asfaltit të shtruar.

Valon Brahimi: Nëse vërtet konsideroni se ka pasur shkelje të rënda ligjore, unë ju inkurajoj që t'i adresoni ato në institucionet kompetente. Unë, juve si Kryetar i Komunës, po ju kërkoj që, duke qenë se keni ardhur në pushtet me premtimin se do të realizoni punë të mira për qytetin, të na tregoni se si do ta hapni rrugën Limani dhe rrugën Ali Zeneli, si dhe kur planifikoni t'i përfundoni këto dy projekte, meqë po thoni se do ta vazhdoni procedurën.

Xhylljeta Imeri: Për momentin, po flitet jashtë pikës së rendit të ditës. Ju lus që, për hir të mbarëvajtjes së mbledhjes dhe për të na kursyer të gjithëve kohë, të respektojmë kufizimet për marrjen e fjalës sipas Rregullores së Punës. Besoj se rregullorja e përcakton qartë këtë çështje. Marrja e fjalës për çdo imtësi e zgjat panevojshëm diskutimin dhe, sinqerisht, krijon një ngarkesë të panevojshme për të gjithë të pranishmit.

Kryesuesi i Kuvendit: Faleminderit, znj. Imeri. Keni plotësisht të drejtë theksoi se Rregullorja e Punës ua garanton anëtarëve të Kuvendit të drejtën e diskutimit një herë për secilën çështje, ndërsa ndërhyrja e dytë lejohet vetëm në formë replike. Ai bëri thirrje për respektimin e rregullores dhe të kohës së mbledhjes, duke theksuar se, ndonëse deri më tani ka pasur tolerancë për diskutime shtesë, kjo ka ndikuar në zgjatjen e seancës.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Z. Brahimi, po ta kthej përgjigjen lidhur me këtë çështje. Në njërën prej pyetjeve që ia kam drejtuar drejtorit, përgjigjen e ka dhënë edhe asamblisti Stavilevci. Kur e kam pyetur nëse kanë përfunduar Rruga "Lah Nimani" dhe Rruga "Ali Zeneli", besoj se jeni dëshmitarë që

është thënë se të dyja rrugët kanë përfunduar. Tani po vijmë në përfundimin se ato nuk kanë përfunduar plotësisht, prandaj duhet t'i ndajmë çështjet veç e veç. Sa i përket Rrugës Limani, z. Kavaja e sqaroi se realizimi i saj është rreth 50%. Pyetja që shtrohet është: çfarë është thënë më herët, nëse Rruga është përfunduar apo jo? Duhet të kemi një sqarim të qartë për këtë çështje. Sa i përket Rrugës Limani, ekzistojnë dy raporte vlerësimi, një i vitit 2021 dhe një i vitit 2023. Ne nuk mund të vazhdojmë me raportin e vitit 2021, sepse gjendja faktike ka ndryshuar dhe objekti në fjalë tashmë nuk ekziston. Po ashtu, nuk mund të vazhdojmë as vetëm me raportin e vitit 2023, për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në terren. Për këtë arsye, ne kemi kërkuar nga Ministria e Financave që të bëjë një vlerësim të ri dhe më pas të vazhdojmë me procedurën e këmbimit të pronave. Kërkesa është bërë dhe aktualisht jemi në pritje të përgjigjes nga Ministria e Financave për të realizuar vlerësimin e ri dhe për të vazhduar më tej procedurat për hapjen e Rrugës. Besoj se Rruga Limani do të mund të hapet deri në fund të vitit të ardhshëm, duke pasur parasysh procedurat që duhet të ndiqen dhe kohën që mund të marrë procesi në Ministrinë e Financave. Nga ana jonë, ne i kemi ndërmarrë të gjitha veprimet që kanë qenë të nevojshme. Kemi kërkuar vlerësimin e ri dhe tashmë jemi në pritje të përgjigjes. Sa do të zgjasë ky proces, mbetet për t'u parë dhe për këtë mund të diskutojmë më tej.

Naser Muja: Ai tha se i mbetet borxh t'i përgjigjet pyetjes së asamblistit. Sipas tij, është e vërtetë se në kohën kur është bërë pranim-dorëzimi i detyrës kanë ekzistuar fatura të padorëzuara, por ato kanë qenë të shoqëruara me pranim teknik dhe me raport të organit mbikëqyrës. Ai u shpreh se nuk e di pse ato nuk janë dorëzuar me kohë, pasi kanë qenë në zyrat e komunës, ndërsa punimet ishin realizuar në përputhje me kontratat. Ai rikujtoi se edhe më herët i kishte kërkuar kryetarit Bedri Hamza që të pranoheshin faturat që ishin të shoqëruara me raportet përkatëse, pasi ato përbënin obligime të komunës. Sipas tij, kjo edhe ka ndodhur, pasi faturat janë pranuar dhe janë përfunduar brenda rreth një muaji. Më tej, ai tha se gjendja aktuale është edhe më e rëndë se ajo e mëparshme, pasi tani po paraqiten fatura të padorëzuara për punë të kryera gjatë vitit të kaluar, të cilat, sipas tij, nuk janë pranuar nga zyrtarët përgjegjës. Ai tha se nuk e di arsyen e mospranimit, por theksoi se do të kishte qenë më mirë sikur ato të ishin deklaruar me kohë. Sipas tij, fillimisht janë deklaruar rreth 1.5 milionë euro obligime të shoqëruara me pranim teknik, ndërsa vetëm gjatë ditës së sotme kanë arritur edhe rreth 600 mijë euro fatura të tjera të padeklaruara. Ai theksoi se komuna është e obliguar t'i pranojë këto fatura, por paraprakisht duhet të verifikohet pse nuk janë dorëzuar me kohë, nëse përgjegjësia bie mbi organin mbikëqyrës, projekt menaxherin apo ndonjë zyrtar tjetër. Në fund, ai shtoi se situata e mëparshme ka qenë më e menaxhueshme, sepse obligimet ishin të deklaruara, edhe pse me vlerë më të madhe, ndërsa kontratat dhe punimet ishin të përfunduara dhe i gjithë procesi ishte mbyllur brenda një periudhe rreth njëmuajore.

Kushtrim Zeneli: Ai tha se kjo është një çështje me interes për qytetarët dhe se ka marrë vëmendje të madhe mediatike. Sipas tij, lidhur me çështjen e mbjelljes së luleve janë bërë deklarime të ndryshme edhe nga asamblistët. Ai kërkoi që drejtori të japë një sqarim si për anëtarët e Kuvendit, ashtu edhe për qytetarët, duke shpjeguar se çfarë ka ndodhur me atë marrëveshje dhe me kontrollin e ushtruar. Gjithashtu, ai kërkoi të sqarohet se për cilën periudhë kohore bëhet fjalë në lidhje me çështjen e mbjelljes së luleve në Mitrovicë.

Kryesuesi i Kuvendit: Theksoi se dëshiron të japë vetëm një sqarim, duke rikujtuar se, në cilësinë e tij si kryesues, e ka për obligim të sigurojë mbarëvajtjen e diskutimit. Ai u shpreh se nuk po tregohet konsideratë ndaj pikës që është në shqyrtim. Ai sqaroi se drejtori nuk ka obligim t'u përgjigjet pyetjeve që nuk lidhen me raportin në diskutim, pasi në fillim të mbledhjes është miratuar si pikë e veçantë raporti për vitin 2025. Sipas tij, pyetjet lidhur me çështjen e mbjelljes së luleve nuk kanë lidhje me raportin që po shqyrtohet. Ai shtoi se, pavarësisht se kjo mund të jetë një çështje me interes të madh për qytetarët dhe është diskutuar gjerësisht gjatë ditëve të fundit, diskutimi duhet të kufizohet në çështjet që lidhen drejtpërdrejt me raportin që është në rend dite.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Po, është diskutuar edhe ndër çështje të tjera, por mund të trajtohet edhe në kuadër të pyetjeve dhe përgjigjeve. Nuk dua që kjo çështje të mbetet pa sqarim, prandaj po i drejtohem z. Brahimi. Nuk e di saktësisht profesionin tuaj, por dua të theksoj se një pjesë e konsiderueshme e formimit tim akademik është e orientuar në fushën juridike. Për këtë arsye, jam i njohur me disa çështje që lidhen me përgjegjësinë ligjore të zyrtarëve publikë. Kur je në qeverisje, përgjegjësia nuk lidhet vetëm

me veprimet që mund të përbëjnë shkelje ligjore, por edhe me mosveprimin e një zyrtari publik, i cili në raste të caktuara mund të sjellë pasoja ligjore. Duke iu referuar edhe asaj që u tha më herët për adresimin e çështjeve në institucionet kompetente, dua të di nëse ka një qëndrim të qartë lidhur me këtë. Nuk po kërkoj domosdoshmërisht konfirmim, por një opinion lidhur me mundësinë që këto çështje të raportohen dhe të trajtohen në institucionet përkatëse. Për shembull, a duhet të përgatitet një raport lidhur me situata të trashëguara nga qeverisjet e mëparshme, ku kanë ekzistuar objekte që kanë funksionuar pa leje në institucione publike, apo raste kur janë shfrytëzuar hapësira publike pa autorizim? Ka pasur raste të raportuara edhe për lokale apo objekte të cilat kanë funksionuar pa leje dhe kanë përdorur hapësira të institucioneve publike, përfshirë edhe hapësira të Qendrës së Kulturës, ndërsa Inspektorati nuk ka ndërmarrë veprime të mjaftueshme gjatë periudhave përkatëse. Po ashtu, shtrohet pyetja se sa raste të reklamave pa leje, të cilat janë vendosur në qytet, janë evidentuar dhe trajtuar nga Drejtoria e Inspeksionit. Cilat kanë qenë veprimet konkrete të drejtorit dhe të inspektorëve lidhur me këto raste? Dua të di gjithashtu cilat kanë qenë veprimet ligjore dhe administrative të ndërmarra kur janë dhënë leje të kundërligjshme për ndërtime private në prona komunale, si në rastin e ndërtimit të objekteve private në hapësira publike. Nëse nesër dikush ju kërkon llogari për mosveprimet gjatë një mandati, përgjegjësia nuk mund të shmangët vetëm me arsyetimin se një çështje nuk është trajtuar. Ekzistojnë shumë raste për të cilat mund të kërkohej përgjegjësi institucionale. Sa i përket drejtorit aktual të Inspeksionit, unë besoj se ai ka vullnetin dhe angazhimin për ta kryer punën e tij dhe nuk kam dyshim në këtë drejtim. Megjithatë, përtej vullnetit personal, ekzistojnë edhe obligime ligjore dhe administrative që duhet të zbatohen. Për këtë arsye, herë pas here kërkoj informata lidhur me veprimet konkrete që duhet të ndërmerren. Gjithashtu, shtrohet pyetja se ku janë mediat dhe raportimet publike për raste të tilla. Sa media në Mitrovicë kanë raportuar për raste kur janë ndërtuar objekte private në prona komunale apo në hapësira publike? E di që nuk mund të trajtohen qindra raste brenda një dite, por duhet të ketë një qasje të organizuar dhe secili rast duhet të trajtohet një nga një deri në përfundim. Unë nuk po them se duhet të dërgohen shkresa vetëm për çështje të caktuara, por duhet të trajtohen të gjitha rastet, pavarësisht se për kë bëhet fjalë dhe cilat janë rrethanat. Kur këto shkresa dërgohen në institucionet përkatëse, shumë varet nga mënyra se si trajtohen ato dhe nga vullneti institucional për t'i adresuar. Nuk duhet të ketë trajtim selektiv apo ndikime politike në këtë proces. Prandaj, kur të filloj t'i dërgoj këto raste, dua të jetë e qartë se nuk bëhet fjalë vetëm për një çështje të vetme, por për të gjitha rastet ku ka pasur veprime apo mosveprime që duhet të shqyrtohen. Përfshirë këtu edhe çështje si dallimet në matjet e punëve të realizuara, kontratat e lidhura, ndryshimet ndërmjet vlerave të buxhetuara dhe atyre të realizuara, si dhe rastet kur është bërë pranim teknik për punë që pretendohet se nuk janë realizuar në tërësi. Pra, përveç veprimeve të gabuara, duhet të trajtohen edhe rastet e mosveprimit. Për të gjitha këto çështje do të ndërmarr hapa dhe do t'i adresoj një nga një.

Valon Brahim: Lidhur me çështjen e raportit me mediat, mendoj se edhe ju duhet t'i rregulloni raportet me gazetarët, pasi gazetarët e kanë punën e tyre dhe përgjegjësitë e veta. Sa i përket çështjes së pretendimit për gazetarë që kanë ndërtuar shtëpi në pronë publike, unë nuk kam informacion për një rast të tillë. Për çështjen e reklamave, kryetar, edhe më herët e kam sqaruar se menaxhimi i hapësirave publike, objekteve dhe reklamave është kompetencë e Drejtorisë së Urbanizmit. Ne nuk kemi të dhëna direkte për këto raste. Ne i drejtohem Drejtorisë së Urbanizmit dhe kërkojmë që të na përcillet lista e reklamave që dyshohet se janë vendosur pa lejet përkatëse. Sa i përket pronave publike dhe objekteve në pronësi publike, për shembull rastet që lidhen me ndërmarrje publike apo hapësira të tjera, duhet të sqarohet se kush ka dhënë leje dhe kush e ka refuzuar një kërkesë. Këto janë çështje që nuk mund t'u përgjigjem pa pasur informacionet përkatëse. Lidhur me çështjen e objekteve pa leje, dua të theksoj se nuk jam në dijeni që gjatë mandatit tim të jetë lejuar ndonjë ndërtim pa leje. Nëse pretendohet se ka ndodhur një rast i tillë, duhet të specifikohet konkretisht. Po ashtu, sipas Ligjit për Ndërtim, drejtori nuk ka kompetencë të inspektojë ndërtime. Këtë kompetencë e ka inspektori. Inspektori është ai që duhet të veprojë dhe të marrë vendime në bazë të ligjit. Roli i drejtorit në Drejtorinë e Inspeksionit është rol menaxherial. Drejtori nënshkruan vendimet për ekzekutim, por nuk mund të ndërhyjë në vendimmarrjen profesionale të inspektorit. Inspektori ka autonominë e tij ligjore dhe drejtori nuk ka të drejtë t'i ndikojë apo t'i ndërhyjë në vendimet profesionale. Nëse një inspektor nuk e kryen punën e tij, atëherë ekzistojnë procedura për përgjegjësi disiplinore.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Është e rëndësishme të kuptohet se autonomia e inspektorit nuk e përjashton përgjegjësinë menaxheriale të drejtorit. Unë pajtohem që zyrtarët publikë, përfshirë inspektorët, kanë autonominë e tyre profesionale, por kjo nuk do të thotë që drejtori nuk duhet të mbikëqyrë punën e drejtorisë. Po jap një shembull tjetër. Edhe në raste të tjera ku kam qenë përgjegjës, ka pasur kallëzime dhe kërkesa për sqarime. Përgjegjësia e një drejtuesi lidhet jo vetëm me vlerësimet profesionale, por edhe me gjendjen faktike dhe me obligimin për të ndërmarrë veprime kur ka informacione për probleme. Nuk mund të thuhet se nuk ka pasur dijeni për raste të caktuara, si për shembull për uzurpimin e hapësirave publike apo përdorimin e hapësirave të institucioneve publike. Unë pajtohem që inspektori ka autonomi, por duhet të dallojmë mes autonomisë dhe pavarësisë absolute. Kur ekzistojnë probleme që lidhen me sigurinë, respektimin e ligjit dhe interesin publik, duhet të ketë reagim institucional. Nuk po them që drejtori duhet të dalë vetë në terren dhe të kryejë punën e inspektorit, por duhet të ketë mbikëqyrje dhe përgjegjësi menaxheriale për punën që zhvillohet në drejtori.

Mujë Igrishta tha se dëshiron të japë vetëm një sqarim, duke theksuar se jetojnë në një vend të vogël dhe njihen mirë me njëri-tjetrin, si edhe me përgjegjësitë ligjore që kanë institucionet. Sipas tij, çdo aktvendim që nxjerr inspektori ka pasoja juridike dhe nuk duhet të paraqitet ndryshe nga sa është në të vërtetë. Ai theksoi se është e vërtetë që nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë në kompetencat e inspektorit, por sqaroi se, pasi inspektori nxjerr aktvendimin dhe e obligon palën të aplikojë në Drejtorinë e Urbanizmit, në rast se Urbanizmi e refuzon kërkesën, drejtori, në bazë të atij aktvendimi, është i obliguar të nxjerrë vendimin për rrënim dhe vendimin për ekzekutimin e tij. Më tej, ai iu referua rastit të objektit të njohur si “Hashtagu”, duke thënë se kërkesa për legalizim ishte refuzuar nga Urbanizmi më 14 gusht 2024 dhe se, sipas tij, pas këtij refuzimi nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim. Ai deklaroi se, sipas bindjes së tij, në këtë rast ka pasur ndërhyrje politike, ashtu siç, sipas tij, kishte ndodhur edhe në rastin e Sulejman Ukës. Gjatë debatit pati ndërhyrje nga drejtori, ndërsa ai kërkoi disa herë që të mos i ndërpritej fjala dhe të mos përdoren standarde të dyfishta. Ai theksoi se po fliste mbi bazën e dokumenteve dhe jo të pretendimeve, duke shtuar se nuk është e drejtë të thuhet njëherë se drejtori nuk ka kompetencë për të nxjerrë vendimin përfundimtar të ekzekutimit, e më pas të pretendohet e kundërta. Sipas tij, duhet të ketë qëndrim të qartë nëse kjo kompetencë ekziston ose jo. Në vijim, ai iu referua sërish dokumentacionit të vitit 2024, duke theksuar se, pas refuzimit të kërkesës nga Urbanizmi, nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim. Ai shtoi se situata është edhe më shqetësuese për faktin se, sipas tij, në disa raste inspektorët janë pezulluar nga veprimet e tyre pas ndërhyrjeve me telefonata. Në përfundim, ai ritheksoi se po i referohej dokumenteve zyrtare dhe se vendimi për ekzekutimin nënshkruhet nga drejtori, duke kërkuar që përgjegjësitë institucionale të mos shmangen.

Kryesuesi i Kuvendit tha se e kupton se kjo çështje është me interes të madh, si për anëtarët e Kuvendit, ashtu edhe për publikun. Megjithatë, ai kërkoi mirëkuptim dhe konsideratë për rolin e tij si kryesues, duke theksuar se është i obliguar të veprojë në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Ai sqaroi se detyra e tij është të sigurojë që diskutimet të zhvillohen brenda kornizës së pikës së rendit të ditës, të miratuar nga vetë anëtarët e Kuvendit. Sipas tij, pavarësisht dëshirës së anëtarëve për të trajtuar edhe çështje të tjera, roli i kryesuesit është t'i rikthejë diskutimet te pika për të cilën po zhvillohet shqyrtimi.

Mujë Igrishta: Ai tha se kjo nuk është hera e parë që ngrihen aludime të tilla dhe se për këtë çështje ka pasur edhe deklarime publike. Ai kujtoi se ishte thënë se, nëse mund të gjendet qoftë edhe një rast gjatë mandatit të tij ku nuk është vepruar sipas ligjit, ai do të ishte i gatshëm të merrte përgjegjësi. Më tej, ai iu drejtua drejtorit, duke theksuar se ky i fundit kishte nxjerrë dy vendime për rrënim, si dhe vendime për ekzekutim të nënshkruara prej tij, por, sipas tij, objektet nuk ishin larguar, pavarësisht se kërkesat për legalizim ishin refuzuar. Ai shtoi se e njëjta situatë kishte ndodhur edhe në rastin e kioskës së Sylejman Ukës. Sipas tij, drejtori kishte dhënë edhe një arsytim me shkrim, përmes emailit, ku kishte deklaruar se nuk kishte kompani të kontraktuar për realizimin e rënimeve.

Valon Brahim: Sqaroi se, në kohën kur drejtoreshë e DKRS ishte znj. Idrizi, kishte ekzistuar një listë me vendimet e nxjerra nga kjo drejtori për lirin e hapësirave publike në Qendrën e Kulturës. Sipas tij, çdo vendim që i ishte përcjellë Inspektoratit ishte ekzekutuar. Sa i përket rastit të objektit të njohur si “Hashtagu”, ai tha se, pas vendimit të Inspektoratit, objekti ishte larguar nga vetë pala. Ai shtoi se objekti ishte ndërtuar më vonë dhe kishte pasur një leje të përkohshme, ndërsa për zhvillimet e mëtejshme nuk

kishte informacion. Më tej, ai theksoi se Inspektorati nuk ka pasur mundësi të ndërhyjë në hapësirat e DKRS pa një kërkesë zyrtare nga kjo drejtori. Në fund, ai u shpreh se posedon ende një shkresë zyrtare nga Drejtoria e Urbanizmit, sipas së cilës objekti që funksionon si “Mitrovica Mall” i ishte refuzuar kërkesa për leje, me arsyetimin se, sipas planifikimit urban, në atë lokacion nuk ekziston mundësia e pajisjes me leje ndërtimore, pasi ishte paraparë vetëm ndërtimi i kulmit. Ai tha se objekti mbi “Mitrovica Mall” ishte rrënuar mbi bazën e vendimit përkatës. Sipas tij, vetëm një muaj pasi kishte dhënë betimin, objekti ishte ndërtuar sërish. Ai ngriti pyetjen se si objekti ishte pajisur më pas me leje ndërtimore, duke kërkuar sqarim nëse një leje e tillë ishte lëshuar apo jo.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Ai tha se edhe vetë i kishte parashtruar pyetje drejtorit, me qëllim që të ishte i informuar lidhur me këtë çështje. Ai propozoi që, në seancën e ardhshme, përveç pikave të tjera të rendit të ditës, shefi i grupit të asamblistëve ta përfshijë edhe këtë temë për shqyrtim të veçantë. Sipas tij, çështja duhet të trajtohet në kuadër të menaxhimit të pronave, duke përfshirë edhe ndërhyrjet, mosveprimet dhe të gjitha aspektet që lidhen me këtë fushë. Ai shtoi se, ashtu si edhe ju, kishte kërkuar sqarime nga drejtori, i cili e kishte siguruar se çdo veprim i ndërmarrë ka qenë në përputhje me ligjin dhe procedurat administrative. Në fund, ai theksoi se asnjë drejtor, e aq më pak administrata komunale, nuk duhet të veprojë jashtë kornizës ligjore.

Mujë Igrishta: Ai tha se edhe më herët kishte përmendur se kishte kërkuar mendim nga zyrtari ligjor lidhur me këtë çështje dhe se e vlerësonte punën e bërë në këtë drejtim. Sipas tij, sapo kishte marrë detyrën, kishte kërkuar sqarim mbi bazën ligjore të rastit, pasi vendimi për ekzekutim kishte mbetur i pazbatuar dhe ishte bartur si përgjegjësi te drejtori i Inspektoratit. Ai shtoi se gjendja e konstruksionit mund të vërtetohet me dëshmi dhe dokumente, të cilat, sipas tij, do t'i paraqesë në një seancë tjetër. Në përfundim, ai deklaroi se është i gatshëm ta argumentojë publikisht qëndrimin e tij, madje duke theksuar se do të pranonte të mbante përgjegjësi nëse do të vërtetohej e kundërta.

Kryesuesi konstatoi se diskutimet lidhur me këtë pikë të rendit të ditës ishin shteruar dhe njoftoi se Kuvendi do të kalojë në shqyrtimin e pikës së radhës.

Pika e 8

Kryesuesi kaloi në shqyrtimin e raportit të Komisionit për Vlerësimin e Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera dhe pyeti nëse kishte diskutime ose pyetje lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Meqenëse nuk pati diskutime, ai sqaroi se, për shkak se ishin paraqitur tri raporte të veçanta, ato do të hidheshin në votim një nga një. Fillimisht, ai e paraqiti për votim raportin për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri në shtëpinë e Sinan Xhafës dhe ftoi anëtarët e Kuvendit të deklarohen me votë për miratimin e tij.

Kryesuesi i Kuvendit Meqenëse nuk ka të lajmëruar për diskutim atëherë e hedh në votim raportin për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri në shtëpinë e Sinan Xhafës.

Rezultati i votimit: 20 të pranishëm, 20 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Konstatohet se miratohet Raporti për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga zjarri në shtëpinë e Sinan Xhafës.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket pjesës së dytë të raportit, kjo pjesë ka të bëjë me vlerësimin e dëmeve gjatë periudhës së vitit 2025, ndërsa pjesa e tretë ka të bëjë me periudhën e vitit 2024. Është e nevojshme që gjatë votimit të përcaktohet qartë emërtimi i pjesëve të raportit, në mënyrë që të dihet saktësisht se për cilin raport bëhet fjalë.

Nënkryetari i komunës z. Enis Osmani: Pjesa e dytë e raportit përfshin dëmet e shkaktuara nga zjarret në fshatrat Vaganicë dhe Vllahi, ndërsa pjesa e tretë përfshin dëmet e shkaktuara në fshatin Kqiq të Madh. Në këtë raport janë të përfshira tri raste: raporti për shtëpinë e Sinan Xhafës, raportet për fshatrat Vllahi dhe Vaganicë, si dhe raporti për fshatin Kqiq të Madh. Pjesa e parë e raportit tashmë është miratuar.

Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim raportin për dëmet e shkaktuara nga zjarret në fshatrat Vaganicë dhe Vllahi.

Rezultati i votimit: 20 të pranishëm, 20 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Konstatohet se miratohet Raporti për dëmet e shkaktuara nga zjarret në fshatrat Vaganicë dhe Vllahi.

Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim raportin për dëmet e shkaktuara nga zjarri në fshatin Kçiq.

Rezultati i votimit: 20 të pranishëm, 20 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Konstatohet se miratohet Raporti për dëmet e shkaktuara nga zjarri në fshatin Kçiq.

Pika e 9

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, Raporti vjetor i menaxhimit të mbeturinave komunale për vitin 2025. A ka dikush nga anëtarët e Kuvendit diskutim lidhur me këtë çështje?

Xhyljeta Imeri: Në këtë raport janë paraqitur edhe disa planifikime për vitin 2026, ku ndër të tjera është përmendur se gjatë muajit maj dhe nëntor do të bëhet largimi i mbeturinave të vëllimshme. Megjithatë, nuk jam në dijeni që aktualisht ekziston ndonjë mundësi apo vend i caktuar ku qytetarët mund t'i dërgojnë këto lloj mbeturinash. Prandaj, i propozoj Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit që të ndërmarrë masa konkrete për krijimin e një sistemi më të organizuar për grumbullimin e mbeturinave të vëllimshme, duke caktuar një ditë dhe një lokacion të veçantë, së paku një herë në muaj. Kjo duhet të përfshijë mbeturinat si mobiliet e vjetra, orenditë shtëpiake, dyshekët dhe mbeturinat e tjera të ngjashme. Aktualisht qytetarët nuk kanë një vend apo termin të përcaktuar për largimin e këtyre mbeturinave, gjë që shpesh rezulton me hedhjen e tyre në hapësira publike dhe ndotjen e mjedisit. Organizimi i një aksioni të rregullt mujor do t'u ofronte qytetarëve një zgjidhje praktike dhe do të kontribuonte në ruajtjen e pastërtisë së qytetit.

Arjeta Beqiri: Sa i përket deponimit të mbeturinave të vëllimshme, është e vërtetë që deri tani nuk ka pasur një sistem të tillë dhe nuk ka qenë i planifikuar më herët. Megjithatë, në planet e qeverisjes aktuale dhe të drejtorisë është paraparë mundësia e krijimit të një sistemi të tillë. Pra, nuk është ende i krijuar, por është një plan që pritet të realizohet. Sa i përket raportit të punës së drejtorisë, duhet të theksoj se ende nuk kemi përfunduar periudhën gjashtëmujore të punës, prandaj është herët të jepet një raport i plotë për rezultatet e kësaj periudhe. Unë jam në këtë pozitë që nga data 16 dhjetor dhe mund të jap sqarime vetëm për periudhën prej marrjes së detyrës. Gjërat që nuk janë realizuar deri tani nuk kanë të bëjnë domosdoshmërisht me mosveprim, por me faktin se disa prej tyre nuk kanë qenë pjesë e planeve dhe buxhetit të mëparshëm. Aktualisht jemi duke punuar sipas planeve dhe prioritetëve të reja.

Xhyljeta Imeri: Unë jam bazuar në atë që kam lexuar në raport. Gjithmonë i analizoj raportet dhe diskutimi im është bazuar vetëm në përmbajtjen e raportit.

Bajram Istrefi: Drejtoreshë, prej marrjes së mandatit tuaj, sa deponi ilegale keni gjetur dhe sa prej tyre keni arritur t'i largoni?

Arjeta Beqiri: Z. Istrefi nëse e keni analizuar raportin e punës për vitin 2025, mund të keni vërejtur se gjatë asaj periudhe njëvjeçare janë identifikuar 11 deponi ilegale. Ndërsa, me miratimin dhe përkrahjen e Ministrisë së Mjedisit dhe planifikimit hapësinor, gjatë kësaj periudhe rreth pesë muaj janë identifikuar 28 deponi ilegale. Nga këto deponi, rreth 2.000 ton mbeturina tashmë janë larguar, ndërsa deponitë e tjera janë në proces të largimit. Mbeturinat inerte do të dërgohen në hapësirën e përcaktuar në Gërmovë për trajtimin e tyre.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Sa i përket çështjes së mbeturinave inerte, së bashku me bashkëpartiaken e kolegëve tanë dhe kryeshefin e njësisë kemi vendosur që nga java e ardhshme të organizohet një ditë brenda javës, ku në parkingun ku ndodhet njësiatë përkatëse të bëhet grumbullimi i mbeturinave inerte. Ky organizim nuk ka qenë i aplikuar më herët. Qëllimi është që një herë në javë mbeturinat inerte nga e gjithë zona e qytetit të dërgohen dhe të grumbullohen në atë hapësirë, në mënyrë që të mos ngarkohen kontejnerët e zakonshëm me mbeturina të kësaj natyre dhe të sigurohet një menaxhim më i mirë i tyre.

Igballe Islami: Meqenëse nuk e kam shfrytëzuar të drejtën e diskutimit në këtë pikë dhe nuk e kisha pasur ndërmend të diskutoja për raportin, megjithatë diskutimi i drejtoreshës dhe më pas edhe i nënkryetarit, ku u potencua bashkëpartiajaka jonë, jo bashkëpartakja jo por në bashkëpunim me kryeshefin e KRM “Uniteti” janë larguar një numër i konsiderueshëm i tonëve të mbeturinave dhe është realizuar marrëveshja me Ministrinë, më shtyu të jap një sqarim. Është mirë të theksohet se puna për eliminimin e deponive ilegale është realizuar edhe falë angazhimit të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave “Uniteti”, e cila përmes funksionimit dhe menaxhimit të mirë ka kontribuar në mënyrë të rëndësishme në përmirësimin e gjendjes së pastërtisë në qytet. Prandaj, vlerësimi duhet të bëhet duke u bazuar në faktet dhe në kontributin e të gjitha institucioneve dhe ndërmarrjeve të përfshira në këtë proces, po ashtu edhe në postimet që i bëni të theksohet.

Arjeta Beqiri: Edhe në publikimin e bërë në faqen zyrtare është referuar se Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit ka arritur të largojë deponitë ilegale. Është e rëndësishme që të theksohet roli i KRM “Uniteti”, e cila në bashkëpunim me Ministrinë ka realizuar këtë punë dhe ka kontribuar në mirëmbajtjen e qytetit. Është e rëndësishme që në komunikimet publike të paraqiten faktet në mënyrë të saktë dhe të përfshihet kontributi i të gjitha palëve të angazhuara në këtë proces. Patjetër që kompania e cila është kontraktuar për këtë punë e ka obligim ta kryejë atë. Në këtë rast, nuk ka kush tjetër përveç KRM “Uniteti” që t’i grumbullojë dhe t’i largojë mbeturinat, pasi kjo është pjesë e detyrave të saj. Gjithashtu, duhet të theksohet se kjo ka ardhur si rezultat i një kërkese dhe udhëzimi nga Ministria përkatëse për kryerjen e këtij angazhimi. Kompania ka zbatuar detyrën e përcaktuar dhe nuk ka bërë më shumë sesa obligimet që i takojnë në kuadër të përgjegjësisë së saj.

Kryesuesi tha se, nëse nuk ka ndonjë diskutim apo çështje tjetër për t’u ngritur, e konsideron të mbyllur këtë pikë të rendit të ditës dhe njoftoi kalimin në pikën e radhës.

Pika e 10

Kryesuesi hap diskutimkin.

Xhylejta Imeri: Sa i përket Raportit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në të janë pasqyruar një numër i konsiderueshëm i aktiviteteve kulturore, artistike dhe sportive të realizuara gjatë periudhës raportuese. Ky raport evidenton gjithashtu edhe disa nevoja dhe sfida me të cilat përballen Qendra e Kulturës, siç janë: mungesa e rojeve fizike, mungesa e stafit higjieno-sanitar, mosfunksionalizimi i ashensorit, mungesa e shtrirjes së internetit, nevoja për renovimin e tualeteve dhe çështje të tjera të ngjashme. Propozoj që këto nevoja të planifikohen në kuadër të buxhetit për vitin e ardhshëm, me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve për qytetarët. Gjithashtu, propozoj që sektori i rinisë të hartojë një kalendar vjetor të aktiviteteve rinore, ku të përfshihen aktivitete të planifikuara për çdo muaj, në mënyrë që angazhimet për të rinjtë të jenë më të vazhdueshme, të organizuara dhe të strukturuar. Në kuadër të këtij kalendari propozoj: organizimin e një festivali rinor komunal, ku të rinjtë të kenë mundësi të prezantojnë talentet e tyre në fusha si muzika, arti, teatri dhe vallëzimi; Organizimin e trajnimeve falas në fusha si lidërsipë, komunikimi, teknologjia, sipërmarrja dhe orientimi në karrierë; Organizimin e aktiviteteve verore në parqe dhe sheshe publike, si kinema në natyrë, koncerte dhe aktivitete rekreative; Shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Rinisë dhe datave të tjera të rëndësishme përmes aktiviteteve publike; Krijimin e një platforme online ku do të publikohen aktivitetet, mundësitë dhe njoftimet që kanë të bëjnë me të rinjtë. Gjithashtu, kërkoj nga drejtori, z. Asllani, që të marrë pjesë në një takim me Komitetin për Komunitete, në mënyrë që përfaqësuesit e komuniteteve të kenë mundësi të paraqesin nevojat, idetë dhe propozimet e tyre, të cilat më pas mund të përfshihen në aktivitetet kulturore, artistike dhe sportive.

Valon Brahimi: Kërkoj një përmirësim të vogël në raportin e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Ai theksoi se raportet zakonisht përgatiten nga zyrtarët përkatës dhe jo drejtpërdrejt nga drejtori, duke shtuar se në raport duhet të ketë më shumë kujdes në përzgjedhjen dhe klasifikimin e aktiviteteve të paraqitura. Ai vuri në dukje se në mesin e aktiviteteve të përshkruara në raport ishte përfshirë edhe tubimi i subjektit politik “Guxo”, duke theksuar se një aktivitet politik nuk mund të konsiderohet aktivitet kulturor. Ai kërkoj që në të ardhmen të bëhen korrigjimet e nevojshme dhe të shmangen përfshirje të tilla në raportet zyrtare.

Gazmend Asllani: Ai sqaroi se aktivitetet kulturore dhe aktivitetet e zhvilluara në Qendrën e Kulturës janë dy çështje të ndryshme. Sipas tij, aktivitetet e sektorit të kulturës janë ato që janë realizuar nga ky sektor, ndërsa aktivitetet në Qendrën e Kulturës paraqesin një kategori tjetër. Ai theksoi se kjo nuk përbën gabim në raport, por vetëm një dallim në mënyrën e kategorizimit të aktiviteteve. Sipas tij, është e rëndësishme të kuptohet se Qendra e Kulturës dhe sektori i kulturës nuk janë e njëjta gjë, pasi kanë veprimtari të ndara. Po ashtu sqaroi se raporti i paraqitur nuk është raport i punës së tij personale, por raport për aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës përkatëse. Ai theksoi se aktivitetet e sektorit të kulturës janë të cvidentuara në raport dhe se përfshirja e tyre nuk përbën gabim. Sa i përket çështjeve të ngritura për Qendrën e Kulturës, drejtori njoftoi se shërbimi i pastrimit është siguruar dhe se pastrimi kryhet dy herë në javë. Gjithashtu, bëri të ditur se procedurat e prokurimit për shërbimet higjieno-sanitare janë në proces për Qendrën e Kulturës, Pallatin e Sportit dhe Muzeun. Drejtori shtoi se në raportin e ardhshëm të punës do të përfshihen të gjitha aktivitetet dhe rezultatet e punës së drejtorisë, përfshirë edhe aktivitetet e realizuara në fushën e sportit dhe kulturës. Ai theksoi se gjatë kësaj periudhe janë realizuar shumë aktivitete të rëndësishme për sportin dhe kulturën në Mitrovicë, të cilat do të paraqiten në mënyrë më të detajuar në raportin e punës.

Pas këtij sqarimi, kryesuesi e konsideroi diskutimin të mbyllur dhe kaloi në pikën tjetër të rendit të ditës.

Pika e 11

Hap diskutimin.

Igabelle Islami: diskutoi lidhur me raportin e Drejtorisë së Shëndetësisë, duke shprehur vërejtje për mënyrën e hartimit dhe paraqitjes së tij. Ajo theksoi se kishte pasur vështirësi për të kuptuar periudhën raportuese, pasi në pjesë të ndryshme të raportit referohej herë në periudhën janar–mars, herë janar–maj, ndërsa në disa pjesë të tjera përdoren të dhënat e vitit 2025. Sipas tij, mungon një periudhë e unifikuar raportimi që do të mundësonte krahasimin e saktë të të dhënave. Ajo theksoi se raporti është paraqitur nga Drejtoria Komuna e Shëndetësisë, ndërsa në pjesën e objektivave janë paraqitur vetëm objektivat e QKMF-së dhe jo objektivat e drejtorisë. Ajo vlerësoi se një raport i tillë duhet të jetë i shqyrtuar në mënyrë më institucionale para se të silllet në Kuvend. Pastaj ngriti shqetësime edhe lidhur me përdorimin e gjuhës angleze në raport, duke theksuar se gjuha angleze nuk është gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës dhe se pjesë të konsiderueshme të raportit, përfshirë statistika, janë paraqitur në këtë gjuhë. Ai përmendi gjithashtu se në raport ishte përfshirë një referencë “chatgpt.com”, duke theksuar se përdorimi i inteligjencës artificiale mund të jetë ndihmues, por dokumentet zyrtare duhet të kontrollohen dhe të përmbajnë burime të sakta e të verifikueshme. Ai ngriti pyetje edhe për saktësinë e të dhënave për stafin shëndetësor, ku në raport janë paraqitur 166 infermierë dhe 56 mjekë. Sipas tij, bazuar në numrin e popullsisë, këto të dhëna tregojnë se numri i stafit është i mjaftueshëm, por problemi mund të jetë në menaxhimin dhe shpërndarjen e stafit. Ajo theksoi se ka ankesa nga terreni për mungesë të stafit në disa QMF dhe AMF në zonat periferike, duke përmendur Ilirinë, Vaganicën, Bajrën, Shipolin, Këqiqin e Madh, Gushavecin, Broboniqin, Staniërgun, Bajgurin, Baren, Prasharin, Vllahinë dhe Zabërxh. Ai kritikoi gjithashtu përfshirjen në raport të objekteve shëndetësore që nuk janë funksionale, duke theksuar se raporti duhet të pasqyrojë gjendjen reale në terren dhe të mos paraqiten si funksionale objekte që nuk ofrojnë shërbime. Sa i përket pjesës së vaksinimit, ajo shprehu shqetësim për të dhënat e paraqitura në raport, ku sipas saj thuhet se gjatë periudhës janar–maj 2026 janë regjistruar 294 lindje dhe vetëm 37% e fëmijëve janë vaksinuar me vaksinat në lindje (BCG dhe hepatit B). Ajo theksoi se, nëse këto të dhëna janë të sakta, paraqesin një shqetësim serioz publik dhe kërkojnë sqarim nga drejtoria. Ndërsa, nëse të dhënat janë të pasakta, atëherë raporti duhet të korrigjohet, pasi nuk paraqet gjendjen reale. Në fund, ajo kërkoi sqarime të detajuara për periudhën raportuese dhe për përqindjen e vaksinimit, duke theksuar se raporti kishte nevojë për përmirësime në mënyrën e përgatitjes dhe paraqitjes së të dhënave.

Armend Begu: Parashitroi pyetje për Drejtoreshën e Shëndetësisë lidhur me funksionalizimin e shërbimit të mamografisë. Ai pyeti nëse ky shërbim aktualisht është në funksion dhe, në rast se nuk është funksional, kërkoi sqarim se ku qëndron problemi apo çfarë e ka penguar funksionimin e tij.

Rozana Peci: Ngriti çështjen e vonesave të raportuara në pagesat e kujdestarive dhe shtesave të tjera për punëtorët shëndetësorë. Ajo kërkoi nga Drejtoresha e Shëndetësisë një sqarim zyrtar lidhur me këtë situatë, duke kërkuar të informohet për arsyet që kanë shkaktuar vonesat në realizimin e këtyre pagesave.

Xhylljeta Imeri: U shpreh se, duke u bazuar në raportin e paraqitur, numrin e vizitave dhe shërbimeve të ofruara nga mjekët dhe infermierët, dëshiron t'i falënderojë për punën dhe angazhimin e tyre, duke theksuar se çdo minutë e punës së tyre është me rëndësi për qytetarët.

Ajo ngriti shqetësim lidhur me mbulueshmërinë e vaksinimit të rregullt të fëmijëve. Duke iu referuar të dhënave të paraqitura për periudhën janar-maj, ajo theksoi se asnjëra nga vaksinat nuk arrin mbulueshmëri mbi 50%, duke e vlerësuar këtë si shqetësuese për shëndetin publik dhe parandalimin e sëmundjeve ngjitëse. Ajo kërkoi sqarim nga drejtoria nëse kjo gjendje është rezultat i mungesës së vaksinave, mosparaqitjes së prindërve, migrimit të popullsisë apo problemeve në evidentimin e të dhënave. Gjithashtu, kërkoi intensifikimin e fushatave informuese për rëndësinë e vaksinimit të fëmijëve. Ajo ngriti gjithashtu çështjen e listës së stafit mjekësor, ku sipas saj figurojnë punonjës të cilët, sipas informacioneve të tij, janë në pushim pa pagesë për një periudhë rreth dyvjeçare dhe nuk janë prezentë në vendet e tyre të punës. Kërkoi sqarim nga drejtoria për bazën ligjore të vazhdimtë të këtij statusi, afatin maksimal të pushimit pa pagesë dhe nëse janë ndërmarrë masa për zövendësimin e këtyre punonjësve me qëllim që të mos dëmtohet ofrimi i shërbimeve shëndetësore. Më tej, ajo kërkoi që në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe me mbështetjen e kryetarit të komunës të planifikohen trajnime të detyrueshme për ndihmën e parë për stafin edukativo-arsimor, nga çerdhet deri në shkollat e mesme. Ajo theksoi se në situata emergjente, si bllokimi i rrugëve të frymëmarrjes, krizat epileptike, reaksionet alergjike dhe raste të tjera urgjente, reagimi i parë është vendimtar dhe se mungesa e trajnimit mund të çojë në veprime të gabuara me pasoja për shëndetin dhe jetën e fëmijëve. Një shqetësim tjetër i ngritur nga ajo ishte sektori i stomatologjisë. Ajo rikujtoi se në dhjetor të vitit 2019 kishte kërkuar rifunksionalizimin e ordinancës stomatologjike për fëmijë, pasi në të njëjtën hapësirë trajtoheshin edhe fëmijët edhe të rriturit, përfshirë procedurat e nxjerrjes së dhëmbëve. Sipas saj, kjo paraqiste shqetësim për shkak të ndjeshmërisë së fëmijëve dhe mundësisë së infeksioneve. Ajo falënderoi ish-drejtoreshën e Shëndetësisë, znj. Barani, për trajtimin e kësaj kërkesë dhe për funksionalizimin në vitin 2021 të ordinancës stomatologjike të veçantë vetëm për fëmijë, duke ndarë shërbimet nga ato për të rriturit. Megjithatë, ajo theksoi se kjo praktikë aktualisht është rikthyer dhe se në të njëjtën ordinancë po trajtohen përsëri fëmijët, të rriturit dhe të moshuarit. Në fund, ajo kërkoi nga drejtoresha e Shëndetësisë që të ndërmerren masa për rikthimin e organizimit të mëparshëm, në mënyrë që trajtimi stomatologjik i fëmijëve të jetë i ndarë nga ai i të rriturve dhe të moshuarve, duke siguruar kushte më të përshtatshme dhe më të sigurta për pacientët e vegjël.

Flamur Vojvoda: Fillimisht falënderoi stafin shëndetësor për punën dhe angazhimin e tyre, duke theksuar se në kuadër të shërbimeve shëndetësore janë të angazhuar 56 mjekë, 16 stomatologë dhe mbi 100 infermierë. Ai theksoi se ekzistojnë ankesa lidhur me përmbushjen e obligimeve të disa punonjësve shëndetësorë sipas kontratave të punës që ata kanë nënshkruar. Sipas tij, është e nevojshme të identifikohen arsyet konkrete në rastet kur stafi nuk është i pranishëm në vendin e punës, duke marrë parasysh se aktualisht është edhe periudha e pushimeve vjetore dhe ekzistojnë forma të ndryshme të pushimeve të lejuara me ligj. Ai rekomandoi që të bëhet një analizë më e detajuar për të identifikuar nëse problemi lidhet me mungesën e stafit, shpërndarjen jo të duhur të punonjësve në njësitë shëndetësore apo me faktin që disa punonjës preferojnë të punojnë vetëm në QKMF dhe jo në AMF-të periferike. Ai theksoi se përgjegjësia për organizimin dhe menaxhimin e stafit nuk i takon vetëm Drejtorisë së Shëndetësisë, por edhe strukturave të tjera menaxhuese, përfshirë QKMF-në dhe AMF-të.

Ai u shpreh se nuk është e drejtë që qytetarëve t'u mohohen shërbimet shëndetësore për shkak të mungesës së gatishmërisë së ndonjë punonjësi për të punuar në njësitë ku është caktuar. Sipas tij, punonjësit shëndetësorë janë pranuar për të punuar në kuadër të kujdesit primar shëndetësor komunal dhe jo në një lokacion të caktuar sipas preferencës personale. Më tej, ai ngriti shqetësimin lidhur me numrin e rasteve të

pneumonisë të paraqitura në raport, duke theksuar se në Mitrovicë janë evidentuar 52 raste, ndërsa në disa komuna tjera numri është dukshëm më i ulët. Ai kërkoi që të bëhet një analizë më e thelluar për të identifikuar shkaqet e kësaj gjendjeje, duke marrë parasysh moshën e pacientëve, gjendjen shëndetësore dhe faktorët e mundshëm të rrezikut. Në fund, ai ofroi gatishmërinë e tij për të kontribuar në identifikimin e faktorëve që kanë ndikuar në rritjen e rasteve të pneumonisë, në bashkëpunim me institucionet relevante shëndetësore, përfshirë spitalin rajonal dhe strukturat e tjera përgjegjëse.

Bajram Istrefi: Ngriti çështjen e furnizimit me oksigjen në institucionet shëndetësore, duke theksuar se kjo ka qenë një temë shqetësuese për qytetarët dhe institucionet shëndetësore. Ai kërkoi sqarim nga Drejtoria e Shëndetësisë lidhur me gjendjen aktuale të furnizimit me oksigjen në institucionet shëndetësore të Komunës, duke pyetur nëse ekziston kontratë aktive dhe nëse janë siguruar rezerva të vazhdueshme për të garantuar furnizim të pandërprerë kur ka nevojë.

Albina Kasrati Rama: I'alëndcroi anëtarët e Kuvendit për interesimin dhe shqetësimet e ngritura lidhur me kujdesin parësor shëndetësor. Ajo sqaroi se raporti i prezantuar paraqet një informatë mbi gjendjen shëndetësore të popullatës në Komunën e Mitrovicës dhe nuk paraqet raport përfundimtar të punës së drejtorisë. Ajo theksoi se të dhënat në raport janë bazuar në raportet e Qendrës Rajonale të Shëndetit Publik në Mitrovicë, si dhe në raportimet e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, ku punojnë profesionistë shëndetësorë, veçanërisht mjekë familjarë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë. Lidhur me çështjen e vaksinimit, drejtoresha sqaroi se analizimi i të dhënave të vaksinimit është përgjegjësi e Qendrës Rajonale të Shëndetit Publik. Ajo theksoi se vaksinat e lindjes, si BCG dhe hepatiti B, tashmë aplikohen në spitalin e Mitrovicës dhe jo në QKMF si më parë, prandaj të dhënat e paraqitura janë marrë nga raportimet zyrtare të institucioneve përgjegjëse. Sa i përket periudhave të ndryshme raportuese, ajo sqaroi se raporti është përgatitur si informatë dhe për shkak të kohës së përgatitjes së tij janë përdorur të dhëna nga periudha të ndryshme, pasi të dhënat e plota gjashtë mujore publikohen më vonë nga institucionet relevante. Pranoi se ekziston shqetësim lidhur me mbulueshmërinë e vaksinimit dhe theksoi se një nga arsyet kryesore është hezitimi i disa prindërve, veçanërisht për vaksinën MMR, si pasojë e dezinformatave se kjo vaksinë shkakton autizëm. Ajo bëri të ditur se edhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, Qendra Rajonale e Shëndetit Publik dhe QKMF-ja kanë zhvilluar vazhdimisht fushata për vetëdijësimin e qytetarëve për rëndësinë e vaksinimit. Sipas saj, kjo nuk është vetëm çështje e Komunës së Mitrovicës, por një shqetësim në nivel të gjithë Kosovës. Lidhur me mungesën e stafit mjekësor në disa ambulanca, drejtoresha tha se e kupton shqetësimin e ngritur dhe sqaroi se një pjesë e mungesave kanë ardhur si pasojë e shfrytëzimit të pushimeve vjetore nga punëtorët shëndetësorë. Ajo theksoi se kjo ka qenë një praktikë e vazhdueshme ndër vite, ku pushimet e mbetura nga viti paraprak janë shfrytëzuar gjatë muajve të verës. Ajo siguroi Kuvendin se asnjë qytetar i Komunës së Mitrovicës nuk ka mbetur pa shërbime shëndetësore, pasi në rastet kur ambulancat e mjekësisë familjare nuk kanë ofruar shërbime, pacientët janë orientuar në qendrat më të afërta të mjekësisë familjare. Gjithashtu, ajo përmendi se janë funksionale ekipet për shërbime në shtëpi, përfshirë ekipin paliativ, ekipin geriatrik dhe ekipin e urgjencës për raste më të rënda. Për çështjen e vonësive në pagesat e shtesave dhe kujdestarive për punëtorët shëndetësorë, drejtoresha sqaroi se kjo situatë është trashëguar nga periudha paraprake dhe lidhet me planifikimin jo të mjaftueshëm buxhetor. Ajo theksoi se për gjithë vitin 2025 kishte qenë planifikuar një shumë prej rreth 14 mijë e 913 €sh për kujdestari dhe shtesa të tjera, e cila nuk ka qenë e mjaftueshme për mbulimin e nevojave reale. Ajo bëri të ditur se qeverisja aktuale ka mbuluar detyrimet e mbetura për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2025, si dhe pagesat për muajt janar dhe shkurt 2026, ndërsa për muajt mars, prill dhe maj janë duke u zhvilluar përpjekje në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave për realizimin e pagesave. Lidhur me shërbimin e mamografisë, drejtoresha sqaroi se aktualisht ky shërbim nuk është funksional në objektin e ri të QKMF-së për shkak të mungesës së izolimit të dhomave të radiologjisë. Ajo theksoi se në objektin e ri nuk ofrohen shërbimet e radiologjisë, mamografisë dhe ortopanisë, ndërsa disa shërbime vazhdojnë të ofrohen në objektin e vjetër. Ajo ngriti shqetësimin se, përkundër mungesës së përfundimit të infrastrukturës së nevojshme, në fund të vitit 2025 janë blerë pajisje radiologjike në vlerë rreth 17 mijë €, të cilat nuk kanë mundur të përdoren për shkak të mungesës së kushteve teknike. Gjithashtu theksoi se këto pajisje janë vendosur në hapësira të

papërshtatshme dhe kanë qenë të ekspozuara ndaj rrezikut nga vërshimet, megjithëse sipas raportit të komisionit të vlerësimit nuk janë konstatuar dëmtime.

Në fund, drejtoresha iu përgjigj shqetësimit për stomatologjinë e fëmijëve, duke bërë të ditur se kjo çështje do të zgjidhet dhe se ordianca e stomatologjisë për fëmijë do të funksionalizohet përsëri si hapësirë e veçantë. Ajo njoftoi se për këtë është siguruar një donacion nga një punëtorë shëndetësorë, e cila ka dhuruar dy karrige stomatologjike në kujtim të vajzës së saj të ndjerë, duke mundësuar krijimin e kushteve më të përshtatshme për trajtimin stomatologjik të fëmijëve. Ajo njoftoi se raporti informues do t'u shpërndahet anëtarëve të Kuvendit më 15 korrik. Më tej, ajo tha se kishte pranuar kërkesa edhe më herët lidhur me organizimin e trajnimeve për dhënien e ndihmës së parë në shkollë. Ajo sqaroi se, për shkak të përvojës së saj disavjeçare të punës në Shkollën e Mjekësisë, e konsideron këtë çështje shumë të rëndësishme. Sipas saj, edhe pse në këtë shkollë ka pasur mjekë dhe infermierë dhe nxënësit kanë marrë njohuri për ndihmën e parë, gjithmonë ka nevojë për trajnime të vazhdueshme. Ajo theksoi se këto trajnime janë të nevojshme si në arsimin fillor, ashtu edhe në shkollat e mesme. Gjithashtu, bëri të ditur se kishte pranuar një kërkesë edhe nga një shkollë e mesme dhe njoftoi se, duke filluar nga muaji shtator, do të nisë zbatimin gradual të trajnimeve për shumicën e shkollave.

Xhyljeta Imeri: Ajo theksoi se trajnimet për dhënien e ndihmës së parë duhet të bëhen të detyrueshme për çdo mësimdhënëse. Sipas tij, për këtë duhet të merret vendim nga kryetari i komunës dhe drejtori i Arsimit, në mënyrë që pjesëmarrja në këto trajnime të jetë obligative. Ai shtoi se këto trajnime janë jetike, pasi një veprim i gabuar mund të shkaktojë pasoja të rënda ose dëmtime serioze të shëndetit.

Igballe Islami: Ajo iu drejtua drejtoreshës me pyetjen nëse është në dijeni se këto vaksina u administrohen fëmijëve menjëherë pas lindjes. Ajo tha se pikërisht për këtë arsye e kishte ngritur këtë çështje dhe kishte parashtruar pyetjen. Ajo shtoi se ishte bazuar në raportet që i kishte përmendur drejtoresha dhe theksoi se përgjegjësia për administrimin e vaksinave është e institucioneve shëndetësore. Sipas saj, mbulueshmëria me këto vaksina ka qenë rreth 99%, ndërsa në periudhën janar-maj ka rënë në 37%. Ajo kërkoi sqarim për arsyet e kësaj rënieje, duke theksuar se më herët fëmijët vaksinoheshin brenda javës së parë, ndërsa tani, sipas praktikës, vakcina jepet që në ditën pas lindjes. Më tej, ajo ngriti shqetësimin se kjo rënie e mbulueshmërisë lidhet me vaksinat kundër tuberkulozit, duke përmendur se, sipas raportimeve, në Mitrovicë janë shënuar raste të kësaj sëmundjeje. Ajo shtoi se kjo është një çështje serioze e shëndetit publik dhe se të dhënat burojnë nga raportet e Qendrës së Shëndetit Publik. Në fund, ajo iu referua edhe pajisjeve mjekësore, duke kujtuar deklarin e drejtoreshës se dy pajisje ishin konsumuar shpejt. Sipas saj, edhe pse ato ishin siguruar në fund të mandatit të kaluar, në momentin e marrjes së detyrës është dashur të sigurohej mirëmbajtja e tyre, në mënyrë që të mos lireshin jashtë funksionit.

Albina Kastrati Rama: Drejtoresha u përgjigj se përgjegjësi për mirëmbajtjen e pajisjeve ka pasur edhe drejtori përkatës, por theksoi se, pas pranimit zyrtar të objektit, përgjegjësia për mirëmbajtjen kalon te institucioni që e pranon atë. Sipas saj, pas investimeve të konsiderueshme të realizuara, veçanërisht me mbështetjen e shoqatave dhe donatorëve, është dashur t'u kushtohet kujdes edhe mirëmbajtjes së pajisjeve. Ajo sqaroi se pajisjet janë pranuar zyrtarisht nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe Drejtoria e Shëndetësisë, duke theksuar se, sipas dokumentacionit, pranimi i tyre është bërë më 11 dhjetor 2025. Sa i përket vaksinave, ajo deklaroi se nuk ka mungesë të tyre dhe se furnizimi është i rregullt. Duke iu referuar të dhënave të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, ajo tha se mbulueshmëria dhe furnizimi me vakcina janë në nivel shumë të mirë. Në reagim, njëri nga anëtarët theksoi se ai ishte bazuar në raportet e Qendrës Rajonale të Shëndetit Publik dhe në të dhënat e prezantuara nga drejtuesit e saj, e jo në vlerësime personale. Në vijim, drejtoresha tha se një nga sfidat më të mëdha me të cilat ishte përballur në fillim të mandatit kishte qenë mosrespektimi i orarit të punës nga punonjësit shëndetësorë, veçanërisht në administratën e QKMF-së. Sipas saj, kishte raste kur zyrtarë administrativë nuk paraqiteshin në punë për javë apo muaj të tërë ose paraqiteshin vetëm për një kohë shumë të shkurtër, pa kryer detyrat e tyre, ndërsa për periudha të gjata nuk ishte marrë asnjë masë ndaj tyre.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani: Drejtoresha deklaroi se, sipas të dhënave që posedon, ish-drejtori i administratës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, Adnan Ramadani, nuk ishte paraqitur në punë për një periudhë prej gjashtë deri në shtatë muaj dhe se kjo situatë ishte toleruar nga qeverisja e

mëparshme. Ajo shtoi se, përveç kësaj, ai kishte përfituar edhe kontrata nga komuna. Ajo theksoi se praktika të tilla nuk do të tolerohen më dhe se punonjësit që nuk paraqiten në punë nuk kanë vend në administratën komunale apo në institucionet publike, duke shtuar se ndaj tyre nuk do të vazhdohet pagesa e pagës. Më tej, ajo deklaroi se gjatë mandatit të saj do të kërkohet zbatimi i plotë i kontratave të punës nga të gjithë punonjësit, përfshirë mjekët, infermierët dhe stafin administrativ. Sipas saj, kontrata e punës parasheh tetë orë punë në ditë dhe 40 orë në javë, standard që, sipas saj, nuk ishte respektuar në të kaluarën. Në fund, ajo njoftoi se, me emërimin e kryeshëfit të ri dhe drejtuesve përgjegjës, do të sigurohet respektimi i orarit të punës nga të gjithë punonjësit e QKMF-së. Ajo theksoi se masat do të zbatohen në mënyrë të barabartë ndaj të gjithë punonjësve të institucioneve komunale, përfshirë QKMF-në, palestrën, Qendrën e Kulturës dhe institucionet e tjera, pa dallim.

Albina Kastrati Rama: Po ashtu theksoi se një ndër sfidat me të cilat është përballur pas marrjes së përgjegjësisë ka qenë edhe mungesa e një furnizimi të qëndrueshëm me oksigjen në kujdesin parësor shëndetësor. Ajo njoftoi se gjatë gjashtëmujorit të parë është arritur të lidhet kontratë trevjeçare për furnizim me oksigjen për të gjitha njësitë e kujdesit parësor shëndetësor, duke përfshirë Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, ambulancat dhe qendrat e tjera të mjekësisë familjare. Lidhur me shqetësimin e ngritur për numrin e rasteve të pneumonisë në Komunën e Mitrovicës, drejtoresha sqaroi se raporti i paraqitur është një informatë e përgjithshme dhe nuk përmban të dhëna të detajuara sipas grupmoshave dhe gjinisë. Ajo theksoi se në aspektin profesional dihet se grupet më të prekura nga pneumonia janë fëmijët e vegjël, personat me sëmundje kronike dhe të moshuarit. Ajo u shpreh se në raportet e ardhshme kjo çështje do të trajtohet më në detaje, me qëllim të analizimit më të saktë të situatës shëndetësore në komunë. Në fund, drejtoresha theksoi se nga informacionet e marra nga kujdesi parësor shëndetësor, mjekët dhe institucionet e kujdesit sekondar, rezulton se Komuna e Mitrovicës përballlet me sfida të theksuara shëndetësore dhe për disa sëmundje paraqitet ndër komunat me numër më të lartë të rasteve, duke përmendur veçanërisht sëmundjet malinje, sëmundjet e lëkurës dhe autizmin.

Pika e 12

Kryesuesi i Kuvendit sa i përket Informatës së Planifikimit dhe realizimi i mbjelljeve pranverore për vitin 2026 fjalën ia kaloi drejtoreshës znj. Remzije Topalli.

Remzije Topalli në pika të shkurta e arsyeoi Informatën e Planifikimit dhe realizimi i mbjelljeve pranverore për vitin 2026.

Valon Brahim: Parashtroi një pyetje lidhur me kërkesat e fermerëve për informacione rreth mundësisë së hapjes së projekteve të subvencionimit gjatë këtij viti. Ai theksoi se disa fermerë kanë shprehur interesim nëse do të ketë mbështetje për mekanizëm bujqësor, sera apo forma të tjera të subvencionimit në sektorin e bujqësisë, duke kërkuar një informacion lidhur me planet e komunës për këtë fushë.

Remzije Topalli: Në përgjigje të pyetjes së ngritur, theksoi se një ndër vendimet më të rëndësishme të ndërmarra është subvencionimi i fermerëve për qumësht, me mbështetje prej 10 cent për litër. Ai e vlerësoi këtë si një vendim me rëndësi të veçantë për Komunën e Mitrovicës, duke theksuar se është hera e parë që një masë e tillë zbatohet që nga themelimi i Drejtorisë së Bujqësisë. Ajo njoftoi se janë ndërmarrë edhe disa iniciativa të tjera për mbështetjen e fermerëve, përfshirë memorandumin e bashkëpunimit me Iber-Lepencin dhe mbështetjen për ujitjen e kulturave bujqësore përmes sistemeve të ujitjes. Më tej, ajo bëri të ditur se janë drejt finalizimit dy projekte të rëndësishme, ndër to mbulimi i interesit bankar nga Komuna e Mitrovicës dhe projekti për organizimin e panairëve. Gjithashtu, ajo njoftoi se janë në proces edhe projekte të tjera për subvencionimin e fermerëve, përfshirë: mbështetjen me mekanizëm bujqësor; mbështetjen për sektorin e bletarisë përmes pajisjeve për bletë; subvencionimin me fidane dhe sisteme të ujitjes. Në fund, ajo theksoi se është ndarë edhe një buxhet i veçantë për fermerët të cilët kanë pësuar dëme gjatë vitit, me qëllim të ofrimit të mbështetjes për tejkalimin e këtyre dëmeve.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Sqaroi se fermerët që kërkojnë informacione për projektet dhe subvencionimet në bujqësi duhet të njoftohen se kryetari i ri ende nuk e ka hartuar buxhetin e ri, por që vetëm përmes bartjeve buxhetore është arritur rritje prej 58% e buxhetit për bujqësinë në Komunën e

Mitrovicës. Ai theksoi se kjo rritje është bërë në krahasim me gjendjen e trashëguar para gjashtë muajve dhe se mbështetja për fermerët tashmë përfshin edhe masa të reja që më herët nuk kanë qenë pjesë e skemave të përkrahjes. Drejtori theksoi se Komuna e Mitrovicës, së bashku me Komunën e Gjilanit, janë ndër komunat që ofrojnë mbështetjen më të lartë për prodhimin blegtoral, konkretisht për subvencionimin e qumështit me 10 cent për litër, me qëllim stimulimin e prodhimit të qumështit dhe zhvillimit të sektorit të blegtorisë. Ai njoftoi se gjatë këtij viti është planifikuar një marrëveshje në vlerë deri në 500 mijë €, përmes së cilës fermerët me ambicie për rritjen e kapaciteteve dhe investime në bujqësi do të kenë mundësi të përfitojnë mbështetje për mbulimin e normës së interesit. Për këtë do të zhvillohet një proces publik ku bankat do të konkurrojnë dhe njëra prej tyre do të përzgjidhet për realizimin e kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu, ai bëri të ditur se është planifikuar mbështetje në vlerë prej 35.000 € për sistemet e ujitjes së kulturave bujqësore, duke marrë parasysh temperaturat e larta dhe nevojën për ujtime të qëndrueshme gjatë sezonit veror. Ai përmendi edhe memorandumin e bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë, përmes të cilit do të vazhdojë faza e dytë e investimeve në sistemin e ujitjes në fshatin Pirç, ndërsa në të ardhmen investimet do të shtrihen edhe në zonat e Vaganicës, Frashrit dhe Këqit. Sipas tij, investimet në sistemet e ujitjes gjatë dy-tre viteve të ardhshme parashihet të arrijnë vlerën deri në 1 milion €. Në fund, ai theksoi se këto janë vetëm masat fillestare të mbështetjes për fermerët dhe zhvillimin e bujqësisë, ndërsa për masat tjera, përfshirë mekanizimin bujqësor dhe çështjet specifike, nuk dua ti përsëris se i dha sqarimet Drejtoresha e Bujqësisë.

Pika e 13

Kryesuesi i mbledhjes njoftoi se kalojnë në pikën tjetër të rendit të ditës, për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit nr. 02-VI-060, fraksion 01-VI-0014/451-7/26, të datës 27.03.2026.

Ai sqaroi se ndryshimi bëhet për shkak të një gabimi teknik të evidentuar në aneksin e vlerësimit të dëmeve, konkretisht në pikën 15, ku për përfituesin z. Ferit Zahiti në raportin paraprak ishte shënuar shuma prej 694 €, ndërsa në raportin e Komisionit ishte evidentuar shuma prej 6,940 €. U theksua se bëhet fjalë vetëm për korrigjim teknik, përkatësisht inkorporimin e shumës së saktë në vendim, pa pasur ndryshime të tjera në raport. Pas sqarimeve, propozimi për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit u hodh në votim.

Kryesuesi i Kuvendit: E hedh në votim Propozim-Vendimin Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0014451-7/26 dt. 27.03.2026.

Rezultati i votimit: 19 anëtarë të pranishëm, 19 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se u miratua unanimisht Vendimi Për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0014451-7/26 dt. 27.03.2026.

Pika e 14

Kryesuesi sa i përket Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për klubet sportive që kanë arritur rezultate gjatë vitit 2026, fjalën ia kaloi Kryetarit të Komunës z. Faton Peci.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci theksoi se, në bazë të kompetencave ligjore që i ka si kryetar, ka të drejtë t'i propozojë Kuvendit nxjerrjen e vendimeve të veçanta për raste të caktuara. Ai bëri të ditur se, pas konsultimeve paraprake dhe duke u bazuar edhe në praktikën e komunave të tjera, është konfirmuar se ekziston baza ligjore për një propozim të tillë. Ai vlerësoi sukseset e klubeve sportive të Komunës së Mitrovicës, duke theksuar se ato përfaqësojnë krenarinë e qytetit dhe kontribuojnë në promovimin e tij në nivel vendor dhe ndërkombëtar. Në këtë drejtim, Kryetari propozoi ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria e subvencioneve si shpërblim për klubet që kanë arritur rezultate të veçanta sportive, si në vijim: KB Trepça – 30,000 €, si kampione e Kosovës në basketboll; KF Mitrovica (femrat) 15,000 €, si kampione dhe pjesëmarrëse në garat e Ligës së Kampioneve (UEFA Women's Champions League); KF Mitrovica 10,000 €, për inkuadrimin në Ligën e Parë të futbollit;

KB Trepça U21 (femrat) 5,000 €, si kampione në kategorinë e tyre. Kryetari theksoi se vlera e përgjithshme e mbështetjes financiare është 60,000 €. Ai sqaroi se kjo përkrahje paraqet një shenjë

mirënjohjeje dhe vlerësimi për sukseset e arritura, më shumë sesa mbulim të nevojave reale të klubeve. Ai gjithashtu nënvizoi rëndësinë e mbështetjes së sportit të femrave dhe promovimit të vajzave të reja në sport, duke theksuar se suksesi i tyre meriton përkrahje të vazhdueshme. Në fund, Kryetari bëri të ditur se, përveç kësaj mbështetjeje të veçantë për klubet kampione, Drejtoria për Sport do të shpallë edhe një thirrje publike për ndarjen e subvencioneve për klubet e tjera sportive, në mënyrë që edhe ato të përfitojnë mbështetje financiare në përputhje me mundësitë buxhetore të Komunës.

Egzon Sadiku: E kam një pyetje për Kryetarin e Komunës nëse, përveç mbështetjes për klubet sportive, është paraparë që në të ardhmen të ketë përkrahje edhe për kampionët individualë të Komunës së Mitrovicës, të cilët arrijnë suksese në sporte individuale. Ai kërkoi të dijë nëse ekziston një plan apo mekanizëm për vlerësimin dhe shpërblimin e tyre.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Në përgjigje të pyetjes së një anëtarit të Kuvendit lidhur me mbështetjen për sportistët individualë, Kryetari theksoi se kjo nismë nuk është menduar si një vendim i njëhershëm, por si praktikë që synohet të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme, në përputhje me mundësitë buxhetore. Ai shtoi se kjo mbështetje nuk i përjashton sportistët individualë, përkundrazi, Komuna synon të përkrahë edhe ata që arrijnë rezultate të rëndësishme dhe promovojnë Mitrovicën në sporte të ndryshme. Kryetari përmendi si shembull sportistët e atletikës dhe disiplinave të tjera individuale, duke theksuar se secili sportist që arrin sukses do të trajtohet me të njëjtin parim mbështetjeje. Sipas tij, kjo mbështetje financiare ka vlerë jo vetëm materiale, por edhe simbolike, duke shërbyer si shenjë mirënjohjeje dhe vlerësimi për mundin, përkushtimin dhe sakrificën që sportistët bëjnë për të arritur rezultate dhe për ta përfaqësuar me dinjitet Mitrovicën.

Igballë Islami: Anëtarja e Kuvendit theksoi se, për këtë pikë të rendit të ditës, nuk ishte shpërndarë material paraprak, prandaj gjatë prezantimit kishte shënuar klubet sportive dhe vlerat financiare të propozuara. Ajo ngriti çështjen e mbështetjes për Klubin Basketbollistik Trepça, duke kujtuar se kishte përshtypjen se Kryetari kishte bërë një premtim publik për një subvencion shtesë në rast se klubi shpallej kampion. Megjithatë nuk ishte plotësisht e sigurt për shumën e premtuar, kërkoi sqarim lidhur me këtë zotim. Më tej, ajo kërkoi sqarime për kriteret mbi të cilat janë përcaktuar vlerat financiare për klubet përfituese, duke veçuar Klubin Futbollistik Mitrovica (femrat), i cili do ta përfaqësojë vendin në arenën ndërkombëtare. Sipas saj, duke marrë parasysh rëndësinë e këtij suksesi dhe shpenzimet që sjell pjesëmarrja në gara ndërkombëtare, ky klub mund të meritonte një mbështetje edhe më të madhe. Po ashtu, ajo pyeti nëse klubet që përfitojnë nga ky vendim i veçantë do të kenë të drejtë të aplikojnë edhe në thirrjet e rregullta publike për subvencionim dhe cilët janë parametrat që janë përdorur për të përcaktuar nivelin e mbështetjes financiare për secilin klub.

Kryetari i Komunës z. Faton Peci: Sqaroj se zotimi i tij publik kishte qenë që, në rast se Klubi Basketbollistik Trepça shpallej kampion, mbështetja komunale do të arrijte deri në 50.000 €, e jo 100.000 €. Ai theksoi se vendimi aktual parasheh ndarjen e 30.000 € përmes një vendimi të veçantë, ndërsa klubi nuk do ta humbasë të drejtën për të aplikuar edhe në thirrjet publike për subvencionim, ashtu si edhe klubet e tjera përfituese. Sa i përket dallimeve në vlerat e mbështetjes financiare, Kryetari shpjegoi se ato janë përcaktuar mbi bazën e një vlerësimi të bërë nga Drejtoria e Sportit, duke marrë parasysh shpenzimet operative të secilit klub, nivelin e garave dhe sukseset e arritura. Sipas tij, Klubi Basketbollistik Trepça ka kosto dukshëm më të larta të funksionimit, ndërsa Klubi Futbollistik Mitrovica (femrat), megjithatë ka shpenzime më të ulëta për shkak se shumica e lojtareve janë vendore, do të ketë shpenzime shtesë për pjesëmarrjen në gara ndërkombëtare. Kryetari shtoi se Komuna mbetet e hapur që, nëse klubet arrijnë suksese të mëtejshme dhe krijohen nevoja shtesë financiare, të shqyrtojnë mundësinë e marrjes së vendimeve të tjera për mbështetje, në përputhje me mundësitë buxhetore. Ai theksoi se edhe Klubi Basketbollistik Trepça do të vazhdojë garat në arenën ndërkombëtare, gjë që është marrë parasysh gjatë vlerësimit të mbështetjes financiare. Në përfundim, Kryetari bëri të ditur se Drejtoria e Sportit ka hartuar një vlerësim të përafërt të shpenzimeve aktuale dhe të projeksioneve financiare të secilit klub, duke synuar një ndarje sa më të drejtë dhe të balancuar të mjeteve.

Valon Brahimi: Theksoj se nuk është në dijeni të mundësive reale financiare të Komunës për ndarjen e subvencioneve sportive, por vlerësoi se, nëse ekziston hapësirë buxhetore, do të duhej të shqyrtohej

mundësia e rritjes së mbështetjes financiare për klubet që do ta përfaqësojnë Mitrovicën në garat ndërkombëtare. Ajo propozoi që të shqyrtohej rritja e mbështetjes për Klubin Basketbollistik Trepça në 40.000 € dhe për Klubin Futbollistik Mitrovica (femrat) në 25.000 €, duke theksuar se të dy klubet do të marrin pjesë në kompeticione ndërkombëtare dhe se mbështetja e tyre do të ishte e arsyeshme nëse mundësitë buxhetore e lejojnë. Në fund, ajo falënderoi Kryetarin dhe kërkoi që kjo mundësi të shqyrtohet seriozisht.

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani. Drejtori sqaroi se shuma prej 60.000 € është planifikuar në bazë të mundësive aktuale buxhetore, përmes bartjes së mjeteve nga viti paraprak në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport. Ai theksoi se dëshira e tij, si dhe e Kryetarit dhe e gjithë ekipit komunal, do të ishte që mbështetja për klubet, veçanërisht për Klubin Basketbollistik Trepça, të ishte edhe më e madhe. Megjithatë, mundësitë buxhetore aktuale nuk e lejojnë një gjë të tillë. Sipas tij, me mjetet e siguruar është bërë e mundur ndarja e 60.000 € si subvencion shtesë për klubet që kanë arritur suksese sportive ose kanë avancuar në nivelin e garave ku marrin pjesë.

Kryesuesi vuri në votim propozimin e Kryetarit për ndarjen e subvencioneve për klubet sportive, si vijon:

- Klubit të Basketbollit “Trepça”, t’i ndahen mjete financiare në shumë prej 30.000. (tridhjetëmijë) €;
- Klubit të Futbollit të Femrave “Mitrovica”, t’i ndahen mjete financiare në shumë prej 15.000 (pesëmbëdhjetëmijë) €;
- Klubit të Futbollit “Mitrovica”, t’i ndahen mjete financiare në shumë prej 10.000 (dhjetëmijë) €;
- Klubit të Basketbollit të Vajzave U21 “Trepça”, t’i ndahen mjete financiare në shumë prej 5.000 (pesëmijë) €.

Rezultati i votimit: 18 anëtarë të pranishëm, 18 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se u miratua unanimisht Vendimi Për ndarjen e mjeteve financiare për klubet sportive që kanë arritur rezultate gjatë vitit 2026.

Pika e 15

Kryesuesi i Kuvendit rikujtoi një pikë që ishte lënë pa u trajtuar dhe prezantoi Propozim-vendimin për autorizimin e Komisionit Komunal që të kryejë zhvlerësimin e laptopëve të përdorur nga anëtarët e legjislaturës së kaluar, në përputhje me rregulloren në fuqi, me qëllim që pas zhvlerësimit ata t’u kalojnë si donacion ish-anëtarëve të Kuvendit. Ai sqaroi se, sipas rregullores, pas tre vitesh përdorimi këto pajisje konsiderohen plotësisht të amortizuara dhe se procedura po ndiqet për përmbushjen e obligimeve ligjore.

Kryesuesi e hedh në votim propozimin për zhvlerësim të laptopëve të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mandatin 2021-2025, dhe të njëjtëve t’iu ipen këta laptopë në formë dhurate.

Rezultati i votimit: 19 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesi konstatoi se u miratua unanimisht Vendimi që laptopët që janë në posedim të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në mandatin 2021-2025 (gjithsejtë 35 laptopë) tu ipen në formë të dhuratës apo transferit atyre anëtarëve të Kuvendit.

Pika e 16

Pyetje dhe përgjigje

Egzon Sadiku: Për Drejtorin përkatës (DSHPI) ngriti çështjen e ndriçimit publik në Zhabar të Epërm dhe kërkoi informata nëse është planifikuar vazhdimi dhe zgjerimi i ndriçimit në rrugët “Faik Uka”, “Bahri

Ahmeti” dhe “Faik Sadiku”. Gjithashtu, ai ngriti kërkesën për ndërtimin e një trotuari në gjatësi prej rreth 150 metrash përgjatë rrugës kryesore “Ulqini”, në pjesën ku banojnë familjet Fejza, duke theksuar se realizimi i këtij segmenti do të përmbyllte çështjen e trotuarit në këtë zonë.

Armend Begu: Për Drejtorin përkatës (DSHPI) kërkoi që të trajtohet përfundimi i trotuarit në lagjen Bajër, duke theksuar se gjendja aktuale paraqet rrezik për këmbësorët, nxënësit dhe qytetarët, pasi në atë zonë ndodhen disa institucione shkollore dhe ka qarkullim të madh. Gjithashtu, ai paraqiti kërkesën e banorëve të Fshatit Dedi për përfshirjen në planifikimet buxhetore të ardhshme të asfaltimit të një segmenti rrugor prej rreth 1.2 kilometrash, duke theksuar se ky lokalitet nuk ka përfituar investime infrastrukturore pas luftës.

Igballe Islami: Për Drejtorin përkatës (DSHPI) kërkoi informatë me shkrim lidhur me fazën në të cilën ndodhet procedura e prokurimit për kontratën për trajtimin e qenve endacakë dhe arsyet e vonës së kësaj procedure. Ai kërkoi gjithashtu sqarim lidhur me bartjen e mjeteve financiare për këtë kontratë, duke pyetur për arsyet e ndryshimit të drejtorisë përgjegjëse për menaxhimin e këtyre mjeteve dhe nëse ka pasur pengesa financiare apo procedurale.

Bajram Istrefi: Për Drejtorin përkatës (DSHPI) paraqiti kërkesë për renovimin e rrugës “Ilaz Shkodra”, e cila lidh zonën e Shipolit me Vaganicë, duke theksuar se kjo rrugë është mjaft e frekuentuar dhe ka nevojë për renovim.

Valon Brahimi: Për Drejtorin përkatës (DSHPI) Kërkoi informatë lidhur me afatin e realizimit të renovimit të rrugës së “Malit” në Kqiç të Madh, e cila është dëmtuar nga aktiviteti i operatorit ekonomik, duke pyetur nëse ndërhyrja pritët të realizohet gjatë këtij viti apo në vitin e ardhshëm.

Kryesuesi i Kuvendit i mbylli punimet e mbledhjes së 9-të të rregullt të Kuvendit të Komunës në ora 17:32 min.

Mitrovicë
29.06.2026

Procesmbajtës;

Afërdita MAXHUNI

